



FAQE 3



FAQE 4



FAQE 5



FAQE 7

Koha

www.koha.mk



Drejtësia
është vlerë e
përbashkët

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3190 • E premte 6 tetor 2017 | 15 DEN



Në fund "lufta" zhvillohet në bazë

Shkup, 5 tetor - Krahas debateve televizive dhe shpalljes së programeve të kandidatëve për kryetarë të komunave, partitë politike ditëve e fundit kanë zbritur në bazë për ti angazhuar maksimalisht strukturat lokale, kjo për të bindur qytetarin shqiptar për dhënien e votës.

Lufta politike për votë në rrethin e parë po zhvillohet mes katër fronteve - BDI-LSDM, Lëvizja BESA, ASH dhe PDSH, po mos e mohuar këtu rivalin tjetër - koalicioni RDK-UNITETI në qytetin e Gostivarit. Partia në pushtet, BDI konkurren në 18 komuna me kandi-

datë për kryetarë, ndërsa në 35 komuna me lista për këshilltarë duke hapur 35 shtabe në nivel degësh dhe mbi 250 shtabe në nivel të këshillave vendor. Partia e Ali Ahmetit, sipas asaj që thonë nga Shtabi Qendror i kësaj partie, pretendon fitore që në...
Faqe 2

Dita Botërore e Mësuesit

Sfidat e mësuesit janë dramatike



Si një mundësi të mirë "për orientimin e interesit publik në njohjen e rolit të mësuesve, rëndësinë që ata kanë në shoqëri, sigurimin e cilësisë për përgatitjen më të mirë të mundshme të mësuesve në gjithë botën" e ka konceptuar këtë dedikim edhe Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), e cila e ka caktuar 5 tetorin si Ditë Botërore të Mësuesit

FAQE 4

130 mijë të punësuar me rrogë 2500 denarë më shumë




Shkup, 5 tetor - Deri më 15 tetor, të gjitha bizneset private do të duhet në llogarinë transakcionale të 130.000 punëtorëve - në vend të 9500 denarëve sa kanë paguar për rrogën e gushtit, tani për muajin shator do të duhet të paguajnë 12.000 denarë apo 2500 denarë më shumë. Ligji për rritjen e rrogës

minimale që u miratua nga shumica parlamentare dy javë më parë, përveç që parasheh që Qeveria financiarisht t'i subvencionojë firmat private në vlerë mujore prej 1.5 milionë euro që të mund kompanitë private pa probleme të paguajnë rrogën minimale prej 12.000 denarë, njëkohësisht parasheh dhe dën-

ime të rënda për ata që nuk do ta respektojnë ligjin. "Deri në fund të muajit dhjetor, me rishikimin e buxhetit janë siguruar 6 milionë euro që do të shkojnë për kompanitë që do të paguajnë rroga minimale prej 12 mijë denarëve. Të gjithë ata kompani që nuk do të respektojnë ligjin, Ministria...
FAQE 4

SPECIALE Sindroma e Ajnshtajnit



Kur nëna e Albertit, Pauline, e lindi, koka e tij ishte kaq e madhe dhe e shtrembëruar, sa ajo kujtonte se mos ishte i deformuar. Ngaqë fundin e kokës e kishte shumë të madhe, familja mendoi mos ishte monstër. Megjithatë, ndërsa javët kalonin ata e kuptuan se ishte një fëmijë gati normal me të tjerët. Thuhet se gjyshja e tij ka klithur "është i...
FAQE 17

GLOBI Regjimi i Asadit sërish ka përdorur gazin sarin

RAJON Çfarë po ndodhë në Beograd? Rusia po ngjall frikëra lufte

ANALIZË "Vëllazëria e gjakut"




FAQE 16

Shpresat për fitore edhe tek strukturat lokale

Në fund "lufta" zhvillohet në bazë

Nga BDI thonë se pretendojnë fitore që në rrethin e parë në Saraj, Zhelinë, Tearcë, Vrapçisht, Dibër dhe Kërçovë, ndërsa në rrethin e dytë shpresojnë të marrin sigurt Gostivarin dhe Strugën, por me gjasa për fitore edhe Tetovën dhe të gjitha komunat tjera. BESA pretendon të mund BDI-në në të gjitha komunat në rrethin e dytë, ndërsa në rrethine parë shpresojnë ta marrin Likovën, Sarajin, Bogovinën, Tearcën dhe Zhelinën. ASH pretendon në rreth të parë të marrë Vrapçishtin dhe Bogovinën, ndërsa në rreth të dytë të fitojë Strugën, Dibër, Gostivarin, Bogovinën dhe Likovën. Pretendime të dalë forcë e dytë në zgjedhje lokale dhe të fitojë sigurt Tetovën dhe disa komuna tjera ka edhe PDSH



tarë duke hapur 35 shtabe në nivel degësh dhe mbi 250 shtabe në nivel të këshillave vendor. Partia e Ali Ahmetit, sipas asaj që thonë nga Shtabi Qendror i kësaj partie, pretendon fitore që në rrethin e parë në Komunën e Sarajit, Zhelinës, Tearcës, Vrapçishtit, Dibër dhe Kërçovës, ndërsa në rrethine dytë presin që LSDM të lehtësojë fitoren e BDI-së në Tetovë, Gostivar dhe Strugë, thonë për gazetën KOHA anëtar të Shtabit Qendror të BDI-së. Siç shtojnë ata, BDI do të angazhohet maksimalisht që kandidati i LSDM-së për Qytetin e Shkupit,

Petre Shilegov, të fitojë në rrethin dytë ndaj Koce Trajanovskit të VMRO-së. "Fakti që duam forcimin e koalicionit qeveritar, kjo për të mirën e të gjithë qytetarëve, bashkëpunimi në zgjedhje lokale do të jetë faktor që në të ardhmen - me LSDM-në të nxjerrim kandidat të përbashkët për president pa mos mohuar deri në fund as koalicionin parazgjedhor në disa prej njësive zgjedhore me çka mund të rrisim ndjeshëm përfaqësimin e shqiptarëve në Parlament", thonë nga Shtabi qendror i BDI-së. Nga Lëvizja BESA mendojnë se tash-

më veç kanë ndërtuar kauzën kundër rivalëve politike, ku më të theksuar janë kundër BDI-së, ndërsa elektorati i tyre është i etabluar që nga zgjedhjet parlamentare. "Nëse kësaj i shtojmë dhe kandidatët për kryetar të komunave me kredibilitet të lartë moral dhe profesional, fitore të sigurt presim që në rrethin e parë në Likovë, Çair, Saraj, Studenica, Bogovinë dhe Zhelinë, ndërsa në rrethin e dytë do të fitojmë mbi 10 komuna shqiptare - përfshirë me siguri këtu edhe Tetovën, ku presim të fitojë në rreth të dytë kryetari i partisë, Bilal

Kasami", thonë anëtar të kryesisë të Lëvizjes BESA. Ata shtojnë se elektorati shqiptar që ia kthehu shpinën BDI në zgjedhjet parlamentare dhe që votoi partinë e tyre sigurisht se do të shtohet e jo të kthehet në BDI - aq më shumë, thonë nga BESA, kur BDI përfaqon si çdo herë liderët politikë maqedonas. "Gjendja e mjerueshme në komunat shqiptare flet qartë se pretendimet e BDI-së se do të fitojë disa komuna në rrethin e parë janë thjeshtë për të turbulluar dhe dezinformuar opinionin e jo se janë reale dhe gjejnë vend në mendjen popullit shqiptar", thonë anëtar të kryesisë së Lëvizjes BESA. Pretendime serioze që në rrethin e parë shfaq edhe Aleanca për Shqiptarët edhe atë në Vrapçishtë dhe Bogovinë, ndërsa në rrethin e dytë do të shkojnë dhe me idenë për t'i fituar ato në Strugë, Dibër, Gostivar, Haraçinë, Tetovë, Tearcë, Zhelinë dhe Likovë. Me mbi 170 shtabe lokale, ASH konkurren me kandidat për kryetar në 15 komuna, ndërsa sa i përket votave për këshilltarë, presin të dalin forcë e parë tek shqiptarët. "Kemi hapur pothuajse në çdo degë dhe nëndegë shtab të Aleancës për Shqiptarët. Po funksionojmë jashtëzakonisht mirë. Kemi zgjed-

hur forma frontale dhe të drejtpërdrejta me qytetarët. Kandidatët tonë po priten shumë mirë nga qytetarët e rëndomtë, nga zanatçinjtë, ndërmarrësit, afaristët lokal, shoqatat e ndryshme, shoqëritë civile... I jemi përgjigjur pozitivisht të gjitha debatëve publike, të gjitha këto elemente si dhe veprimi ynë politik, përkrahja e madhe në terren - janë tregues se dukshëm e kemi rritur numrin e anëtarësisë dhe mbështetësve tanë. Jemi të bindur se rezultati do të jetë shumë më i mirë dhe do ta dyfishojmë numrin e votuesve në total. Jemi të bindur se do të fitojmë në qytetet kryesore shqiptare si dhe shumë komuna rurale, si dhe do të dalim forcë e parë në vota edhe në numrin e këshilltarëve në nivel republikanë", thonë nga Shtabi qendror i ASH-së. Nga PDSH kanë pretendime reale të çojnë numrin e votave në mbi 50 mijë me çka priten të rikonfirmohen si forcë e dytë politike në Maqedoni. PDSH konkurren në këto zgjedhje në 16 komuna me kandidatë për kryetarë, ndërsa në 34 komuna me lista për këshilltarë. Në këto zgjedhje, siç thonë nga Shtabi qendror - PDSH do të fitojë Tetovën, Bogovinën dhe Studenicanin. "Partitë e reja janë sezonale dhe incidentalisht si rezultat i pakënaqësisë së madhe ndaj qeverisjes së BDI-së për gjatë 15 viteve të kaluara, dhe morën ato që morën në parlamentare. Baza po kthehet tek ne, dhe populli po e kupton se pse PDSH duhet të fitojë në zgjedhjet lokale dhe pse PDSH duhet të jetë në pushtet kur shohim se kush me kë po vëllazërohet në këtë kohë", thonë nga Shtabi qendror i PDSH-së.

Koha | Fatos RUSHITI

Shkup, 5 tetor - Krahas debateve televizive dhe shpalljes së programeve të kandidatëve për kryetarë të komunave, partitë politike ditëve e fundit kanë zbritur në bazë për ti angazhuar maksimalisht strukturat lokale, kjo për të bindur qytetarin shqiptar për dhënien e votës. Lufta politike për votë në rrethin e parë po zhvillohet mes katër fronteve - BDI-LSDM, Lëvizja BESA, ASH dhe PDSH, po mos e mohuar këtu rivalin tjetër - koalicioni RDK-UNITETI në qytetin e Gostivarit. Partia në pushtet, BDI konkurren në 18 komuna me kandidatë për kryetarë, ndërsa në 35 komuna me lista për këshill-

BESA NË BOGOVINË: STOP KRIMIT DHE TË KEQES

Kandidati i Lëvizjes BESA për kryetar Komune në Bogovinë, Minur Asani, së bashku me këshilltarët komunal, kanë realizuar tubimin qendror në Bogovinë. Asani ndër të tjera në takime me qytetarët tha se bashkë me qytetarët e Bogovinës, më 15 tetor do t'i thuhet stop të keqes, krimin, pengmarrjes dhe politizimit të institucioneve. "Sonte në mesin tonë ndodhen ata to rinj e të reja, të cilët nuk u bënë shërbëtor të këtij pushteti që të marrin notë, ata kaluan studimet në mënyrë të ndershëm, ata nuk u bënë peng dhe vasalë të këtyre njerëzve që i mbushën të rinjtë tanë me diploma pa shpërndarë diturinë... Sonte, publikisht i themi stop të keqes, stop krimin, stop pengmarrjes së institucioneve, stop politizimit të institucioneve, por me fitoren e BESËS do të kemi një komunë të hapur për të gjithë, e cila për çdo ditë do tu shërbejë qytetarëve, ku qytetarët do të ndjehen të lirë. Me BESËN komuna do të jetë në shërbim të banorëve tanë, e jo e kundërta siç ka ndodhur deri më tani".



Kandidati për Likovën, Erkan Arifi prezantoi Programin

Të gjitha projektet tona do të bëhen realitet



Likovë, 5 tetor - Kandidati i Bashkimit Demokratik për Integrim për kryetar të Komunës së Likovës, Erkan Arifi në një takim me gazetarët ka prezantuar programin e tij për zgjedhjet lokale. Ai tha se

Bashkimi Demokratik për Integrim, për këtë mandat për të gjithë qytetarët e Komunës së Likovës ka përgatitur platformë shumë të shkurtër, me projektet kapitale të realizuara deri më tani nga

BDI dhe të gjitha projektet prioritare dhe më të rëndësishme për banorët. "BDI kurrë nuk është marr me premtime bombastike e të pa realizueshme, gjithmonë i parashohim ato projekte të cilat do të bëhen realitet, e këtë e dëshmojmë me atë se thuaj se të gjitha projektet që i kemi parapare gjatë zgjedhjeve të kaluara, tani më janë realizuar, ku vet qytetarët i shohin dhe i prekin ato, ku dua të përmendi faktin se vetëm investime kapitale nga BDI, janë bërë mbi 17 milionë euro", tha Arifi duke potencuar se për ujësjellësin në nivel komunal deri më tani është investuar rreth 2.5

milion euro, në kanalizime rreth 1 milion euro, në asfaltimin e rrugëve rreth 10 milion euro, bekonizim të rrugicave mbi 500.000 euro, rekonstruim të tërësishtë të shkollave fillore komunale rreth 630.000 euro, salla sportive rreth 1 milion euro, shkollën e mesme komunale "Ismet Jashari" investime rreth 490.000 euro. Arifi premtoi se në mandatin e ri katërvjeçar kanë parapare projekte me të cilat vendbanimet e komunës së Likovës do të duken me pamje urbane duke parajmëruar infrastrukturë rrugore të ndërtuar dhe të rikonstruar, përfundim të ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit për të gjitha vend-

banimet, përfundim të të gjitha rrjeteve të kanalizimeve, infrastrukturë shkollore që i plotëson të gjitha kushtet për zhvillim të mirëfilltë të procesit edukativo-arsimor. "Paralajmërojmë edhe hapjen e zonës së lirë ekonomike në bashkëpunim me Qeverinë në fshatin Nikush-tak, përfundimin e ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës, si dhe investime tjera për zhvillimin e sportit, kulturës, dhe projekte të tjera që do ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal, hapjen e vendeve të reja të punës, me çka për banorët do të sjellim mirëqenies sociale sa më të duhur për të gjithë. Për këtë qëllim do

të vazhdojmë të angazhohemi për një komunë stabile në aspektin financiar, administratë profesionale, ndërmarrje publike që do t'i ushtrojë të gjitha veprimtaritë e parapara me ligj dhe në të mirë të qytetarëve", theksoi kandidati për kryetar të Komunës së Likovës. Në vazhdim të rrugës së trasuar në katër vitet e kaluara, tha më tej ai, do të vazhdojmë realizimin e projekteve të mëdha përmes bashkëpunimit midis bashkësive vendore dhe qytetarëve, pushtetit vendor, pushtetit qendror, si dhe përmes bashkëpunimit me institucionet e ndryshme të vendit dhe të huaja.

Sela në Saraj
dhe Zhelinë

Faji ka një emër: BDI

Shkup, 5 tetor - Kryetari i Aleancës për Shqiptarë, Ziadin Sela, në kuadër të fushatës parazgjedhore për Zgjedhjet Lokale dhe vizitoi Sarajin dhe Zhelinën. Ai në takimet me qytetarët ka folur për procesin e decentralizimit, që është pjesë e Marrëveshjes së Ohrit duke akuzuar me këtë rast, BDI-në se është përgjegjëse që, siç thotë, paratë e shqiptarëve janë drejtuar në vendbanime që nuk janë të banuara nga shqiptarët. "Degradimi i procesit edukativo-arsimor në nivelin që e kemi e ka vetëm një fajtor, e është ai i cili e ka pushtetin qendror tash e 15 vjet. Është po ashtu i njëjti fajtor kujdestar për mungesën e kushteve për nxënësit. Ndahet pak buxhet nga pushteti qendror për pushtetin lokal. Problemi i ujit të pijshëm, i cili është i pranishëm në të gjitha komunat shqiptare, problem i cili nuk mund të jetë faj veç e veç i disa kryetarëve të komunave, por ka një emër të përbashkët, i konceptit politik që i ka udhëhequr këto komuna dhe që e ka udhëhequr pushtetin qendror", ka thënë Sela. Në Sarajit, kreu i ASH, e prezantoi kandidatin për kryetar të kësaj komune dhe kërkoi nga banorët që të votojnë kandidatin e Aleancës për Sarajin, Ekrem Alija. Kandidati i ASH-së për kryetar të Komunës së Sarajit, Alija shpalosi projektin për katër vitet e ardhshme, si me prioritet renditi punësimin e të rinjve, pasi që sipas tij, deri më tani janë punësuar vetëm aktivistë partiak dhe familjarë të kryetarit në largim të Sarajit. "Infrastrukturë probleme me qarkullim, riparimi i rrugëve ekzistuese, ndërtimin e rrugëve të reja, rregullimi i barrierave për gjatë hekurudhës në fshatin Kondovë. Sanimi i rrjetit të ujësjellësit, rregullimi i ndriçimit publik, sigurimin e transportit të nxënësve në fshatin Paniçar". Ai tha se janë në bisedime me Investitor nga Austria dhe Kosova për ta rikthyer në një qendër rekreative Liqenin artificial Treska.

Dimitrov për gazetën greke "Katimerini"

Të sillemi si partnerë në BE dhe NATO

Lidhur me pohimet e tij të paradokohshme se Maqedonia nuk duhet të jetë vendi i vetëm i cili do të ketë të drejtë të identitetit maqedonas dhe se nëse kjo është tregues për mundësi që të arrihet kompromis për emrin, Dimitrov theksoi se idetë për ekskluzivitet janë lojëra pa fitim, të cilat në të kaluarën kanë qenë vetëm burim i ndarjeve dhe trazirave në rajon dhe më gjerë

Shkup, 5 tetor - Në qoftë se Maqedonia dhe Greqia dëshirojnë që në të ardhmen të jenë partnerë në Bashkimin Evropian dhe NATO duhet që prej tani të sillen ashtu, thekson ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Nikolla Dimitrov, në intervistë për edicionin e së enjtes të gazetës greke "Katimerini". Dimitrov sot merr pjesë në takimin katërpalësh të Maqedonisë, Shqipërisë, Greqisë dhe Bullgarisë, i cili mbahet në Selanik me iniciativë të shefit të diplomacisë greke, Nikos Koxias. Ai dhe Koxias mbajtën disa takime nga qershori e deri më tani, ndërsa në pyetjen se nëse kjo do të thotë se janë afër ndonjë zgjidhjeje për kontestin rreth emrit, Dimitrov thotë se ai dhe kolegu i tij grek janë duke ndërtuar atmosferë miqësore dhe komunikim të hapur dhe të sinjertë, të ndërthurur me mirëkuptim të ndërsjellë të pozicioneve të ndërsjella. Të dyja palët, sipas Dimitrovit, duhet të kenë qasje më të përgjegjshme, e cila do të ofrojë progres të vërtetë dhe ardhmëri më të mirë për qytetarët e të dy vendeve. Lidhur me pohimet e tij të



NUK KAM THËNË SE KONTESTI PËR EMRIN ËSHTË I LIDHUR ME GJUHËN APO ÇËSHTJE TË TJERA

Shpresoj se në një moment do të mund të vijmë në një situatë të kemi bisedime kuptimplotë për emrin. Asnjëherë nuk kam thënë se kjo është e lidhur me gjuhën apo çështje të tjera. Këtë e deklaroi shefi i diplomacisë greke Nikos Koxias në konferencë për shtyp në Selanik, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve nëse, siç publikuan disa media greke, ka thënë se Athina përveç emrit të Maqedonisë konteston edhe çështje të tjera siç janë gjuha, kombi... Koxias, paraprakisht sot në Selanik pati takim me shefin e diplomacisë së Maqedonisë Nikolla Dimitrov, në të cilin kanë biseduar për forma të reja të bashkëpunimit. Në kontekst të takimit të sotëm të ministrave të Greqisë, Maqedonisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë, Koxias theksoi se Athina do të japë mbështetje për shumicën e vendeve për anëtarësim në BE, si dhe mbështetje për krijimin e rrjetit për bashkëpunim. Ai pranoi se Greqia është sjellë në mënyrë arrogante ndaj vendeve në rajon në vitet e 90-ta, por ka mësuar leksionin dhe është kthyer drejt ndërtimit të besimit. Vlerësoi se marrëdhëniet mes vendeve në rajon tani janë më të mira sesa që është perceptuar në opinion.

paradokohshme se Maqedonia nuk duhet të jetë vendi i vetëm i cili do të ketë të drejtë të identitetit maqedonas dhe se nëse kjo është tregues për mundësi që të arrihet kompromis për emrin, Dimitrov theksoi se idetë për ekskluzivitet janë lojëra pa fitim, të cilat në të kaluarën kanë qenë vetëm burim i ndarjeve dhe trazirave në rajon dhe më gjerë. Ai theksoi se të dy vendet duhet të kenë mirëkuptim për pozicionet e ndryshme për çështje të caktuara. "Kur një fqinj nga Maqedonia greke

thotë se ajo ose ai është maqedonas, në mënyrë rajonale, historike ose kulturologjike, vallë kjo paraqet kanosje për mua? Gjithsesi se jo. Kur unë do të them se jam maqedonas, vallë kjo duhet të paraqesë kanosje për fqinjin tim? Në Evropë në shekullin 21? Konsideroj se nuk duhet", theksoi ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë. Në pyetjen për shqetësim për opinionin grek për ekzistimin e elementeve të irredentizmit në Maqedoni, siç janë harta, mësimet historike të

cilat shfaqin aspirata drejt pjesës veriore të Greqisë, por edhe emra të objekteve, si aeroporti në Shkup, Dimitrov u përgjigj se vendi nga irredentizmi formalisht është liruar që para shumë kohësh, me Kushtetutën. Lidhur me atë se nëse palë të treta përpiqen të ndikojnë në politikën e brendshme të vendeve të Ballkanit, Dimitrov theksoi se sfidat e sotme janë të natyrës së ndryshme dhe nuk mund të shikohen nga aspekti i një vendi ose organizate.

"Garda e vjetër" e VMRO-së kërkon dorëheqjen e Gruevskit

Shkup, 5 tetor - "Garda e vjetër" e VMRO-DPMNE-së njoftoi do të kyçet aktivisht në gjitha aktivitetet e reformatorëve. Ish-deputetja e VMRO-DPMNE-së Gjulistana Markovska, theksoi se ndryshimet janë fenomen natyror dhe gjithçka që fillon duhet të përfundojë. "Është mirë që VMRO-DPMNE për

një periudhë të jetë në opozitë, për ta kuptuar faktin se ku ka gabuar dhe të përmirësojë ato gabime. Ne nuk kërkojmë që VMRO-DPMNE-ja të ndahet, vetëm kërkojmë reforma të brendshme në parti, gjegjësisht dorëheqje të kryetarit Nikolla Gruevski dhe të disa personave tjerë në krye të partisë",

tha Markovska. Ndërsa Mihail Panovski njëri nga anëtarët e parë të partisë, tha se lëvizje e besueshme është që VMRO-DPMNE-ja të reformohet dhe të fillojë të ndërtojë bashkëjetesë me shqiptarët dhe bashkëpunim me SHBA-të dhe BE-në. "Si anëtarë të Parlamentit të parë dispartiak e njohim interesin

shtetëror. VMRO-DPMNE duhet të reformohet dhe ta kap kursin euroatlantik, si dhe të gjejë parti shqiptare për koalicion, me çka do të kthehej përsëri në pushtet", tha Panovski. Më herët edhe disa anëtarë tjerë përveç veteranëve, kërkuar reforma në parti dhe dorëheqje të Nikolla Gruevskit.

14 për qind e qytetarëve ndihmë u kanë kërkuar përfaqësuesve partiak

Shkup, 5 tetor - Qytetarët nga Ballkani Perëndimor, që kërkojnë shërbime nga partitë politike, kanë për gjashtë herë mundësi më të mëdha t'i ekspozohen presionit që votën e tyre ta zëvendësojnë për para/shërbime në krahasim me ata që nuk kërkojnë ndih-

më të tillë, tregon studimi rajonal i zbatuar në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor nga projekti INFORM, në të cilin nga Maqedonia merr pjesë Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup. Në pyetjen "Nëse ndonjëherë u janë ofruar para ose

shërbime në këmbim të votës suaj në zgjedhje?", me PO janë përgjigjur 23 për qind e të anketuarve në Mal të Zi, 21 për qind në Shqipëri, 15 për qind në Bosnjë e Hercegovinë dhe 13 në Kosovë, tetë në Serbi dhe 7 për qind në Maqedoni. Në pyetjen

"Nëse ndonjëherë jeni drejtuar te ndonjë përfaqësues partiak për ndihmë", më shumë se 14 për qind e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht në Maqedoni, 13 për qind në Malin e Zi, 10 në BeH, tetë në Kosovë dhe shtatë në Serbi, ndërsa shkallë më e

ulët prej pesë për qind është vërejtur në Shqipëri. Raporti "Jeta joformale e partive politike në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor" i analizon strategjitë partiake për mobilizim të elektoratit bazuar në praktikat klienteliste. Rezultatet nga ra-

porti bazohen kryesisht në të dhënat nga anketa e zbatuar në një sërë vendesh nga Ballkanin Perëndimor në maj dhe qershor të vitit 2016, si dhe intervista gjysmë të strukturuar, punë etnografike në terren dhe hulumtime arkivore.



Në Ditën Botërore të Mësuesit

Sfidat e mësuesit në Maqedoni janë dramatike

Si një mundësi të mirë “për orientimin e interesit publik në njohjen e rolit të mësuesve, rëndësinë që ata kanë në shoqëri, sigurimin e cilësisë për përgatitjen më të mirë të mundshme të mësuesve në gjithë botën” e ka konceptuar këtë dedikim edhe Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), e cila e ka caktuar 5 tetorin si Ditë Botërore të Mësuesit

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 5 tetor - Sot kur e gjithë bota i ka drejtuar sytë tek mësuesit, duke mbështetur tek ta besimin se do të jenë të aftë të përgatisin gjeneratat e reja, profesioni dhe sfidat e mësuesve marrin padyshim një vlerë të veçantë. Si një mundësi të mirë “për orientimin e interesit publik në njohjen e rolit të mësuesve, rëndësinë që ata kanë në shoqëri, sigurimin e cilësisë për përgatitjen më të mirë të mundshme të mësuesve në gjithë botën” e ka konceptuar këtë dedikim edhe Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), e cila e ka caktuar 5 tetorin, si Ditë Botërore të Mësuesit.

Në Maqedoni, ndërkaq po tregohet të paktën deklarativisht një angazhim intensiv për përmirësimin e statusit



shoqëror të profesionit të mësuesisë, përmes rregulimeve ligjore. “Kemi nis procesin e reformave në arsim, të cilat përfshijnë përmirësimin e statusit shoqëror dhe dinjitetit të njerëzve që zgjidhën të jenë mësimsdhënës. Ndryshimet të cilat çojnë drejt arsimit më të mirë dhe më cilësor, do të krijojnë dhe implementohen në bashkëpunim me Ju”, ka nënvizuar ministria Renata Deskoska, në urimin drejtuar mësimsdhënësve. Por, pozita aktuale e mësimsdhënësve në Maqedoni nuk le hapësirë për ta dëshiruar këtë profesion. Sfidat që ata kanë përpara, sipas ekspertëve dhe njohësve të arsimit janë të shumta, deri edhe dramatike, sikurse vlerëson doajeni Tahir Zajazi. Fundja, pozita në të cilën është degraduar tani e shumë vite përpara profesionin e mësuesit është refleksi i degjenerimit të vlerave të gjithmbarshme në shoqërinë tonë. Shoqëria në njërin anë dhe roli i mësuesit në anën tjetër, janë dy forca që lëvizin paralel-

isht më njëra tjetër dhe që ndikohen në mënyrë reciproke. “Në shoqëri të zhvilluara dhe të civilizuar doemos që do të ketë mësues të vlerësuar dhe me shumë dinjitet, ndërsa në shoqëri të pa rregulluara si Maqedonia normal do të kemi mësues që nuk lakmohen prej askujt”, shprehet Zajazi. Sipas tij, mësuesi është shtylla e parë e çdo shoqërie. Shtylla e dytë, thotë se është mjekësia, ndërsa shtylla e tretë, janë gjithë profilet tjera, pasi varen nga dy shtyllat e para. “Nuk është e rastësishme që figura, personaliteti dhe imazhi i mësuesit ka marrë përmasa ndërkombëtare. Kjo është një dëshmi me të cilën vërtetohet se mësuesi është figura e ardhmërisë së çdo shoqërie. Pastaj, se cila është shkalla e vlerësimit të kësaj të vërtetë varet nga mjedisi se ku ushtohet ai profesion”, shprehet më tej ai. Protagonist i së kaluarës, i periudhës pas Luftës së Dytë Botërore kur Zajazi ishte fillorist, kujton se si në atë kohë

mësuesin e çmon shumë lartë të gjithë. “Mësuesit e mi gëzonin respektin e popullit, edhe pse masa më e madhe ishin analfabet. Por, mësuesi gëzonte respektin dhe benificionin edhe nga ata që krijonin politika arsimore. Çmoheshin, sidomos mësuesit e fshatrave dhe zonave të thella, të cilët trajtoheshin si misionarë”. Sot, gjërat kanë ndryshuar. Sa më shumë të kthesh kokën prapa, vlera e mësuesit është çdo herë e më e lartë, sqaron doajeni Zajazi, i cili sheh një denigrim të skajshëm të atyre vlerave në kohën e sotme. Rrjedhimisht, edhe sfidat që dalin përpara thotë se janë të mëdha, shumë dramatike. “Mësuesi gjendet në një mjedis me shumë të pa njohura, me presione që i vijnë nga të gjitha anët, me tekste skandalozë të cilat në vend që ti shërbejnë si mjet pune e nënçmojnë mësuesin para së gjithash. Në orvatje për ta reformuar arsimin, mësuesi është kthyer sot në një administrator dhe kjo e detyroi të humbën moralin e

TAHIR ZAJAZI

“Mësuesi gjendet në një mjedis me shumë të pa njohura, me presione që i vijnë nga të gjitha anët, me tekste skandalozë të cilat në vend që ti shërbejnë si mjet pune e nënçmojnë mësuesin para së gjithash. Në orvatje për ta reformuar arsimin, mësuesi është kthyer sot në një administrator dhe kjo e detyroi të humbën moralin e misionit që ka profesionin, pasi inspektor që nuk kanë lidhje me çështje pedagogjike shkojnë dhe kontrollojnë punën e mësuesit. Janë anatemuar këshilltarët pedagogjik. Kjo është absurde



misionit që ka profesionin, pasi inspektor që nuk kanë lidhje me çështje pedagogjike shkojnë dhe kontrollojnë punën e mësuesit. Janë anatemuar këshilltarët pedagogjik. Kjo është absurde”, shprehet Zajazi. Lista e sfidave është ende më e gjatë, ndërsa profesori nuk mund të le pa përmendur fenomenin e shitjes së diplomave dhe notave, apo faktin se secilit që i mbyllën dyert diku tjetër regjistrohet në fakultetet pedagogjike. “Janë gjëra shumë të dhimbshme, që hapin plagë të pa shërueshme në shoqëri dhe që kanë pasoja të rënda”, plotëson më tej, duke dashur të gjejë “një grimë shprese” se gjërat ndoshta mund të nisnin të ndryshojnë për mirë, pas paralajmërimeve të Qeverisë së re për ndërmarrjen e reformave rrënjësore në gjithë sistemin e arsimit.

Maqedonia është një prej 21 shteteve që zyrtarisht e shënon 5 tetorin si Ditën Botërore të Arsimit, të propozuar nga Interna-

cionalja e Arsimit (EI), me seli në Bruksel, kurse në fundamentin e saj qëndrojnë Rekomandimet e vitit 1996 të Organizatës Ndërkombëtare e Punës (ILO) lidhur me Statusin e Mësuesit, si dhe Rekomandimet e UNESCO-s në lidhje me Statusin e Personelit Arsimor, të vitit 1997. Në vijim të kësaj, Forumi Botëror i Arsimit ka nxjerrë deklaratën, ku thuhet se “Ne, sigurojmë që mësuesit dhe edukatorët do të jenë të fuqizuar, të rekrutuar në mënyrë adekuate, të trajnuar mirë, profesionalisht të kualifikuar, të motivuar dhe të mbështetur me resurse të mira, sisteme efikase dhe të qeverisura në mënyrë efektive”. Ndërkaq, në vitin 2015 shefat e UNESCO-s, ILO-së, UNICEF-it, UNDP-së dhe EI-së dhanë porosinë se “mbarë bota është bashkuar për të mbështetur Agjendën e re 2030 të OKB - së, për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe ky rol kurrë s’ka qenë më me peshë sesa tani”.

Certifikata e lindjes, kurorëzimit dhe vdekjes edhe në gjuhën shqipe

Kërkesa online dhe pranimi në adresë banimi

Qytetarët e Shkupit në të ardhmen nuk kanë nevojë të shkojnë në Drejtorinë për udhëheqjen e librave amë dhe personalisht të plotësojnë kërkesë për të pajisur me këto dokumente, sepse tani duke u regjistruar në faqen e Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë nga shtëpia, mund të plotësojnë formularin dhe dokumentin e gatshëm brenda 72 orëve “Posta e Maqedonisë” do t’ua dërgojë në adresën e banimit. Certifikatat mund t’i marrin edhe në gjuhën shqipe

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 5 tetor - Plotësimi i kërkesave për tu pajisur me certifikatë të lindjes, kurorëzimit apo të vdekjes me stilolaps dhe të njëjtën ta dorëzosh në

sportelet e Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë, si duket do të shkojë në histori. Nga data 1 tetor, të gjithë qytetarët e Shkupit mund të aplikojnë përmes internetit në faqen e Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë në mënyrë elektronike dhe nga momenti kur edhe plotësohet formulari elektronik për certifikatë të lindjes, të njëjtën brenda 72 orëve me letër rekomanduese “Posta e Maqedonisë” do t’i ja dorëzojë qytetarit në adresën ku banon. Zbatimi i këtij projekti, sipas drejtorit të Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë, Gjoko Kotevski, është pjesë e programit qeveritar 3-6-9 dhe në të ardhmen - qytetarët e Shkupit në adresën e banimit do të mund të marrin certifikatat e lindjes nëse paraprakisht regjistrohen në faqen e Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë apo në adresën e ueb portalit: uvmk.gov.mk dhe pasi të



kenë plotësuar formularin për certifikatë të lindjes, do të marrin numër notifikimi si dhe kohën kur duhet përmes “Postës së Maqedonisë” ta marrin certifikatën. Për momentin, këtë shërbim mund ta shfrytëzojnë vetëm qytetarët që banojnë në Shkup pavarësisht se janë të lindur në Shkup apo në ndonjë komunë tjetër. “Për fillim, këtë shërbim do të mund ta shfrytëzojnë të gjithë qytetarët që kanë adresë të saktë të vendbanimit në

Shkup, pa marrë parasysh se në cilën komunë është i lindur. Së bashku me Postën e Maqedonisë bëjmë përpjekje maksimale që deri te ky shërbim të kenë qasje të gjithë qytetarët e Maqedonisë”, deklaroi Kotevski, deklaroi Kotevski, është që qytetarët e Maqedonisë në të ardhmen të mos humbin kohë nëpër sportele për të dorëzuar kërkesa për dokument personal dhe se përmes këtij sistemi të sigurt, që

tani ka filluar të aplikohet, t’ju mundësojë qytetarëve shpejtësi dhe për një kohë të shkurtër të pajisen me dokumente personale pa pasur nevojë personalisht t’i drejtohen njërit nga sportelet më të afërta të Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë. Kotevski ka informuar gjithashtu se qytetarët shqiptarë po ashtu duke filluar nga 1 tetori mund të plotësojnë formularin për certifikatë lindje edhe në gjuhën shqipe dhe të njëjtën do ta marrin të plotësuar me alfabet të gjuhës shqipe. Ndërkohë, drejtori i “Postave të Maqedonisë”, Fadis Rexhepi deklaroi se zbatimi i këtij projekti në bashkëpunim me Drejtorinë për udhëheqjen e librave amë do t’ju lehtësojë qytetarëve shërbimin e marrjes së certifikatës së lindjes shpejtë dhe në kohë pa pasur nevojë të drejtohen në sportelet e drejtorisë. “Të gjithë qytetarët që do të plotësojnë formularin në

mënyrë elektronike për tu pajisur me certifikatë lindjeje në ueb faqen e drejtorisë për udhëheqjen e librave amë e pas 72 orëve të njëjtën postieri do tua dërgon në adresën e banimit. Që të mos ndodhë gabim gjatë dorëzimit të dokumentit e njëjta do të dorëzohet me letër rekomanduese e përcjellë me letër kthimi të cilën do të duhet qytetari ta nënshkruan pasi ta marrë dokumentin. Gjithashtu dërgimi dhe dorëzimi i dokumentit do të përcjellët përmes sistemit të Postës së Maqedonisë ‘tracking trace’. Kjo do të thotë se administratorët në postë, por edhe qytetari do të mund ta vërtetojë se dokumenti është dorëzuar në punonjësin e postës dhe është pranuar përmes faqes së Postës së Maqedonisë. Këtë shërbim do të mund ta shfrytëzojnë edhe shtetasit që jetojnë jashtë Maqedonisë”, deklaroi Fadis Rexhepi, drejtor i “Postave të Maqedonisë”.



Aktgjykimi për Sulejman Osmanin më 19 tetor

Sulës i cenohet e drejta e mbrojtjes

Pala mbrojtëse e të akuzuarve për ngjarjet e Kumanovës, që ndodhën në vitin 2015, është e mendimit se të dy gjykatësit të cilët e procedojnë ndaras lëndën gjyqësor për "Lagjen e Trimave", si Verka Petrovska, ashtu edhe Goran Boshevski, nuk janë të interesuar për t'u zbardhur ky rast



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 5 tetor - Gjykimi i Sulejman Osmanit, i cili gjykohej veçmas 37 të akuzuarve për ngjarjet në "Lagjen e Trimave" në Kumanovë, nuk përputhet me asnjë akt ligjor, pasi vetë akuzat është e njëjtë në të dy proceset gjyqësore. Me këtë qëndrim të enjten avokati Naser Raufi i përmblyll fjalët përfundimtare në procesin gjyqësor kundër të akuzuarit Sulejman Osmani, me çka shtoi se nuk ka ekzistuar asnjë arsye e shëndoshë dhe e mbështetur në dispozita ligjore që gjykimi i Sulës të zhvillohet ndaras të akuzuarve tjerë për sulmin në Karakollin e Gushincës dhe incidentit të armatosur në Kumanovë. "Ne vlerësojmë se arsye e vetme e Trupit gjyqësor ka qenë frika për intervalin kohor, i cili në rast të bashkimit të lëndës së Sulejman Osmanit me të akuzuarit tjerë, do t'i kalonte dy vjet nga ngritja e aktakuzës, me çka me automatizëm gjykata do të ishte e obliguar t'i lirojë nga

paraburgimit të gjithë të akuzuarit", theksoi avokati Raufi. Ai, mes tjerash në fjalët përmblyllëse nënvizoi një moment tejet të rëndësishëm në të gjithë këtë proces gjyqësor, i cili drejtpërdrejtë është i lidhur me procesin tjetër ku gjykohej 37 persona për ngjarjet në "Lagjen e Trimave", e që ka të bëjë me refuzimin e dëshmitë plotësuese të propozuara nga ana e palës mbrojtëse. Rrjedhimisht, siç tha të enjten avokati Raufi, përbërja e Trupit gjyqësor në rastin e parë u arsyetua se dëshmitë shtesë të palës mbrojtëse të propozuar së fundmi e që ishin të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ekspertiza, provat materiale dhe dëshmitarë tjerë, sipas tyre, është dashur të propozohen në fazën e mëhershme të gjykimit për "Lagjen e Trimave". "Përderisa në procesin gjyqësor kundër Sulejman Osmanit, Trupi gjyqësor tha se këto dëshmi nuk janë relevante të prezantohen. Për ne, kjo është një paradoks i paprecedent deri më tani, për shkak se gjykatësit, pjesë-

tar në një Këshill penal, për veprën e njëjtë penale, japin arsyeime të ndryshme për refuzimin e provave shtesë të dhëna nga ana jonë", tha avokati Raufi.

Pala mbrojtëse e të akuzuarve për ngjarjet e Kumanovës, që ndodhën në vitin 2015, është e mendimit se të dy gjykatësit të cilët e procedojnë ndaras lëndën gjyqësore për "Lagjen e Trimave", si Verka Petrovska, ashtu edhe Goran Boshevski, nuk janë të interesuar për t'u zbardhur ky rast. Ndërkohë, në fjalët e tij të fundit para se gjykata të miratojë aktgjykimin e caktuar më 19 tetor, i akuzuari Sulejman Osmani, të enjten e përsëriti një pjesë të mbrojtjes së tij të dhënë në fazën e mëhershme të gjykimit, dhe tha se ardhja e tyre në Maqedoni ka qenë në emër të UÇK-së, ushtri kjo e pranuar nga ndërkombëtarët. "Dua të sqaroj se ne nuk jemi terroriste dhe as që kemi qenë ndonjëherë. Prezenca jonë në Kumanovë ka qenë për shkak se Marrëveshja e Ohrit e nënshkruar në 2001 nuk u

zbatua dhe nuk u respektuar komfor afatit, i cili u premtua se do të realizohet. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe u arrestuan dhe u vranë shumë pjesëtarë të UÇK-së, dhe me qindra raste tjera politike kundër shqiptarëve, po edhe ndaj tjerëve nga ana e ish regjimit të Nikolla Gruevski dhe Ali Ahmetit, u montuan dhe orkestruan. I bëjë apel Qeverisë së re, e cila në rast se shkon hapave të shteteve demokratike, neve - ushtarëve të UÇK-së, qoftë në liri apo në burg - do të na ketë pas, mirëpo nëse nuk ndodhë kjo, atëherë UÇK do të jetë gati të reagojë çdoherë kur të cenohen liritë dhe të drejtat e shqiptarëve", tha i akuzuari Sulejman Osmani. Ndryshe, para se Gjykata Penale e Shkupit të bëjë të ditur aktgjykimin kundër të akuzuarit Osmani, më 19 tetor, pas një procesi të gjatë, i shoqëruar me shumë kritika publike për mënyrën e zhvillimit, do të shpallë aktgjykimin kundër 37 të akuzuarve tjerë për "Lagjen e Trimave", shumica e të cilëve janë shtetas të Kosovës.

24 të arrestuar për keqpërdorime të subvencioneve

Shkup, 5 tetor - Njëzet e katër persona janë arrestuar gjatë aksionit të së enjtes të MPB-së dhe Prokurorisë themelore publike për ndjekje të krimin të organizuar dhe korrupsionit, për shkak të dyshimit se kanë kryer keqpërdorim të pozitës zyrtare gjatë lidhjes së kontratave për blerje të tokës bujqësore dhe pagesë të subvencioneve, duke e dëmtuar Buxhetin e shtetit për 220.000 euro. Prokurori kompetent publik, gjykatësit për procedurë paraprake pranë Gjykatës themelore Shkup 1 i parashtrori propozim për caktim të masës së paraburgimit ndaj shtatë personave të dyshuar. Siç kumtoi PPRM, në mesin e të dyshuarve janë 15 persona zyrtar të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe njësitë rajonale të kësaj ministrie, ndërsa të dyshuarit e tjerë janë persona fizik dhe persona përgjegjës në subjekte juridike në pronësi private. Sipas PPRM-së, në periudhën prej vitit 2011 deri në vitin 2016, personat e dyshuar zyrtar e kanë shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare apo autorizimin dhe i kanë tejkaluar kufijt e autorizimeve të tyre zyrtare gjatë lidhjes së prishjes së kontratave për blerje të tokës bujqësore. Gjatë ndërmarrjes së veprimeve jo të ligjshme, janë ndihmuar nga personat e tjerë të dyshuar. Në të njëjtën kohë, kanë miratuar pagesë për Programin për mbështetje financiare në bujqësi - subvencione, në të cilën mënyrë kanë përfituar dobi për disa persona juridik dhe fizik në dëm të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Ministria e Drejtësisë, MPB dhe PSP futen në GJPSH

Shkup, 5 tetor - Hetues të Ministrisë për Punë të Brendshme dhe një ekip i Prokurorisë Speciale Publike, gjatë ditës së enjte kanë realizuar një inspektion në Gjykatën Penale të Shkupit. Jo zyrtarisht siç mëson gazeta KOHA, prezencat e prokurorëve speciale Lençe Ristovska, ka qenë për një procedurë para hetimore, e cila lidhet me ish kryetarin e kësaj gjykate, Vladimir Pançevski, dhe dy personave tjerë të punësuar në këtë Gjykatë. Për arsye se procedurat para hetimore janë sekrete, dhe zbulimi i detajeve nga këto aksione janë të ndaluara ligjërisht nga PSP-ja, për gazetën KOHA vetëm e konfirmuan lajmin hyrjes në GJPSH, por jo edhe detaje tjera për arsyen e prezencës dhe rrjedhën e mëtejshme të kësaj procedure. Ndryshe, gjatë ditës së enjte në GJPSH edhe zyrtarisht është futur një Komision i themeluar nga Ministria e

Drejtësisë, detyra e të cilët do të jetë inspektimi i Sistemit të automatizuar të informacioneve për menaxhim të lëndëve gjyqësore (SAILGJ). Ky sistem, i cili ishte pjesë e Raportit të Pribes, ku thuhet se ekzistojnë dyshime për keqpërdorim të tij, nga Komisioni në fjalë duhet të vërtetohet se vallë lëndët gjyqësore janë ndarë në bazë të shortit elektronik, apo të njëjtat gjykatësve u janë dhënë në dorë. Dyshimet për keqpërdorim të këtij sistemi janë shtuar së fundmi, pasi që gjykatësja Lidija Petrovska, e përmendur në "bombat" e opozitës të publikuara në vitin 2015, i janë ndarë tre lëndët e Prokurorisë Speciale Publike, të cilët janë në procedurë gjyqësore, duke filluar për "Fortesa 2", "Transportuesi", dhe lëndët e fundit të cilat kanë të bëjë me furnizimin e 300 veturave për nevojat e MPB-s, ndryshe e njohur si rasti "Treqind".

Kronikë

Ndërroi jetë Alit Abazi nga Kërçova

Kandidati i pavarur për këshilltar në Komunën e Kërçovës, Alit Abazi, i cili i plagos më 26 shtator në Kërçovë, ndërroi jetë nga plagët e marra në stomak. Informacionin për vdekjen e tij e ka konfirmuar zëdhënësi i Ministrisë së Shëndetësisë, Kosta Petrov, i cili theksoi se Abazi i është nënshtruar plagëve sot rreth orës 4 të mëngjesit. Abazi është sulmuar pas shpine, derisa ishte me shefin e shtabit të tij zgjedhor, Destan Abdiu, i cili gjithashtu ishte nën shënjestrën e sulmuesit. Sulmi ka ndodhur në qendër të Kërçovës. Abazi disa ditë ishte në gjendje kritike në Repartin për trajtim intensiv në klinikat e Shkupit. Ai kishte lëndime serioze në organet abdominale, shtyllën kurrizore dhe boshtin e shtyllës kurrizore. Ende nuk janë zbuluar motivet për vrasjen e tij, megjithëse bashkë me Abazi, u plagosën edhe dy të tjerë.

I vihet flaka një automjeti në Kapishtec

Persona të panjohur mbrëmë i kanë vënë flakën një automjeti "BMW" pronësi e A.J. (30) nga Shkupi, i cili është djegur në pjesën e përparme. MPB informoi se mbrëmë në orën 02:23 D.J. ka denoncuar se në rr."Adam Mickieviq" në Shkup, nga ana e disa personave të panjohur të cilët kanë qenë me maska në kokë, me shishe paraprakisht të ndezur, i është vënë flaka në pjesën e përparme automjetit "BMW" me targa të Shkupit, pronësi e birit të tij A.J. (30), i cili vetë ka arritur ta shuajë zjarrin, ndërsa personat e kanë braktisur vendin e ngjarjes. Po ndërmerren masa për gjetjen e personave.

Tre raste të dhunës në familje

51 vjeçari nga Tetova, E.A së bashku me I.A, po ashtu 51 vjeçar, të mërkurën mbrëmë rreth orës 19.00, ka denoncuar dhunë në familje që në shtëpinë e përbashkët e ka kryer vëllai i tij dhe kunati 45 vjeçar Q.A. Ai ka kërcënuar E.A dhe i ka thënë menjëherë të lëshojë shtëpinë, me ç'rast është goditur me shkop në kokë, ndërsa më pas e ka goditur edhe I.A e cila në ndërkohë ka tentuar t'i ndalojë, kurse në oborr ka hedhur sende të ndryshme. Kanë ndërhyrë familjarë të cilët kanë jetuar në afërsi dhe e kanë penguar 45 vjeçarin Q.A që të vazhdojë me sjelljen e dhunshme. Policia e ka arrestuar atë dhe e ka mbajtur në stacionin policor deri në zbardhjen e plotë të rastit pasi që kanë kërkuar ndjekje penale. Një dhunë tjetër është regjistruar mbrëmjen e 3 tetorit, nga B.M 42 vjeçar nga Banjica e Poshtme, që e ka kryer babai i tij, 80 vjeçar, i cili më herët e ka maltretuar fizikisht dhe psikikisht nënën e tij apo bashkëshorten, e ka ofenduar, tërhequr zvarrë në katin e parë të shtëpisë. Kur djali ka tentuar t'i ndajë, babai ka vrapuar me sëpatë në dorë ndaj tij ndërsa më pas ka hyrë brenda në shtëpi dhe është mbyllur. I denoncuar është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor në Gostivar dhe punohet në zbardhjen e plotë, ndërkohë pritet që të ketë edhe padi penale. Rasti i tretë i dhunës familjare është regjistruar në fshatin Senakos, kur 52 vjeçari, N.A nga ky fshat, ka denoncuar dhunë që e ka ushtruar djali i tij 20 vjeçar A.A. Sipas policisë, ai në mëngjesin e ditës së mërkurë, rreth orës 8, i ka ofenduar prindërit dhe i ka kërcënuar me thikë dhe ka hedhur sende tjera ndaj babait të tij. Është kryer hetim, kurse babai ka kërkuar ndjekje penale, ndërsa djali ka ikur dhe policia është vënë në kërkim të tij.

Plaçkitet haraçinasi në parkun e Gazi Babës

Katër persona të maskuar kanë sulmuar dhe plaçkitur një banor 26-vjeçar të fshatit Haračinë, pardje në mbrëmje, në parkun e Gazi Babës. B.N. (26) dje pasdite në Stacionin policor Gazi Babë ka paraqitur se pardje rreth orës 21, derisa ka lëvizur në parkun e Gazi Babës, është plaçkitur nga katër persona të panjohur të maskuar. Sulmuesit e kanë ndaluar dhe njëri prej tyre e ka goditur me mjet të hekurt në pjesën e kokës, ndërsa tjetri e ka kapur për rripi dhe e ka tërhequr në tokë, pas çka është alivanosur. Kur iu është kthyer vetëdija, ka vërejtur se në xhepin e xhinseve nuk e ka portofolin në të cilin ka pasur 600 euro dhe 3.000 denarë, informon Ministria e Punëve të Brendshme në Buletinin e rregullt ditor. Po ndërmerren masa për gjetjen e personave. (O.XH)



Kongres ndërkombëtar studentor në IBU



Sistemi arsimor të adaptohet

Shkup, 4 tetor - Qëllimi i Qeverisë dhe i Sekretariatit për Çështje Evropiane është t'i sjellë vlerat evropiane në Maqedoni, në shoqërinë tonë, dhe jo vetëm anëtarësimin formal në BE. Vlerësojmë se është e nevojshme që sistemi i arsimit të adaptohet. Këtë sot e theksoi zëvendëskryeministri i obliguar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani para hapjes së Kongresit ndërkombëtar studentor që për herë të katërt e organizon Universitetit ndërkombëtar ballkanik. "Arsimi na përgatit për të ardhmen e cila është e paparashikueshme dhe prandaj fokusi duhet të vihet në stimulimin e kreativitetit tek të rinjtë. Kreativiteti është po aq i rëndësishëm sa edhe aftësia për të lexuar dhe për të shkruar tek gjeneratat e reja, por edhe nevoja e mësimi të përjetshëm është një prej mënyrave se si në Evropë organizohet sistemi arsimor që të mundet të rinjtë të përgatiten për dinamikën e re të zhvillimit jo vetëm në teknologji, në përgjithësi në zhvillimin e shoqërisë", tha Osmani. Rektori i Universitetit ndërkombëtar Ballkanik (IBU), Ismail Koçajusufugllu potencoi se studentët do të diskutojnë për tema të shkëlqyera në nivel akademik, shkencor, në mesin e së cilave si të ndërtohet paqja në botë. Në kongresin e katërt ndërkombëtar të studentëve, i cili sot dhe nesër mbahet në Shkup, marrin pjesë mbi 80 studentë prej 35 vendeve të botës. Kongresi fokusohet në "Krijimin e botës së re në erën e globalizuar", ndërsa studentët do t'i analizojnë aspektet ligjore, politike, ekonomike, sociale, psikologjike, arsimore, artistike dhe inxhinierike.

Deri më 15 tetor duhet të paguhet paga minimale prej 12.000 denarë

130 mijë të punësuar do marrin rrogë për 2500 denarë më shumë

Të gjitha kompanitë private në Maqedoni deri më 15 tetor do të duhet në llogarinë transakcionale të 130.000 punëtorëve - në vend të 9500 denarëve sa kanë paguar për rrogën e gushtit, tani për muajin shtator do të duhet të paguajnë 12.000 denarë apo 2500 denarë më shumë. Punëdhënësit që nuk do të respektojnë Ligjin, do të gjobiten



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 5 tetor - Deri më 15 tetor, të gjitha bizneset private do të duhet në llogarinë transakcionale të 130.000 punëtorëve - në vend të 9500 denarëve sa kanë paguar për rrogën e gushtit, tani për muajin shtator do të duhet të paguajnë 12.000 denarë apo 2500 denarë më shumë. Ligji për rritjen e rrogës minimale që u miratua nga shumica parlamentare dy javë më parë, përveç që parasheh që Qeveria financiarisht t'i subvencionojë firmat private në vlerë mujore prej 1.5 milionë euro që të mund kompanitë private pa probleme të paguajnë rrogën minimale prej 12.000 denarë, njëkohësisht parasheh dhe dënime të rënda për ata që nuk do ta respektojnë ligjin. "Deri në fund të muajit dhjetor, me rishikimin e buxhetit janë siguruar 6 milionë euro që do të shkojnë për kompanitë që do të paguajnë rroga minimale prej 12 mijë denarëve. Të gjithë ata kompani që nuk

do të respektojnë ligjin, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të dërgojë në terren kontrollorë, të cilët do të vëzhgojnë çdo punëdhënës se deri më 15 tetor në llogarinë transakcionale të punëtorëve ka paguar ose jo 12.000 denarë rrogë", thonë nga MPPS. Ndërkohë, nga Ministria e Financave informojnë se zbatimi i Ligjit për rrogë minimale prej 12.000 mijë denarëve është hapi i parë konkret me të cilin hapet spirala për rritjen e përgjithshme të pagave në Maqedoni që do të kontribuojë për standard më cilësor të jetës. "Mjetet për mbështetjen financiare të

kompanive nga muaji shtator deri në dhjetor 2017, gjithsej gjashtë milionë euro - janë paraparë me rishikimin e buxhetit. Shpërndarja e këtyre mjeteve është paraparë të bëhet sipas numrit të punësuarve me rrogë minimale në çdo kompani dhe të realizohet në katër kategori të ndryshme. Ndërsa mjetet tjera për subvencionimin e firmave private deri në muajin mars do të sigurohen me buxhetin e viti 2018. Nga muaji mars, subvencionimi prej 1.5 milion euro në muaj do të përgjysmohet në 750 mijë euro - që do të thotë se pjesa tjetër për pagesën e rrogës minimale,

bie mbi punëdhënësin", thonë nga Ministria e Financave. Nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) thonë se janë të gatshëm që të rrisin rrogën minimale duke filluar nga 1 tetori dhe se rritja e pagës minimale do të kontribuojë dukshëm në qarkullimin më të madh të parave në treg. "Mendojmë që dallimi prej 2000 denarëve apo 2500 denarëve në rrogën minimale nuk do të jetë një barër e madhe për bizneset, pasi kompanitë janë me numër jo shumë të madh të punëtorëve dhe do ta kalojmë në fazën e parë, si dhe ekziston mundësia të kemi një mundësi më të madhe për fuqi blerëse dhe do të kemi më shumë të holla në treg për qarkullim", thotë Nebi Hoxha, kryetari i OEMVP-së, Nebi Hoxha. Gjithashtu, nga 1 tetori hyn në fuqi dhe Ligji për punëtorët e falimentuar, me të cilin përgjithmonë zgjidhet statusi i më shumë se 3000 punëtorëve të falimentuar, të cilët deri në pensionim apo nëse ndërkohë nuk gjejnë punë - do të marrin 7596 denarë.

TË SHKËPUTET KONTRATA ME MEPSO-n

EDS kërkoi që me marrëveshje të shkëputet kontrata me SHA MEPSO për furnizimin me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin elektrodistributiv në Republikën e Maqedonisë, të nënshkruar në dhjetor të vitit 2016, njoftojnë nga kompania. Në kërkesën e dorëzuar nga kompania adresuar SHA MEPSO - qëndron se arsye për këtë kërkesë është evitimi i çfarëdo lloj dyshimi për përplasje të interesave pas emërimit të pronarit të EDS-së, Koço Angjushev për kryeministër i angazhuar për Çështje Ekonomike. "Për shkak të perceptimit në opinion se funksioni zëvendëskryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe pozita pronar dominues në kompaninë e cila furnizon, gjegjësisht i shet energji elektrike shoqatës aksionare në pronësi shtetërore siç është SHA MEPSO paraqet përplasje të interesave, kërkojmë që marrëveshja të prishet me marrëveshje dhe EDS SHPK Shkup të lirohet për furnizim të energjisë elektrike për muajin nëntor të vitit 2017", qëndron në kërkesën e kompanisë dërguar MEPSO-s.

Konferencë "Të rinjtë, paqja dhe siguria"

Qeverisja e drejtë, kyçe për sigurinë dhe ekonominë

Me të vërtetë u dëshmuar se korrupsioni dhe krimi janë një prej rreziqeve kyçe për destabilizim dhe mendoj se këtë mësim duhet ta përsërisim për arsye se shumë shpesh, madje edhe politikanë dhe analistë evropianë thoshin - për ne nuk është e rëndësishme demokracia, për ne është i rëndësishëm stabiliteti", tha Shekerinska

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 5 tetor - U dëshmuar se anëtarësimi në NATO dhe BE si spirancë e politikës sonë, janë shumë të rëndësishme edhe për sigurinë edhe për ekonominë e Maqedonisë. Maqedonia është shem-



bull, ndërsa ky është mësimi nga kriza e viteve të kaluara, se shans i vetëm që shteti të jetë rezistues ndaj rreziqeve të sigurisë është qeverisja e denjë e së drejtës. Këtë e theksoi zëvendëskryeministrja dhe ministre e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në konferencën "Të rinjtë, paqja dhe sig-

uria" në organizim të rrjetit rinor Y-PEER Maqedoni. "Në rastin e Maqedonisë u dëshmuar se edhe siguria dhe stabiliteti i një shteti me të vërtetë varen nga ajo se nëse institucionet funksionojnë në mënyrë të përshtatshme, nëse mediat janë të pavarura në mënyrë të hijshme, se qytetarët,

megjithatë, kanë ndjenjen se në fund të procesit një lloj i drejtësisë, shtetit juridik funksionon. Me të vërtetë u dëshmuar se korrupsioni dhe krimi janë një prej rreziqeve kyçe për destabilizim dhe mendoj se këtë mësim duhet ta përsërisim për arsye se shumë shpesh, madje edhe politikanë dhe anal-

istë evropianë thoshin - për ne nuk është e rëndësishme demokracia, për ne është i rëndësishëm stabiliteti", tha Shekerinska. Çështja kyçe për të rinjtë, madje, shton ajo, është se si të ndikojnë ata në të gjithë procesin, ndërsa për këtë qëllim, thekson se është e rëndësishme që të angazhohen, të jenë të zëshëm dhe të mendojnë në mënyra të ndikimit më të drejtpërdrejt dhe angazhim më të madh duke e përfshirë edhe politikën. "Edhe partitë politike në njëfarë mënyre janë firma, i aftësohen tregut dhe nëse tregu thotë se pensionistët sigurt se do të votojnë, atëherë më e madhe është mundësia se partia do të dalë dhe të thotë jo që pagat, por që pensionet duhet të rriten. Për këtë mendoj se është shumë e rëndësishme që të rinjtë të jenë aktiv edhe në par-

titë politike që të jenë tensioni brenda, që të vijnë në situatë që të ulen në tryezë kur merren vendimet, ndërsa nëse nuk janë atje atëherë të jenë pjesë në këtë pjesë të opinionit ku do të bëjnë presion politik publik mbi cilëndo qeveri dhe mbi cilindo institucion për të drejtat e tyre", thotë ministrja e Mbrojtjes. Në konferencën dyditore 20 përfaqësues të rinj nga më shumë organizata do të debatojnë për lidhshmërinë e temës "Të rinjtë, paqja dhe siguria" me zhvillim të qëndrueshëm dhe Rezoluta 2030 e KB-së. Ngjarja është pjesë e aktiviteteve të cilat Shoqata për inovacione sociale ARNO në partneritet me Y-PEER Maqedoni i realizojnë në kuadër të planit të punës për vitin 2017 për komponentën "Të rinjtë" të Fondit për popullsi e KB-së.



Shtatori dhe tetori me shumë harxhime

Vjeshta vështirë përballohet

Derisa autoritetet qeveritare kanë theksuar se do të bëhet furnizimi me kohë dhe çmimi i druve nuk do të kalojë vlerën prej 50 eurosh, qytetarët thonë se mungesa e kësaj lënde djegëse ka bërë që çmimet në treg të jenë shumë më të larta. Ata thonë se muajt gjatë stinës së vjeshtës, janë më të papërbalueshmit për tërë vitin, për shkak të shpenzimeve për sigurimin e druve, si lëndë djegëse për ngrohje



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 5 tetor - Muaji shtator dhe veçanërisht muaji tetor janë ndër më të vështirët në aspektin ekonomik për qytetarët e Tetovës. Kjo është periudha kur ata përballen me harxhime enorme, të cilët dëmtojnë rëndë buxhetin e familjeve tetovare. Sipas qytetarëve, në këta dy muaj krahas harxhimeve për fillimin e vitit shkollor, periudha që pason është me rëndë. Ata thonë se duhet që të blejnë drunjtë për ngrohje që arrin shifrën deri në 50 euro për një metër kub të blerë. Përveç kësaj fillojnë edhe përgatitjet për sezonin dimëror, thonë qytetarët e Tetovës.

"Vjeshta vështirë përballohet, sepse ka shumë harxhime

që nuk mund të përballohen. Duhet që të blejmë dru për ngrohje, 10 metër janë mbi 50 euro dhe kjo është diku rreth dy rroga dhe pastaj ku janë harxhimet tjera ditore. Vështirë e nxjerrim muajin me 260 euro në muaj", thotë Afrimi, një banorë i Tetovës.

Përndryshe, nëpër pikat e shitjes druri ndonjëherë arrin edhe çmimin mbi 50 euro bashkë me transportin, ndërsa duhet që të paguhet transport shtesë. Pjesa dërmuese e amvisërive tetovare dimrit ngrohen me dru, ndërsa një pjesë e vogël me ngrohje qendrore. Kryefamiljarët shprehen se vështirë ia dalin deri në fund gjatë këtyre dy muajve.

"Këtë periudhë harxhimet i kemi enorme, nuk mund të

mbijetojmë as dy javë, kur dihet se fëmijët kërkojnë kushte për në shkollë, veshje e kështu me radhë. Po ashtu edhe një djalë e kam student edhe ai ka kërkesat e tij dhe mund të them lirisht se tash jemi në kolaps", shprehet Nexhbedini, një kryefamiljar nga Tetova.

Derisa autoritetet qeveritare kanë theksuar se do të bëhet furnizimi me kohë dhe çmimi i druve nuk do të kalojë vlerën prej 50 eurosh, qytetarët thonë se mungesa e kësaj lënde djegëse ka bërë që çmimet në treg të jenë shumë më të larta. Ata thonë se muajt gjatë stinës së vjeshtës, janë më të papërbalueshmit për tërë vitin, për shkak të shpenzimeve për sigurimin e druve, si lëndë djegëse për ngrohje. Qytetarët ankohen se nuk arrijnë që me të ardhur

rat e tyre të sigurojnë dru për të kaluar dimrin. Disa prej qytetarëve ankohen për çmimin e lartë të druve, e disa të tjerë për të ardhura të ulëta që nuk mund t'u mundësojnë të sigurojnë ngrohje për të gjithë sezonin. Përderisa shumica e qytetarëve ankohen për çmimin e lartë të druve, pronarët e depove ankohen për shitje të ulët. Nga Pyjet e Maqedonisë, njëra rajonale e Tetovës, theksojnë se Tetova ka nevojë për 100 mijë kubik dru për djegie, kurse Maqedonia në nivel republikan 100 milionë kubik, përderisa në hapësirat private metri i druve është 3500 denarë, në ndërmarjet pyjore ky çmim është 2400. Krahas kësaj harxhimet kanë edhe përgatitjet për dimër të familjeve që po ashtu rëndojnë shumë buxhetin e tyre.

Polici sulmon të punësuarit në qendër për provime

Shkup, 5 tetor - Një nëpunës policor i punësuar në stacionin policor në Kavadar fizikisht ka sulmuar dy persona nga qendra për provim të "Shoqata e shoferëve" nga Velesi, për shkak se vajza e tij nuk e ka dhënë provimin për patent shoferi. I veshur si civil, J.K., së pari i ka dërguar kërcënime verbale kryetares së qendrës për provim S.N. (41) dhe të kontrollorit për dhënie të provimit për patent shoferi C.P. (34) se do t'i vrasë ata dhe anëtarët e tjerë të komisionit nëse vajza e tij nuk e jep provimin për patent shoferi. Pastaj për kohë të shkurtë sërish ka hyrë në Qendrën për provime dhe fizikisht i ka sulmuar S.N. dhe C.P., të cilët me ndihmën e koleges së tyre M.I. kanë arritur ta largojnë dhe ta dërgojnë jashtë. Pas masave të ndërmarra, nga J.K. me vërtetim i është marrë arma zjrtare dhe kundër tij do të ngritet padi për veprë të kryer penale "dhunë".

Zhduken dy fëmijë nga "25 Maji"

Shkup, 5 tetor - Dy minorenë nga shtëpia për përkujdesje të fëmijëve pa prindër "25 Maji" në Shkup pardje janë larguar në drejtim të panjohur. MPB informoi se në Stacionin policor - Çair, një e punësuar në Shtëpinë për përkujdesje të fëmijëve pa prindër "25 Maji" në Shkup, ka denoncuar se në datën 3 të këtij muaji në periudhën nga ora 12:30 deri në 13:30, nga shtëpia në drejtim të panjohur janë larguar dy fëmijë të moshës 15 dhe 12 vjeçare. Ndërmerren masa për gjetjen e fëmijëve.

Festivalit Internacional Interfest

Anashkalohen artistët nga Shqipëria!

Manastir, 5 tetor - Në Manastir, në organizim të Qendrës për Kulturë, filloi edicioni i 26-të i Festivalit internacional i muzikës klasike "Interfest", në të cilën, sipas programit të prezantuar nga organizatori gjatë nëntë mbrëmjeve sa do të vazhdojë ky eveniment ndërkombëtarë, para manastirase do të prezantohen artistë

nga Serbia, Italia, Kroacia, Portugalia, Spanja, Turqia, Ukraina, Franca dhe Maqedonia. Siç shihet nga më lartë, edhe në këtë eveniment ndërkombëtar, mungojnë artistët nga Shqipëria. Këtyre dhjetë viteve të fundit, është traditë që artistë shqiptarë të mos ftohen të marrin pjesë në eventet kulturore që i organizo-

jnë Qendra për Kulturë, Pallati i Kulturës dhe Teatri i Manastirit. Kështu, për shkaqe për ne të panjohura, por që janë të tejkushme, mungojnë edhe ata artistë që e pasuronin përmbajtjen e Festivalit të Monodramës, për të cilët shpreheshin se "nuk mund të paramendohet mbajtje e Festivalit pa prezencën e aktorëve shqiptarë", por ja që

mundej. Nuk ftohen as në Festivalin që e organizon Teatri i Manastirit, edhe pse me Teatrin "Andon Zako Çajupi" kanë firmosur marrëveshje për bashkëpunim. Ndryshimet të shprehura se do të sjellin risi në marrëdhëniet reciproke mes institucioneve kulturore maqedonase dhe atyre shqiptare. (Q.H)

Kohëve të fundit, shtoi ai, ka numër të madh të shkrimeve për ilaçe çudibërëse, dieta, vajra për shërbime, të pambështetura me asnjë fakt shkencor, që përhapen nga një profil në një tjetër, përmes mbarë botës

Shkup, 5 tetor - Hulumtimet shkencore për ushqim të jenë të kapshëm për njerëzit e rëndomtë që të edukohen dhe informohen në mënyrë të drejtë, në vend që të lexojnë çfarëdo qoftë artikuj në Fejsbuk dhe në rrjetet tjera sociale ose ueb-portale të shkruara nga laikë, porositën pjesëmarrësit në Kongresin ndërkombëtar "Nutrikon 2017".

Paralajmëruan në rrezik nga mashtrim, e cila është gjithnjë e më e pranishme në internet, sidomos kur bëhet fjalë për aspektin shëndetësor të ushqimit. Rekomandohet, theksuan, që shumë pro-



dukte të cilat gjoja mjekojnë kancer, e sidomos manipulohet me çfarëdo qoftë dieta dhe gjoja mënyra të shëndetshme të të ushqyerit. Lënë të kuptohet edhe se kohëve të fundit në sulm është edhe

ushqimit tradicional. Për të është gjithnjë e më moderne të flitet, ndërsa më pak nga aspekti shkencor. Sipas profesorëve - ligjërues, politika duhet të largohet nga ushqimi, t'u lihet hapësirë profesional-

Arsimimi për ushqimin

Shkrimet e laikëve, të dëmshme

izimit dhe moralit. Arsimimi për ushqimin, duhet të fillojë në moshën më të re, që në kopshte, si dhe të ketë shtrirje më të gjerë, të kujdesen prindërit, arsimtarët, inspektorët, avokatët, ndërsa para se gjithash politikanët, sepse nga ata varet se si do të organizohet shoqëria. Ata që marrin vendime, u tha, duhet të marrin edhe përgjegjësi.

"Është tragjike që në raport me ushqimit, njerëzit i besojnë Fejsbukut, e jo bashkësive shkencore. Problemin e loçojmë tek vetja. Si shkencëtarë, i ndalojmë informacione në atare të vogla, të mbyllura. Mjekët në kongrese dhe simpoziume, stomatologët, teknologët, inxhinierët, nutricionistët njëjtë. Nuk

ka përzjerje mes profesionëve, ndërsa ushqimi është punë muktidisciplimore", tha dr. Vlladimir Kanurikov, organizator i kongresit.

Kohëve të fundit, shtoi ai, ka numër të madh të shkrimeve për ilaçe çudibërëse, dieta, vajra për shërbime, të pambështetura me asnjë fakt shkencor, që përhapen nga një profil në një tjetër, përmes mbarë botës. Në këtë kontekst, sqaroi profesori, nuk është e saktë se kafja është e dëmshme ose se bananja, boronicat nuk përmbajnë materie kancerogjene.

"Bananen që e hamë sot nuk ka lidhje me natyralen dhe është hibride nga dy lloje të ndryshme, të marrë me rrezatim. Kjo do të thotë

se është radioaktive, por në doza kaq shumë të vogla që nuk është e dëmshme. Boronicat kanë përmes 120 komponentë, nga të cilat 30 janë kancerogjene, ndërsa kjo është megjithatë një nga frutat më të shërueshme. Materiet kancerogjene janë në sasi të atillë dhe balancë, që janë madje edhe pozitive për organizmin njerëzor. Njëjtë edhe seleni, i cili në vetvete është helm, por pa të nuk do të ketë vitaminë E", theksoi Kakurinov.

Sipas tij, politika duhet të largohet nga ushqimi, ndërsa në llogari të asaj të mibusundojnë profesionalizmi dhe morali.

Kongresi, i cili mbahet në bashkëpunim me Grupacionin evropian për inxhinieri higjienike dhe disenj (EHEDG) dhe Iniciativës për harmonizim global (GHI) do të zgjat edhe nesër, ndërsa në të marrin pjesë profesorë - mjekë, sotamotologë, mikrobiologë, teknologë, nutricionistë, inxhinierë...



KRYETARI I KOMUNËS

Nr. / prej/ _____

Kryetari i Komunës së Çairit, Shkup, gjatë shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga, **Svetlana Spasovska** rr. "Xhon Kenedi" nr. 2/2-45 nga Shkupi, e dorëzuar me numër **PA09-1372** të datës **23.03.2016**, në bazë të nenit 21, paragrafi (2), paragrafi (11) dhe paragrafi (12) të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, 44/14, 115/14, nr. 199/14, nr. 124/15, 129/15, 271/15 dhe 31/16) e në bazë të nenit 205, paragrafi 1 dhe neni 209, të Ligjit për procedurë të përgjithshme juridike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/2005 110/08 dhe nr. 51/2011), e miraton këtë:

A K T V E N D I M
për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm

1. Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm; **mbindërtim i shtëpisë së banimit**, që gjendet, rr. "Xhon Kenedi" pn, Shkup, PK 3847/3; KK Çair; e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 93189 (të dhënat e banesës) dhe Fletë pronësinë nr. 94065 (të dhënat e truallit); objekt i cili është shënuar si:

numri i objektit 1, Nënkulm, hyrja 2, banesa 45, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **banim**, sipërfaqja e brendshme **78 m²**.

numri i objektit 1, Nënkulm, hyrja 2, banesa 45, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse**, sipërfaqja e brendshme **12 m²**.

2. Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet: **Svetlana Spasovska** rr. "Xhon Kenedi" nr2/2-45 me nr. Të letërnjoftimit: A1450475.

3. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. **0810/250-5/17** të datës 13.06.2017 i përpiluar nga **"GEO PROFIL"** SHPKNJ - Shkup.

4. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i njëjti paraqet bazë juridike për regjistrimin e të drejtës të pronësisë së objektit në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive ndërsa gjatë regjistrimit shënohet se objekti ka fituar status juridik në pajtueshmëri me Ligjin për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme.

A r s y e t i m

Kërkuesi **Svetlana Spasovska** rr. "Xhon Kenedi" nr. 2/2-45 nga Shkupi, e dorëzuar me numër **PA09-1372** të datës **23.03.2016**, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

mbindërtim i shtëpisë së banimit,

që gjendet, rr. "Xhon Kenedi" pn, Shkup, PK 3847/3; KK Çair; e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 93189

(të dhënat e banesës) dhe Fletë pronësinë nr. 94065

(të dhënat e truallit); me gjithsej sipërfaqe të brendshme për legalizim **90m²**.

Kërkuesi me kërkesën parashtror:

- Fotokopje e letërnjoftimit

-Deklaratë për pëlqim nga NLB Tutunska Banka nr. 03-6198 nga data 15.06.2017

- Certifikatë nga libri amë i të kurorëzuarve.

- Akt noteri - Deklaratë- nr. PLA 1410/2017 në Shkup me datë 24.06.2017.
- Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. **0810/250-5/17** të datës 13.06.2017 i përpiluar nga **"GEO PROFIL"** SHPKNJ-Shkup.

Toka në të cilën është ndërtuar objekti është në pronësi të Shoqatës për hoteleri dhe tregti ZSF-KOM Shpknj Eksport Import – Shkup, Besar Etemi dhe SHTPSHSH VEROPULOS Shpknj Shkup.

Gjatë procedurës janë sjellë këto:

- Proceverbal nga këqyrja në vend me nr. **PA09-1372** të datës 14.06.2017;

- Pëlqim urbanistik me nr. **PA09-1372** të datës 27.06.2017;

- Konkluzion për pagim të kompensimit nr. PA09-1372 të datës 30.06.2017.

- Konkluzion për rregullimin e kompensimit nga Qyteti i Shkupit dhe Komuna e Çairit nr. **17/13-5567/1** nga data 27.07.2017. Vërtetim për pagesën e kompensimit nga Qyteti i Shkupit nr. **17/13-5567/1 – P** nga data 16.08.2017 dhe Vërtetim për pagesën e kompensimit nga Komuna e Çairit e paguar me datë 25.08.2017.

Kryetari i Komunës së Çairit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, realizimin e këqyrjes në vend, këqyrjen në pëlqimin urbanistik, konstatoi se janë përmbushur kushtet për miratimin e aktvendimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm, **me vërejtje** se gjatë privatizimit të tokës ndërtimore të respektohen dispozitat nga neni 13 (paragrafi 3) të Ligjit për privatizim dhe qiramarrje të tokës ndërtimore në pronësi shtetërore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 4/05, 13/07, 165/08, 146/09, 18/11, 51/11, 27/14, 144/14, 72/15, 104/15, 153/15 dhe 23/16).

Në bazë të asaj që u theksua më lart, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIM PËR KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Çairit për përcaktimin e statutit juridik të objektit të paligjshëm dhe për refuzimin e kërkesës për përcaktimin e statutit juridik të objektit të paligjshëm, mund të dorëzohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës.

Ankesa taksohet me taksë administrative në shumë prej 250,00 denarë .

Dorëzuar deri te:

- Kërkuesi

- Arkivi

Përpiloi / - A.S.

Miratoi / - R.O.

Përktheu / - L.R.

Kryetar
Izet Mexhiti

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18 – 1446/1

04.10.2017 vit

Gostivar

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (" Gazeta zyrtare e R.M. " nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gaz. Zyrtare e RM nr. 5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

THIRRJE PUBLIKE

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik në territorin e Komunës së Gostivarit për shpalljen e **Thirrjes publike** për dorëzimin e iniciativave për përpunimin e Planeve urbanistike.

- Thirrja publike do të zgjasë prej 12.10.2017 deri 11.11.2017 vit.
- Thirrja publike do të shpallet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Gostivarit www.gostivari.gov.mk, në tabelën e shpalljeve në komunë, në sistemin informativ e-urbanizëm dhe në shtypin ditor "Slloboden pečat" dhe "Koha".
- Secili person fizik dhe juridik i interesuar në periudhën e thirrjes publike mundet të dorëzojë iniciativën për përpunimin dhe sjelljen e planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alineja 2,3 dhe 4 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik.
- Lëndë për iniciativë mundet të jetë sjellja e Planit të ri urbanistik, ndryshimi dhe plotësimi i Planeve urbanistike ekzistuese ose Dokumentacioneve planore urbanistike.
- Personat e interesuar fizik dhe juridik iniciativat mundet ti dorëzojnë në formë të shkruar në Qendrën për shërbime publike të Komunës së Gostivarit ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afatin e paraparë.
- Për iniciativat e dorëzuara parashtruesit do të jenë të informuar në formë të shkruar ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e – urbanizëm në afat prej 15 ditë pune nga kalimi i afatit për dorëzimin e iniciativave.
- Iniciativat e pranuar nga Thirrja publike do të inkuorohen në Programin për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës së Gostivarit për vitin 2018.

Mjetet për përpunimin e dokumentacioneve të nevojshme për iniciativat e pranuar duhet ti sigurojnë personat fizik ose juridik të cilët kanë parashtruar iniciativat.


Kryetari i Komunës
Nevzat Bejta



Dëshmi

Fjalori i 1875-ës që i pranon shqiptarët si element i barabartë në Maqedoni

Sipas studiuesit amerikan Victor Friedman, Pula jep tri paraqitje të ndryshme për kombin. Në tekstin maqedonisht ai paraqet një koncept që pajtohet me shtetin-komb tradicional etnik. Por në kolonën shqip dhe turqisht, ai jep një përpjekje për të kuptimësuar kombin me konceptin modern qytetar të bazës së shtetësisë



Salih MEHMETI

Një nga dëshmitë më interesante të shqipes së folur në Maqedoni vjen nga treva e përzier e Rekës, si mjedis ku janë gërshtuar qysh në hershmëri kontaktet gjuhësore shqiptaro-sllave.

Gjorgji Pulevski (që e quante vetën edhe si Gjergj Pula) lindi në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë në fshatin Galiçnik, në rrethin e Dibërës, prej nga ku e njohu shqipen.

Ai cilësohet si një nga penat kryesore që e pahëtoi veçantinë e sllavëve të Maqedonisë dhe të qenurit të dallueshëm nga serbët dhe bullgarët. Duke fqinjëruar afër njëra tjetrës në

Rekën ortodokse, thuhajse secila familje fliste dy gjuhë: edhe 'shkinisht', edhe shqip.

Më 1875, Pulevski botoi «Fjalor trigjuhësh» (në kolonën shqipe e shkruan si «shkinisht – makedonise, shqip ede turqish»).

Pula përdori emërtime të llojndryshme për të shënuar gjuhën shqipe. Në ballinën e fjalorit të tij ai përdori termet arbanski-arnautski, ndërsa në brendi i referohej edhe si arbanski, arnautski dhe albanski, ndërkaq në një faksimil shkruan «shqip».

Fjalori katërgjuhësh ka afërsisht 2.560 fjalë e shprehje shqipe, por duke marrë parasysh se ka raste kur një fjalë e vetme na paraqitet me forma të

ndryshme, ky fond fjalësh është më i vogël.

Është interesant të shënohet se shkrimtari nga Galiçniku i Rekës i konsideronte si të barabartë maqedonasit dhe shqiptarët.

Kështu kur bëhet fjalë për maqedonasit, ai shkruan «maqedonasit janë popull dhe atdheu i tyre quhet Maqedoni» («Така и македонцие се народ и местово њиховно је Македонија»).

Megjithatë bri këtij teksti, në kolonën shqip, Pula shkruan: «Ashtu ede shkipitarat jan njeraz ede vendin etijse po thijn Makedonija, cili po roin aqe».

Ndonëse autodidakt, ai arrinte të nxjerrte edhe përkufizime me vlerë për

popullin, kombin dhe atdheun. Në kolonën shqip, Pula përdor fjalët «njeraz» si zëvendësim për «komb». Në vijim po japim tekstin e transliteruar nga faksimili origjinal dhe pastaj edhe përshtatjen në shqipen e sotme

«Njeraz, pothon, njerijat nka njifis cilji jane ede cilji pokuvendoin, xhit, sesi, kuvend, ede, cilji, poroin, ede shokunismet, nji, meqeter, ede cilji, kishnjen xhit sesi adet ede kanga ede gazuarte, ata, njerazi, pouthojet njejrax, apo vendin ede cilji poroin, njerazi pouthojet atnija nka ata njeraz. Ashtu ede shkipitarat jan njeraz, ede vendin, etijse pothojn Makedonija, cilji, poroin aqe».

«Komb i thuhet atyre

njerëzve që janë një fis, dhe kuvendojnë të njëjtën gjuhë, dhe që jetojnë e shoqërohen me njeri tjetrin, dhe kanë të njëjtat tradita dhe këngë dhe gazmende, këta njerëz quhen komb, dhe vendi ku jetojnë e quajnë atdhe të kombit. Kështu edhe shqiptarët janë komb, dhe ata që jetojnë aty e quajnë vendin e tyre Maqedoni».

Sipas studiuesit amerikan Victor Friedman, Pula jep tri paraqit-

je të ndryshme për kombin. Në tekstin maqedonisht ai paraqet një koncept që pajtohet me shtetin-komb tradicional etnik. Por në kolonën shqip dhe turqisht, ai jep një përpjekje për të kuptimësuar kombin me konceptin modern qytetar të bazës së shtetësisë. Së këndejmi, ai pranon praninë e një numri të rëndësishëm të shqiptarëve në Maqedoni («cilji, poroin aqe» – që jetojnë atje).

Fjalorthi i Boçarëve

Dëshmi e shqipes së suliotëve

Fjalori i Marko Boçarit përbën një thesar të njërit prej dialekteve më të rralla të toskërishtes që flitej në malësinë e Sulit.

Dorëshkrimi burimor i këtij fjalorthi gjendet në Librarinë Kombëtare në Paris, me titullin fillestar «Leksikon i romaishtes së thjeshtë dhe gjuhës arbani» (Λεξικόν της Ρωμαϊκής και Αρβανητικής Απαλής), shkruan Konica.al.

Lënda e fjalorit nuk është se përvijon ndonjë kriter rigoroz, ku fjalët greke që gjenden në kolonën në të majtë të faqeve janë pa ndonjë rend alfabetik.

Nga një përmbledhje e plotë, hyrjet në greqisht janë 1701, kurse ato në shqipe 1494.

Për autorin e këtij kontributi janë hedhur dyshime të arsyeshme.

Duket se Marko Boçari është vetëm përkthyesi në



greqisht, përkatësisht ai që gjeti përkatësen greke të fjalëve shqipe. Ky fjalorth u përpilua në Korfuz, më 1809, me ngulmimin e konsullit francez në Janinë François Pouqueville.


Studiuesi Xhevat Lloshi mohon se Marko

Boçari është autor i fjalorthit, për shkak, se sipas tij, ai ka qenë tepër i ri në këtë kohë, dhe se konsulli francez e thoshte qartë që fjalori është shkruar sipas diktatit të familjarëve të Markos.

Kështu mendon edhe studiuesi me prejardhje

shqiptare, Titos Johalas, i cili beson se fjalorthi është diktuar nga Kicço dhe Notis Boçari si dhe vjehri i tij nga Preveza Kristaq Kallogjeri.

Duke qenë se për shumë arsye ky fjalorth ishte i papërdorshëm për suliotët, Johalas beson se



nisma e Boçarëve është bërë me qëllim të lehtësimit të punës së konsullit francez për një glosar frëngo-shqiptar.

Idioma shqipe e përdorur në këtë fjalorth

dygjuhësh është një veçanësi dialektore e toskërishtes, me plot elemente të moçme që hasen edhe në të folmet e arbëreshëve në Kalabri dhe Sicili. /konica.al/

Katalonja nuk ka asnjë lidhje me Kosovën



Denar BIBA

Ripranimi në BE do të ishte i pamundur, më së paku për shkak të votës kundër Spanjës, por me siguri edhe të shteteve të tjera anëtare me probleme lëvizjesh separatiste brenda tyre (Franca, Italia, Belgjika, Rumania, Hungaria etj.)


Në një shtet e shoqëri të organizuar sipas rregullave demokratike, vërtet që pushteti i takon popullit (sovrani), por populli – përveçse një nocion romantik i lëvizjeve nacionaliste të shek.XIX – është “tutus populi”, ai që ka qenë, ai që është e ai që do të jetë, e nuk duhet të përshkëmbet me tërësinë e individëve që gjallojnë në një moment të caktuar historik në një territor të dhënë gjeografik. Jo; këto janë thjesht turma! Për pasojë, vullneti i tyre në lidhje me një çështje të caktuar, si psh ndarja nga shteti mëmë në kuadrin e një lëvizjeje separatiste/indipendentiste (rasti i Katalonjës nga Spanja), bie ndesh me rregullimet kushtetuese, të cilat përbëjnë kodin bazë të funksionimit të asaj shoqërie e që konsiderohet apriori i paravendosur.

Nuk ka asnjë paralele mes lëvizjes e vullnetit vetëvendosës së popullatës shqiptare, banore autoktone të Kosovës dhe pavarësisht të saj nga Serbia (shtet i një popullate tjetër, të mirëdallueshme) dhe kësaj çka po ndodh në Katalonjë, gjithë ndërmjet spanjollësh. Nga ana tjetër, e paqartë mbetet e ardhmja e kësaj krahine (rajoni), në hipotezën se referendumi do të ishte legjitim dhe i pranuar mbarëkombëtarisht. Në këtë rast, Katalonja – që nga ana e saj pretendon se është zona më e zhvilluar ekonomikisht e Spanjës dhe se me taksat e banorëve të saj po mban me bukë “parazitët” e rajoneve të tjera të pazhvilluara – do ta gjente veten automatikisht jashtë BE dhe do të vuante pasojat shumë të rënda ekonomike.

Ripranimi në BE do të ishte i pamundur, më së paku për shkak të votës kundër Spanjës, por me siguri edhe të shteteve të tjera anëtare me probleme lëvizjesh separatiste brenda tyre (Franca, Italia, Belgjika, Rumania, Hungaria etj.).

Pikërisht, sepse çdo lëvizje separatiste e që i fryn zjarrit të nacionalizmit është në thelb e kundërta e asaj çfarë simbolizon BASHKIMI (!!!) European, sanksionet (e drejtpërdrejta apo të pashpallura si të tilla) do ta dëmtonin ekonominë e Katalonjës me shumë nga sa supozohet se e dëmton rrjedhja e të ardhurave që gjenerohen në territorin e saj drejt territoreve më pak të zhvilluara të Mbretërisë Spanjolle. Duke përfunduar këtë shënim të shkurtër mbi ngjarjet në Katalonjë, sjell në mendje se pas kësaj mund të kemi edhe riaktivizimin e një sive terroriste të ETA-s...

Demokracia është në krizë. Pas Luftës II Botërore, njerëzit e keqkuptuan demokracinë për kapitalizmin; kapitalizmin e barazuan me paranë dhe paranë e vunë në vend të Zotit. Tashmë kemi shkruar shumë larg, kemi humbur vlerat morale që na bënin “njerëz”, për pasojë nuk po dimë më ç’të bëjmë edhe me “pushtetin e popullit”... (gazeta-Shqip.com)



Dr. Bardhosh GAÇE

Për shkaqe fundamentale të njohura që nga kohët e lashta, shqiptarët dhe historia e tyre, kultura dhe fundamenti i tyre shpirtëror, rrugëtimi dhe pengesat e këtij udhëtimi kanë arritur të hyjnë në konsideratat dhe opinionin e studiuesve të huaj gjithëkategorish. Toka dhe njerëzit e këtyre anëve i kanë grishur herë pas here dhe kohë pas kohe njerëzit e huaj të dijes, të cilët nuk kanë ngurruar t’i kushtojnë jetën dhe fuqinë e dijes këtij trualli dhe këtyre njerëzve. Metafora e gjithë kësaj vijimësie intelektuale nga të huajt është absolutisht e lexueshme, sepse dëshmitë e një vendi ndër më të lashtët e Ballkanit, e gjuhës ndër më të vjetrat indoevropiane, i kanë referencat tek gjuha e shqiptarëve. Nga njëra anë dëshmitë dhe faktet, dhe nga ana tjetër shqisa e hollë e studiuesve të huaj, për atë që atyre iu është kërkuar, janë bërë bashkë për të ndërtuar një realitet mbijetese dhe vleroritit bashkëpunues kohë pas kohe.

Pavarësisht epokave dhe kohëve në të cilat janë bërë prezent studiuesit e huaj në domenin shqiptar, ata përbëjnë një plejadë të artë dhe rëndësia për t’i dëshmuar të gjithë pjesë të një plejade dijes, është normale, madje dhe funksionale, parë si realitet i brendshëm i dijes, po ashtu dhe si realitet i jashtëm.

Robert Elsie, si njëri nga ne njerëzit e dijes shqiptare

Elsie është një personalitet i shquar dhe interesant i dijes, i cili i përket shkollës perëndimore ku ai është shkolluar, është formuar dhe ka filluar rrugëtimin e dijes, studimeve dhe hulumtimeve shkencore

Dr. Hahni, Majeri, Shuflaj, Pedersen, Bariç, Tagliavini, Franc Nopça të cilët i përkasin fushës së dijes shkencore, që nga gjuha, albanologjia, historia e deri tek etnologjia dhe folklori, vazhdojnë të mbeten dijetarët e shquar, të cilët arriten të krijojnë kontaktet dhe marrëdhëniet e kulturës shqiptare me opinionin e huaj perëndimorë, në kushte dhe rrethana tejet të nevojshme për shqiptarët. Natyrisht, domeni shqiptar ishte i begatë, interesant dhe një madem që nuk mund të konsumohej lehtë. Kësaj plejade të njohur, pa as më të voglin hezitim, i bashkohet studiuesi, albanologu, përkthyesi dhe shkrimtari Robert Elsie, i cili është njëri nga zërat më të shquar të dijes filologjike, i cili thuhet gjithë jetën ia ka kushtuar Shqipërisë dhe

Kosovës.

Elsie është një personalitet i shquar dhe interesant i dijes, i cili i përket shkollës perëndimore ku ai është shkolluar, është formuar dhe ka filluar rrugëtimin e dijes, studimeve dhe hulumtimeve shkencore. Nëse plejada e para tij ishte e shkolluar në universitetet dhe katedrat e njohura të Vienës, Gjermanisë, Kroacisë, Gracit e gjetkë, Elise mbart në formimin e tij kulturat universitare të Universitetit të Kolumbisë Britanike, studimet Universitare të Lira të Perëndimit (Berlin), angazhimin praktik të Studimeve të Larta (Paris), Institutin e Dublinit (Irlandë) dhe Universitetin e Bonit (Gjermani). E gjithë kjo kulturë dhe të nxëni dijes shkencore-praktike, duket si iu vu në shërbim për të eksploruar dhe për tu marrë me Shqipërinë dhe kulturën e saj.

I lindur në Vankuverin e largët të Kanadasë, larg kontinentit të vjetër evropian, Elsie duket se më së shumti ishte një evropian i qartë, kulturalisht, shpirtërisht dhe shkencërisht. Siç duket, dashuria për Shqipërinë dhe shqiptarët iu bë një lloj lajtmotivi pune dhe angazhimi, që kur për herë të parë vizitoi Shqipërinë në vitin 1978. Elsen, falë të mësuarit dhe përdorimit mjaft mirë të gjuhës shqipe e kanë takuar

shumë nga njerëzit e dijes në Shqipëri dhe në Kosovë, sepse siç ai shprehej, ai frekuentonte rregullisht eventet kulturore dhe filologjike, frekuentonte bibliotekat shqiptare me një rregullsi të habitshme, kërkonte të kishte kontakte të vazhdueshme me njerëzit në rrugë, në auditoret studentore, në shtëpi e kudo ndodhej. Elsie ishte një mjeshtër i rrallë i komunikimit me njerëzit pavarësisht shtresës kulturore.

Që në kontaktin e parë me Shqipërinë dhe Kosovën, Elsie nuk u shkëput dot nga shqiptarët për shumë arsye, të cilat mund të kuptohen lehtësisht përmes krijimtarisë dhe vepërimitarisë së tij shkrimore, hulumtuese, studimore dhe evidentuese. Pa asnjë dyshim, Elsie i ka njohur shqiptarët dhe përmes njerëzve të mendimit që vinin nga dherat e huaja në Shqipëri, po ashtu dhe nga kontaktet që kultura shqiptare krijoi me perëndimin gjatë shekullit të kaluar. Ai vazhdoi të ishte një ndërmjetës mes takimeve të Universitetit të Bonit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, po ashtu që një frekuentues i rregullt i Seminareve Ndërkombëtare për gjuhën, letërsinë e kulturën shqiptare në Shqipëri dhe në Kosovë. Lidhja e tij që kaq e fortë me Shqipërinë, sa e la amanet që trupi i tij pas vdek-



Jusuf BUXHOVI

Shtetndërtimi i Kosovës dhe fshirja e kujtesës historike!

Kujtesa historike e shtetit të Kosovës, krahas kohës së pushtimit nga Beogradi (1912-1999), ka edhe përpjekjet e vazhdueshme për çlirim dhe liri, që si proces i pandalshëm, në binarët historik u vu me krijimin e Lëvizjes Kombëtare te fundviteve të tetëdhjeta dhe atyre të nëntëdhjeta e drejtuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës

Morrovit për fshirjen e kujtesës historike si dhe rishkrimin e saj, ka një mesazh tepër dramatik për viktimat e historisë, në mënyrë që ajo të mos u

përsëritet. Për shqiptarët e Kosovës, që brenda një shekulli e gjysmë përjetuan tre gjenocide, ndërsa këtij të katërtit (në fundvitet e nëntëdhjeta) i shpëtuan në saje të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s të drejtuar nga SHBA-të, kujtesa historike ka rëndësi të veçantë, ngaqë me të lidhet edhe çlirimi, lidhet liria, lidhet edhe demokracia, e mbi të gjitha lidhet krijimi i shtetit të Kosovës, që paraqet të arriturën më të madhe historike të shqiptarizmit.

Dhe, kujtesa historike e shtetit të Kosovës, krahas kohës së pushtimit nga Beogradi (1912-1999), ka edhe përpjekjet e vazhdueshme për çlirim dhe liri, që si proces i pandalshëm, në binarët historik u vu me krijimin e Lëvizjes Kombëtare te fundviteve të tetëdhjeta dhe atyre të nëntëdhjeta e drejtuar nga Lidhja

Demokratike e Kosovës, në të cilën morën pjesë të gjithë shqiptarët pa përjashtim ideologjie dhe përkatësi sociale. Kjo lëvizje kombëtare ndër më të fuqishmet dhe njëherësh ndër më të suksesshmet e historisë sonë, ka kalendarin dhe arkitekturën e vet politike, që kaloi nëpërmes legjitimitetit të infrastrukturës demokratike të domosdoshme për një shtet të pavaur: Deklaratën për Pavarësi të 2 korrikut 1990, Kuvendin e Kaçanikut të mbajtur më 7 shtator 1990 dhe, sidomos, Referendumin për Pavarësi të 26 shtatorit 1991, ku qytetarët e Kosovës votuan për pavarësi, me ç’rast iu dha drita jeshile themelimit të shtetit të Kosovës, i cili filloi të jetësohet me zgjedhjet e para pluraliste dhe presidenciale më 24 prill 1992, që për pasojë patën krijimin e Qeverisë së Kosovës dhe atë që u shfaq si

jes të prehej në Shqipëri. Në moshën 67 vjeçare, në kulmin e fuqisë intelektuale, ai u nda nga jeta, ku patjetër la shumë punë të papërfunduara, pasi ai ishte një pasionant i projekteve të mëdha.

Robert Elsie është një nga studiuesit me një akribi të shquar shkencore dhe me interesa shumë të gjera. Duke qenë albanolog, përkthyes, studiues dhe shkrimtar, kjo i ka mundësuar atij të mundë të depërtojë në realitetet historike, filologjike, shpirtërore, kulturologjike dhe etnologjike shqiptare, të cilat kanë gjetur pasqyrim të larmishëm dhe të gjerë në një korpus botimesh mbi gjashtëdhjetë të tillë. Një korpus i tillë botimesh në shqip dhe në gjuhë të huaja, me një kreativitet brenda vendit dhe jashtë vendit, përbën një pasuri jo e zakonit, që Elsie i ka dhënë lexuesit, institucioneve të dijes brenda dhe jashtë, një lloj "enciklopedie" shqiptare me prerje historike, gjuhësore, folklorike, letrare, poetike, zakonore, bashkëkohore. Është një pasuri e "regjizuar" nga një njeri i dijes, i cili njihje mjaft mirë rrugët e rëndësishme të komunikimit urban dhe akademik, elitare dhe populist.

Nëse sheh me vëmendje titujt e botuar nga Elsie, shihet një prirje për të rimarrë në konsideratën e studiuesit dhe "interpretit" fondamente të dijes dhe të kulturës shqiptare, ku bie në sy Migjeni, historia e kulturës shqiptare, Azem Shkreli, historia e letërsisë shqiptare, kanuni, Fishta, poetë të huaj si Kavafis, Visar Zhiti, Flora Brovina, autorë të tjerë të huaj që janë marrë me kulturën shqiptare dhe çështje të tjera. Ka një marrëdhënie të brendshme në këtë sasje të Elsie, për shkakun e nevojës së sasjeve fundamentale për historinë e letërsisë shqiptare, si një koncept fundamental referencial të saj në kulturën e popujve dhe të kulturave. E mu për këtë shkak autori ka arritur të sjellë në vlerësimin e tij historinë e kulturës

shqiptare, atë të Kosovës, të dhëna dhe dëshmi të shumta nga kultura e lashtë shqiptare dhe eposi, që për nga koha dhe nga përkushtimi, një studiuesi do t'i duhej një jetë.

Kuptohet qartë, ky raport i tij me këto angazhime, duket se i kanë shërbyer atij për një bazë referencial, duke vënë një gurë tjetër të rëndësishëm në sproven e kulturës shqiptare, siç kanë bërë më herët albanologë të tjerë të njohur shqiptarë dhe të huaj. Këmbëngulja e prurjes në një dritë të re dhe moderne të interpretimit nga njëra anë e vertikale historik shqiptarë (kanuni, cikli i kreshnikëve, etnokultura, folklori, Evlia Çelebia, leksiku i kulturës popullore, fjalori historik i Kosovës dhe fjalori historik i Shqipërisë etj) dhe kontribute të tjera të rrjedhës bashkëkohore të jetës, qoftë dhe me profilet e Fishtës, Migjenit, Eqrem Bashës, Azem Shkreli dhe hapësira të tjera sintagmatike, mendoj se përmbushin një dëshmi kulturologjike dhe të zhvillueshme në rrjedhat kohore.

Robert Elsie i ka bërë një shërbim të shkëlqyer kulturës shqiptare jo vetëm me angazhimin për ta dëshmuar në të gjithë raportet Shqipërinë dhe kulturën shqiptare, por ai me korpusin e botimeve të tij, ka arritur të sjellë një këndvështrim modern dhe bashkëkohorë për fundamentin e kësaj kulture, të letërsisë shqiptare, të folklorit, të drejtës zakonore dhe të disa prej poetëve të tij të preferuar. Antologjia poetike e përzgjedhur prej tij duket se do të jetë një lloj certifikate e mirë për poezinë shqipe në përditë dhe në të ardhmen.

Elsie meriton nderimin e dijes dhe shkencës shqiptare në përmasën e nevojshme, pasi ai që, kontribuoi dhe punoi si njëri nga ne, njerëzit e dijes dhe kulturës. Vepra e tij ka nevojë për përlujtonë të sinqertë, ashtu siç ai ia besoi trupin kësaj toke dhe mirësisë së këtyre njerëzve me një kulturë të lashtë.

shtet paralel, që mori përsipër organizimin e jetës institucionale, ku bënte pjesë edhe rezistenca e armatosur, e cila, edhe përkundër vështirësive të njohura, në çastet e domosdoshme, u kthye në mjet të dobishëm të politikës me të cilën u legjitimua edhe ndërhyrja e armatosur ndërkombëtare. Pra, 26 shtatori i vitit 1991 është themel i shtetit të Kosovës, që u konfirmua me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008.

Por, kujtesa historike e shtetit të Kosovës si dhe datat e saj që u përmendën më lart, jo vetëm që kanë filluar të anashkalohej, por edhe "të harrohen" fare dhe qëllimisht madje nga mohuesit e historisë së njëmendtë, nga brenda të lidhur edhe nga jashtë. Kjo u pa më së miri me rastin e 26 shtatorit, ditës së Referendumit për Pavarësi, të aktit historik dhe legjitimit të vetëvendosje, kur jo vetëm nuk u shënuar kund, por thuajse u injorua fare nga mediet dhe veçmas nga historianët tanë si dhe institutet (ai i Historisë dhe Albanologjisë), që kanë për detyrë t'i shënojnë këto data, por edhe të organizojnë tribuna dhe botime shkencore për to, në mënyrë që historia e shtetndëritimit të Kosovës të shpjegohet në përputhje me zhvillimet politike e shoqërore si dhe proceset historike shumëshekullore nëpër të cilat ka kaluar, dhe jo me përrallat, "heroizmat" folklorike si dhe thashethemet e politikanëve zulumqarë që kanë uzurpuar shtetin e Kosovës duke e kthyer në plaçkë të veten dhe mendojnë se ai mund

të mbahet dhe të mbijetojë me përmendore të paqëndrueshme shumë prej tyre të shpifura dhe jashtë konsensusit kombëtar.

Me këtë qëndrim antihistorik dhe antikombëtar, me logjikën e "Fermës së kafshëve" të Orvellit dhe doktrat e "qytetarisë amorse" të diktatit ahtisarian, Kosova kthehet në një shtëpi pa themel, e mbi të gjitha në një feud kaçakësh pa kujtesë historike, pa trashëgimi shpirtërore, pa identitet etnik dhe kulturor të një qytetërimi të lashtë antik (dardan-ilir), në një si çorbë e mbetjes islamike dhe hijë tjetër, ku zhvlerësohen konceptet intelektuale, shoqërore, që lidhen edhe me ato të Rilindjes kombëtare dhe shtyllave kryesore mbi të cilat qëndronte shqiptarizmi si program politik që nuk është përmblyllur ende, ngaqë ajo që po ngjet tani te ne dhe sjelljen tonë përkon me akuzat që Beogradi ka ngritur kundër nesh në memorandumet e akademikëve serbë, atë të vitit 1937, 1944 dhe të vitit 1986!

Mudrov fliste për shkatërrues të kujtesës historike dhe të historisë, ndërsa te ne po ndodh vetë-harresa historike, vetë-shkatërrimi i historisë, vetë-shkatërrimi i identitetit kulturor dhe shpirtëror (duke u zëvendësuar kombëtarja me fetaren dhe arabizmin brutal). Dhe kështu, po ndodh vetë-shkatërrimi i shtetit të Kosovës në përputhje me planet e armiqve të tij shekullor, e me këtë edhe vetë-shkatërrimi ynë! Dhe, nga mallkim i vetë-shkatërrimit, nuk ka shpëtim, e as fajtor madje!... (KultPlus)

Shtetet e Bashkuara të Armëve

Vitorio XUKONI

Lumi i Madh i Kuq, që lan Amerikën me gjakun e 33,000 të vrasurëve çdo vit nga armët e zjarrit, gjarpëron dhe mbërrin në sheshin e lojërave të të rriturve, dhe parajsën e tyre, Las Vegas. Statistikat thonë se dhjetëra të vdekurit, të paktën 58, dhe qindra të plagosurit, më shumë se 500, të goditur nga plumbat e vrasësit janë rekordit historik i viktimave të një atentati, por një milion pushkë ushtarake sulmi, si ato të përdorura nga gjyshi vrasës i Mandalayt, që janë ligjshmërisht apo paligjshmërisht në duar të civilëve, si dhe më shumë se 300 milionë pistoletat, garantojnë se ky rekord do të thyhet edhe ai një ditë.

Të shumtë dhe tepër prepotente janë rrëketë dhe përrënjtë që ushqejnë Lumin e Madh të Kuq dhe asnjë digë, asnjë bonifikim, nuk mund t'i thajë apo ndalë tani. Kur një senator i ardhshëm i Republikës, një ish-gjykatës i quajtur Roy Moore, hipi në skenën e emërimit të tij në Alabama duke tundur një revolver të kromuar, dhe duke premtuar ta merrte me vete në Parlament, atje ku ulet edhe një deputet që s'ka shumë kohë që ka dalë nga spitali, pas plumbave që mori prej një atentatori anti-republikan, shpresat për të paktën kufizimin e dëmit të këtij arsenali, atëherë shpresat bëhen të gënjeshtërtë. Lajmet dhe komentet pas masakrës së Las Vegasit, duke përfshirë apelet e zbrazët nga presidenti Donald Trump, i cili mbjell përçarje dhe urrejtje me "cicerimat" e tij në mëngjes dhe pastaj kërkon dashuri dhe unitet në mbrëmje, janë vetëm përsëritja, e një filmi që e kemi parë dhe do ta shohim përsëri.

Janë politika, interesat komerciale, kultura popullore, tradita, frika, urrejtja reciproke, historia kombëtare që e fryn Lumin, që as edhe kasaphanat si ajo në shkollën fillore të Sandy Hook, shkollën e mesme Columbine, asaj në Orlando,

Tragedia periodike e atentatorit, që zbraz armën kundër të pafajshmëve dhe të panjohurve, në dukje pa asnjë motiv personal apo mëri, i lindur amerikan dhe me origjinë amerikane, nuk është e shpjegueshme, përveçse përmes disponueshmërisë së instrumentave të vdekjes, që shumëfishojnë efektin e aksionit

Qendrën komunitare në San Bernardino, ose vrasjet politike nuk arrijnë ta ndalin. Përkundrazi, tronditja merr efekte paradoksale, duke inkurajuar blerjen e armëve të zjarrit, nga frika se autoritetet do të përpiqen, ashtu si bëri presidentin demokrat Bill Clinton në vitin 1993, të paktën për të kufizuar tregtinë e armëve të tilla si pushkët automatike dhe gjysmë-automatike, të konceptuar jo për sport, gjueti, qitje, por për të vrasur sa më shumë armiq që të jetë e mundur, në kohën më të shkurtër të mundshme. Një AR16, e disponueshme në internet me çmimin e një smartphone të fundit, është në gjendje të realizojë tri të shtëna për sekondë dhe 180 për minutë, e kufizuar vetëm nga nevoja për të ndërruar karikatorin.

Burimi i Lumit të Madh të Kuq është i padiskutueshëm sepse është shkruar në historinë e kombit dhe sipas interpretimeve të ndryshme, çertifikuar nga Amendamenti i Dytë i Kushtetutës, i cili duket se i garanton të gjithëve "të drejtën për të mbajtur armë", madje edhe në kontekstin e harruar të një "milicie popullore të mirë armatosur".

Fakti që ky parim kushtetues u shkrua në vitin 1791, kur mushqetat karikoheshin me pluhur të zi baru-

ti, dhe as edhe pushkatarit më i zoti nuk mundej të qiste 180 goditje për minutë, duket se ka humbur në argumentet e NRA-së, lobi i mbajtësve të armëve, republikanëve, Trumpistëve. Dhe demokratëve, që nuk guxojnë të kundërshtojnë ballaz, por vetëm të modifikojnë skajet, duke futur kufizime nga ato që pushkatarët i shmangin përditë.

Historia amerikane, domethënë sukcesi i pushtimit evropian të kontinentit dhe rebelimit independentist, është e ndërtuar nga armët e zjarrit moderne, "Colt", "Uinchester", "Smith & Uesson". Asociimi mes "six shooter", revolveri në këllëfin e sherifit-kauboj, dhe "manifesti i fatit" të pionierit në karrocën e tij, ngulitur thellë në shpirtin kombëtar, ashtu si dhe figura e "minuteman", rebelit që ishte gati të shtinte kundër mercenarëve të Kurorës mbretërore.

Tragedia periodike e atentatorit, që zbraz armën kundër të pafajshmëve dhe të panjohurve, në dukje pa asnjë motiv personal apo mëri, i lindur amerikan dhe me origjinë amerikane, nuk është e shpjegueshme, përveçse përmes disponueshmërisë së instrumentave të vdekjes, që shumëfishojnë efektin e aksionit.

Përgjigja klasike e lobit, që kujton se nuk janë armët që vrasin, por ata që i mbajnë, mund të lexohet kollaj edhe përmby: nëse Steve Paddock do të kish patur një thikë, dhe jo një "koleksion" automatikësh, siç quhen butësisht arsenalët, nuk do i numëronim me dhjetëra apo qindra të vdekurit e të plagosurit. "Por nuk është ky momenti për të folur për kontrollin e armëve të zjarrit", ka thënë zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Sara Sanders Huckabee, duke e ditur që, me të kaluar tronditja, asgjë nuk do të ndryshojë. Dhe politikanë të rinj do të vazhdojnë të lundrojnë nëpër Lumin e Madh të Kuq, për të mbërritur në portin e cinizmit të tyre. (La Repubblica)



BEKIM KADRIU, PROFESOR



DREJTËSIA ËSHTË VLERË E PËRBASHKËT

Një shtet demokratik do të merrte me seriozitet të gjitha kërkesat për të drejtat e qytetarëve, do insistonte të krijojë një shoqëri të drejtë, ku secili do ta merrte atë çfarë i takon. Sidomos për format më të skajshme të padrejtësive, si gjykimet e montuara, diskriminimi etnik, politik ose gjinor, shërbimet e drejta shëndetësore, domosdoshmërisht të ketë një qasje më serioze nga ana e shtetit, me qëllim që secilin person ta bëjë të ndjehet sikur jeton në shtetin e tij dhe jo në shtet të huaj.

Koha Delvina KËRLUKU

Bekim Kadriu ka lindur në Kërçovë. Sipas vokacionit është jurist i diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi", në vitin 2000 në Shkup. Ai është mbajtës i dy gradave master dhe atë njëra në "E drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare" dhe tjetra "E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut". Grada e parë e masterit ishte në kuadër të Fakultetit Juridik të Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi", në vitin 2006, në Shkup. Ndërsa, e dyta në kuadër të Fakultetit Juridik në Universitetin e Shën Thomasit, në Majami - SHBA, në vitin 2009. Të dy gradat i ka përfunduar me nderimet më të larta. Në nëntor 2010 arriti gradën e Doktoraturës në Fakultetin Juridik të Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi", në vitin 2010, në Shkup, në të drejtën mbi diskriminimin. Pas diplomimit në Fakultetin Juridik, Kadriu vazhdoi punën në profesionin akademik. Së pari ai ishte angazhuar si asistent në Fakultetin Juridik, ku edhe diplomoi, në lëndën e Të drejtës ndërkombëtare publike. Në tetor të vitit 2002 filloi punën në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë. Pas marrjes së doktoraturës së tij, që nga viti 2011, Kadriu është angazhuar si asistent-profesor (docent) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës. Aktualisht ai ligjëron: Hyrje në ligjin e të drejtave të njeriut dhe Të drejtën ndërkombëtare private. Përveç ligjërimit, Kadriu ka botuar libra dhe artikuj juridikë,

në revistat e vendit dhe jashtë. Në vitin 2015 ai botoi dhe promovoi tre libra: E drejta ndërkombëtare private; Mbrojtja nga diskriminimi në të drejtën ndërkombëtare dhe Diskriminimin sipas moshës në të drejtën ndërkombëtare. Aktualisht ai përgatit një artikull mbi përdorimin e gjuhës shqipe në Maqedoni sipas Propozim-ligjit të ri, që do të paraqitet në një konferencë në Durrës, Shqipëri, në fund të tetorit. Kadriu ka punuar në shumë projekte kërkimore si studiues dhe autor i analizave të ndryshme ligjore. Aktualisht ai punon në një Komentim të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Kadriu ka mbajtur disa trajnime mbi mosdiskriminimin dhe

ka marrë pjesë në konferenca dhe seminare të ndryshme që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të ligjit për të drejtat e njeriut. Flet rrjedhshëm shqip, maqedonisht dhe anglisht. Kadriu është anëtar i Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë me mandate 5 vjeçar.

KOHA: Z. Kadriu, jeni paraqitur në opinion me fjalën mbi drejtësinë dhe rrugën e saj. Gjithashtu ligjëroni para studentëve. E gjithë kjo, është këmbëngulje drejt drejtësisë, për të qenë Maqedonia një shtet i së drejtës?

KADRIU: Drejtësia është gjë e

natyrshme, nuk është këmbëngulje. Drejtësia është ideal që të gjithë ne, për çdo ditë, duhet të tentojmë ta arrijmë. Të gjithë duhet të reflektojmë në mënyrë që, pavarësisht në çfarë pozite ndodhemi, drejtësinë ta kemi udhërrëfyes të veprimeve tona. Nuk ka gjë më të natyrshme dhe më të arsyeshme se drejtësia. Ajo nënkupton që secili ta merr atë që i takon në një shoqëri, qoftë si student, si punëtor, qytetar, si individ ose pjesëtar i një grupi të caktuar. Për shembull, drejtësia imponon që bursat t'i marrin studentët që kanë nevojë ose që i meritojnë; drejtësia kërkon që studenti i shkëlqyeshëm të merr 10 në provim; drejtësia kërkon që vendi i punës t'i takojë kandidatit më të

mirë. Pra, drejtësia është vlerë që të gjithë e kemi të përbashkët, për çka sjellja e drejtë është sjellja e pranueshme nga të gjithë, sepse të gjithë e presin një gjë të tillë. Ndërsa sjellja e padrejtë menjëherë bie në sy, sepse të gjithë e kuptojnë se diçka devijon nga ajo çfarë është pritur. Edhe një profesor është i pranueshëm te studentët dhe te shoqëria nëse është i drejtë, nëse i kryen detyrimet e tij që i ka, nëse sillet drejt në punë, nëse i trajton studentët drejt. Shteti gjithashtu duhet të tentojë të jetë i drejtë për të gjithë qytetarët e tij, ndërsa parakusht për të qenë i drejtë është sundimi i ligjit. Natyrisht, ka raste kur edhe ligjet nuk janë të drejta, që nënkupton miratimin e ligjeve më të mira, megjithatë themeli i çdo shteti të drejtë është sundimi i ligjit.

KOHA: Nëse nisim këtë bashkëbisedim se sa e drejtë ka qenë jeta me ju dhe sa padrejtësi u është bërë, qoftë në trungun familjarë, vendlindje, si qëndron?

KADRIU: Besoj që shumë herë shumica prej nesh (ndoshta edhe të gjithë ne) e mendojmë se sa e drejtë ka qenë apo s'ka qenë jeta me ne. Por ajo që do të theksoj është se kur arrihet një stad të caktuar të jetës, kur krijoni personalitetin dhe karakterin tuaj, nuk e mendoni lidhshmërinë e jetës me drejtësinë apo padrejtësinë, por e kuptoni se është gjë që ndodh dhe përballemi me të si diçka shumë e natyrshme. Mendoj që nuk duhet të presim që jeta çdoherë të jetë e drejtë me ne. Padrejtësitë paraqiten në çdo segment të jetës. Nuk do të kisha thënë në familje, sepse secili prind dëshiron më të mirën për secilin nga fëmijët e tij/saj. Por, në segmente tjera të shoqërisë, gjatë procesit arsimor, gjatë punësimit, në marrëdhëniet të punës, në rrugë, spital, gjykatë, në përgjithësi në marrëdhëniet e ndryshme shoqërore, padrejtësitë ndodhin. Është shumë e rëndësishme që padrejtësitë të luftohen, me të gjitha mjetet e mundshme. Madje, njeriu me virtyte lufton jo vetëm për padrejtësitë që i ndodhin atij/asaj, por edhe për padrejtësitë që u ndodhin të tjerëve. Siç theksova më lart, drejtësia është ideal dhe vlerë universale, që të gjithë e duan dhe e presin. Por, jo të gjithë sillen në mënyrë të drejtë në çdo situatë, sepse ndonjëherë te individët mungon tendenca për vlera universale dhe mbizotërojnë apetitet personale. Unë personalisht nuk kam pritur që jeta të jetë e drejtë me mua, por jam munduar që të marr atë çfarë e kam merituar në momente të caktuara.

KOHA: Rruga për të ardhur deri te drejtësia është një rrugë e gjatë, ashtu edhe për të marrë një status si të profesorit. Si e përshkruani këtë rrugë të shkollimit?

KADRIU: Shkollimi është proces që i jep formë personalitetit të një individi. Nuk është vetëm parakusht për të ushtruar një profesion të caktuar, por është edhe parakusht për formimin e një individi. Thjesht, shkollimi e definon një person se kush është duke rrumbullakuar dhe definuar personalitetin e tij. Edhe mua personalisht, shkollimi nuk më ka aftësuar vetëm të jem profesor, por ka ndikuar në mënyrën time të të menduarit. Vlerat që kam fituar gjatë shkollimit dhe studimeve, kanë definuar personalitetin tim dhe kanë ndikuar edhe në mendimet dhe botëkuptimet e mia, që së fundi reflektojnë në sjelljen time të përditshme. Shkollimi si proces është edhe i pafund. Me fitimin e titullit doktor të shkencave të caktuara, personi nuk bëhet i përkryer dhe nuk din gjithçka. Pra, shkollimi ndoshta si proces formal përfundon në një moment, por si proces i fitimit të dijeve të reja vazhdon në pafundësi.

KOHA: Maqedonia është një shtet ku mbizotëron diskriminimi gjinor, etnik., ku padrejtësia është më e fuqishme se drejtësia,



ku mbisundon i fuqishmi dhe jo drejtësia, ku shkelen të drejtat e njeriut, ku gjykohe raset dhe ndërpriten nga rrethana të panjohura. Ajo që shihet në Maqedoni, mund të jetë gjithçka veç drejtësi jo?

KADRIU: Shoqëri ideale nuk ka. Shoqëri ku do të respektohen absolutisht të drejtat e njeriut dhe drejtësia, nuk ekziston. Por, format e paraqitjes së padrejtësisë dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, janë të ndryshme. Në ndonjë shoqëri do të dominojnë disa forma të caktuara të padrejtësisë dhe shkeljeve, ndërsa në shoqëri tjera do të dominojnë forma tjera. Kjo gjë absolutisht nuk nënkupton se, për shkak të formave të caktuara të padrejtësisë, një shoqëri është më e padrejtë se tjetra, por thjeshtë se disa shoqëri gjejnë mënyra më të arsyeshme për ti luftuar padrejtësitë dhe shkeljet ligjore. Në anën tjetër, edhe nuk guxon individët të kënaqen me një status të caktuar në shoqëri. Nuk guxon të pohojmë, sidomos ne që merremi me këtë lëmë, se respektimi i të drejtave të njeriut është i kënaqshëm. Absolutisht jo. Përkundrazi, gjithmonë ka hapësirë që të drejtat e njeriut dhe drejtësia të avancohen në një shoqëri. Madje, drejtësia si koncept relativ dhe abstrakt, kërkon që me kalimin e kohës të marrë formë të reja. Paraqiten grupe të reja që kërkojnë të drejta, paraqiten të drejta të reja që duhet të realizohen, që nganjëherë mund të nënkuptojë edhe përgjegjësi të dyfishtë për definimin e formave të reja ligjore. Republika e Maqedonisë nuk është përjashtim. Republika e Maqedonisë nuk është shoqëri e drejtë dhe ideale ku respektohen të gjithë të drejtat e njeriut. Por, është shumë e rëndësishme në një rrugë anë, si reagojnë qytetarët ndaj të drejtave të tyre në përgjithësi, ndaj shkeljeve dhe padrejtësisë. Është e domosdoshme që qytetarët të kërkojnë të drejtat e tyre dhe të kërkojnë mbrojtje nga institucionet përkatëse. Në anën tjetër, është edhe më e rëndësishme çfarë qasjeje ka shteti ndaj kërkesave të qytetarëve të realizojnë të drejtat e tyre. Një shtet demokratik do të merrte me seriozitet të gjitha kërkesat për të drejtat e qytetarëve, do insistonte të krijojë një shoqëri të drejtë, ku secili do ta merrte atë çfarë i takon. Sidomos për format më të shkajshme të padrejtësisë, si gjykimet e montuara, diskriminimi etnik, politik ose gjinor, shërbimet e drejta shëndetësore, domosdoshmërisht të ketë një qasje më serioze nga ana e shtetit, me qëllim që secilin person ta bëjë të ndjehet sikur jeton në shtetin e tij dhe jo në shtet të huaj.

KOHA: Sa larg është Maqedonia në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagës, që kanë të bëjnë me demokracinë dhe që kërkohe nga çdo shtet kandidat, si kriteret të domosdoshme për integritet evropian?

KADRIU: Kriteret e Kopenhagës janë kriteret më të rëndësishme politike për integritet evropian. Por, plotësimi i këtyre kriterëve më tepër duhet të shihet si diçka që do të shkojë në favor të qytetarëve të Maqedonisë. Me fjalë tjera, parimet e sundimit të ligjit, pavarësia e gjyqësorit, respektimi i të drejtave të njeriut, liria e shprehjes dhe e mediumeve, stabiliteti i institucioneve, janë vlera që duhet të tentojmë ti arrijmë me qëllim që qytetarët të mund të kenë jetë më të mirë, duke pasur siguri më të madhe juridike, duke i realizuar të drejtat e tyre pa pengesa, duke rritur standardin e tyre ekonomik. Këto vlera vitet e fundit kanë qenë të cenuara në Maqedoni dhe rikthimi i këtyre vlerave është diçka e domosdoshme, edhe për rrugën e integritet, por edhe për vetë qytetarët e Maqedonisë. Kthimi në këto vlera nuk arrihet brenda natës, por kërkon seriozitet, punë, devotshmëri permanente, dhe para së gjithash kërkon vullnet politik. Klasa politike



duhet të kuptojë që kthimi i këtyre vlerave shkon në interes të përgjithshëm të qytetarëve dhe këto vlera nuk kanë ngjirime politike. Pavarësisht klasave politike në pushtet dhe opozitë, sundimi i ligjit, pavarësia e gjyqësorit dhe respektimi i të drejtave të njeriut nuk guxon të vendosen në pikëpyetje. Derisa klasat politike i cenojnë këto vlera në momentin kur janë në pushtet, ajo tregon mospasjen e kulturës politike për respektimin e vlerave universale, që është problem në vete për Republikën e Maqedonisë.

KOHA: Reformat në fushën e drejtësisë janë pjesë e agjendës prioritare për evropianët. Si i shihni reformat në drejtësi në Maqedoni?

KADRIU: Si vazhdim i përgjigjes paraprake, pra, edhe për reformat në drejtësi nevojitet vullneti politik që të sigurohet gjyqësori i pavarur, i paanshëm, objektiv dhe i drejtë. Duket sikur reformat në drejtësi zgjasin me vite të tëra, mos them me dekada, por në realitet mospasja e vullnetit politik, përkatësisht nevoja e politikanëve të sigurojnë procese me epilog të caktuar, ka bërë që gjyqësori të mos jete i pavarur, ose thënë më troç, ka bërë që të ketë ndikime të hapura politike në pushtetin gjyqësor. Ndikimet politike kanë bërë që pushteti gjyqësor të bëhet kategori e lëndueshme (vulnerable) dhe qytetarët të humbin besimin të institucionet e gjyqësorit. Përsëris, derisa klasat politike nuk kuptojnë që pushteti gjyqësor dhe pavarësia e tij është vlerë universale dhe nuk duhet të keqpërdoret, flasim për mospasjen e kulturës politike. Gjithashtu me bindje të plotë them që lufta për pushtet gjyqësor të drejtë dhe të pavarur nuk duhet të jetë vetëm farsë e partive kur janë në opozitë. Për gjyqësor të drejtë dhe të pavarur duhet të luftojë vetë pushteti me masat ligjdhënëse dhe administrative, dhe sidomos duke u përmbytur nga ndikimet politike që mund të ushtrohen, që përsëri është (mos)pasje e sensit dhe kulturës politike.

KOHA: Sistemi i vendeve të zhvilluara kalon nëpër një proces të përzgjedhjes rigoroze, nëpërmjet një konkursi dhe një trajnimit unik të gjyqtarëve, përmes një akademie shkollore, që është një garanci për cilësinë. Te ne si ndodh, apo si duhet të jetë?

KADRIU: Padyshim që duhet të

ekzistojë një sistem i përzgjedhjes së gjyqtarëve, që ata më të mirët ta kenë "privilegjin" e shqiptimit të drejtësisë. Një sistem i tillë ekziston edhe në Republikën e Maqedonisë, duke u nisur nga kriteret ligjore, që duhet të garantojnë cilësinë e gjyqtarëve të zgjedhur, deri te themelimi i Akademisë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, seleksionimin e kandidatëve për praninë në Akademi, trajnimit që organizohet në Akademi, deri te zgjedhja e gjyqtarëve nga radhët e atyre që kanë plotësuar kushtet ligjore dhe kanë kaluar trajnimin në Akademi. Sidoqoftë, ky sistem jo gjithmonë është zbatuar në Republikën e Maqedonisë. Shpeshherë pushteti nuk ka respektuar këtë sistem dhe ka përzgjedhur gjyqtarë jashtë këtij sistemi, pra persona që nuk kanë kaluar trajnimin në Akademi. Kjo gjë është bërë për shkaqe politike, duke anuluar zbatimin e rregullave që kanë insistuar në zgjedhjen e gjyqtarëve nga radhët e atyre që kanë kaluar trajnimin në Akademi. Nga ana tjetër, edhe sistemi ekzistues që parasheh trajnimin e kandidatëve për gjyqtar në Akademi, nuk do të thotë që është i përkryer. Pra, duhet gjithmonë sistemi të sfidohet dhe të shihet ku ka defekte që të mund të evitohen, përkatësisht të shmangen. Si shembull, sistemi i krijuar me themelimin dhe funksionimin e Akademisë u konstatua se cenon parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, duke imponuar rregulla rigoroze, madje edhe diskriminuese. Prandaj, duhet që të bëhet ndonjë ndryshim në formën e "ulësës së zbrazët", që mos plotësohen vendet me kandidatë nga bashkësitë që janë të mbi-përfaqësuar në pushtetin gjyqësor. Nga ana tjetër, edhe monopoli që e ka Akademia te përzgjedhja e gjyqtarëve ndoshta duhet të sfidohet, për shkak se ka gjithmonë persona që nuk kanë kaluar akademinë, por me përvojën ose me njohuritë e tyre, mund me sukses ta ushtrojnë funksionin e gjyqtarit. Thënë shkurt, gjithmonë duhet të sfidohet sistemi i përzgjedhjes me qëllim të gjendet modeli që është më i përshtatshëm për vendin e caktuar.

KOHA: Drejtësia duhet të reformohet nga njerëz me "duar të pastra"?

KADRIU: Gjëja e parë që më shkon në mendje kur lexoj këtë frazë është fraza tjetër - "kriminaliteti i jakave të bardha", që gjithmonë më ka sfiduar në kuptimin e krahasimeve



të termeve me realitetin me të cilin po përballemi vazhdimisht. A duhet që drejtësia të reformohet nga njerëz me duar të pastra? Patjetër që po, derisa këto njerëz nuk ngecin në pengesën e parë të jenë "të përlyer".

KOHA: Për rikthimin e besimit të humbur në gjyqësorin e politizuar dhe të korruptuar në shkajshmeri, i kritikuar jo vetëm nga brenda por edhe nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar, duhet punë, drejtësi, apo...?

KADRIU: Republika e Maqedonisë ka problem me sundimin e ligjit. Nëse rregullat ligjore respektohen, ato domosdoshmërisht do të kenë pasojë pozitive edhe në funksionimin e pushtetit gjyqësor. Sundimi i ligjit nënkupton që zgjedhja e gjyqtarëve, puna e tyre, përgjegjësia dhe shkarkimi nga funksioni, të bëhen në përputhje me rregullat ligjore. Në këtë formë, fillimisht, zgjedhja e gjyqtarëve duhet të bëhet nga juristët më të aftë dhe me vlera më të larta morale. Zbatimi i rregullave ligjore për zgjedhjen e gjyqtarëve, sidomos përzgjedhja nga, dhe trajnimit i tyre në Akademinë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet të garantojë zgjedhjen e kandidatëve më të mirë. Nga ana tjetër, edhe përgjegjësia dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk duhet të jetë selektiv, por sistemi i përgjegjësisë dhe shkarkimit duhet të funksionojë në mënyrë objektive dhe të njëjtë për të gjithë. Këtu rol të rëndësishëm ka Këshilli gjyqësor, i cili kontrollon punën e gjyqësorit. Por, diku shihet të kontrollojë edhe punën e Këshillit gjyqësor dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit. Madje, është problematike përse kur një pjesë e anëtarëve të Këshillit gjyqësor nuk plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtarë, ndërsa duhet të kontrollojnë punën e gjyqtarëve! Nga aspekti i punës së gjyqtarëve, ajo gjithashtu duhet të bëhet në përputhje me rregullat ligjore. Ja vetëm një aspekt. Shpërndarja e lëndëve duhet të bëhet sipas sistemit elektronik të shpërndarjes, me qëllim që mos t'u jepen lëndë të merr epilog të caktuar. Mospasja e respektimit i rregullave për shpërndarjen elektronike të lëndëve ka çuar që edhe raportit i ekspertëve evropian (Raporti i Pribesë) të theksojë një gjë të tillë. Shkurtimisht, Republika e Maqedonisë ka kornizë të mirë ligjore për punën e gjyqësorit. Natyrisht, hapësirë për avancim ka gjithmonë.

Por, zbatimi i përpiktë i këtyre rregullave ligjore ka dështuar dhe duhet të rikthehet nga ana e organeve.

KOHA: Kthimi i sundimit të ligjit dhe shtetit ligjor nuk ka alternativë dhe se kjo do të arrihet përmes çrrënjosjes së të gjitha dukurive negative dhe rivlerësimit të plotë të gjyqësorit?

KADRIU: Sundimi i ligjit dhe pushteti gjyqësor i pavarur dhe objektiv, janë vlera universale. Këto vlera shkojnë në interes të të gjithëve, për çka të gjithë duhet të jemi të interesuar, dhe sidomos autoritetet shtetërore që kanë marrë besimin nga qytetarët për qeverisje. Këto vlera janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Në një rrugë anë sundimi i ligjit ndikon në pavarësinë e gjyqësorit. Respektimi i rregullave ligjore për zgjedhjen, punën dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve duhet të sigurojë një gjyqësor më objektiv, të paanshëm, profesional dhe të drejtë. Nga ana tjetër, meqë pushteti gjyqësor i zbaton ligjet në raste konkrete dhe shqipton drejtësinë, është pikërisht një nga hallkat që duhet të sigurojë zbatimin e parimit të sundimit të ligjit. Demokracia është një sistem i përbërë nga shumë elemente, që nëse funksionojnë të gjithë si duhet, kemi demokraci të mirëfilltë. Përkundrazi, nëse një element nga sistemi nuk funksionon si duhet, i gjithë sistemi shembet. Mospasja e sundimit të ligjit ndikon në një gjyqësor jo-objektiv dhe të padrejtë. Sistemi gjyqësor jo-objektiv dhe i padrejtë prodhon procese të montuara politike, shkelje të të drejtave të njeriut në masë të madhe, madje edhe cenim të lirisë së shprehjes duke shqiptuar dënime ose kompensim dëmi në raste të shpifjes. Mospasja e sundimit të ligjit dhe pushtetit gjyqësor ka ndikuar që të krijohet edhe perceptimi për mospërgjegjësinë e bartësve të funksioneve publike, që tani Prokuroria Speciale mundohet ta ndryshojë.

KOHA: Derisa rëndësia e veçore kombëtare, regionale, si dhe të kaluarat e ndryshme historike, kulturore dhe fetare duhet të merren parasysh, është obligim i të gjithë neve edhe i shtetit tonë?

KADRIU: Përgjegjësia më tepër bie mbi shtetin, i cili duhet të bëjë çdo gjë që secili qytetar, pa dallim përkatësinë fetare, etnike ose kulturore që e ka, të ndjehet sikur jeton në shtetin e tij. Shteti duhet të bëjë që të gjithë qytetarët të kenë të drejta të barabarta dhe ata të drejta t'i gëzojnë dhe ushtrojnë në jetën e përditshme. Shteti duhet të punojë në drejtim të tolerancës dhe bashkëjetesës ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme që jetojnë në të. Sa Maqedonia ka arritur të bëjë një gjë të tillë është për tu diskutuar. Ka shumë argumente që e dëshmojnë pikërisht të kundërtën.

KOHA: z. Kadriu, çfarë privilegji iu jep të jeni djali i Profesorit Osman Kadriu?

KADRIU: Profesor Osmani është jurist i dalluar dhe, si i tillë, është i mirënjohur dhe i pranuar nga të gjithë në Republikën e Maqedonisë. Për atë arsye është privilegji për mua të jem djali i tij, por njëkohësisht është edhe sfidë për të dalë përtej asaj të jem i njohur vetëm si "djali i profesor Osmanit". Kjo është gjë e vështirë për ta bërë! (buzëqesh)

KOHA: Kë mbrojni më shumë, drejtësinë apo familjen?

KADRIU: Drejtësia dhe familja nuk janë vlera që i bëjnë konkurrencë njëra-tjetrës, por plotësohen. Një person duhet të mbrojtë edhe drejtësinë edhe familjen. Sidoqoftë, mbrojtja e drejtësisë domosdoshmërisht do të dominojë sepse familja nuk mund të mbrohet duke qenë i padrejtë. Përkundrazi, të jeni të padrejtë, qoftë edhe në mbrojtje të familjes, më tepër i bëni dëm familjes, sesa mbrojni.



Çfarë po ndodhë në Beograd? Rusia po ngjall frikëra lufte



Kur Katalonja bëhet "zemra e Serbisë"

Zyrtarë të Beogradit po deklarohen çdo ditë për gjoja mbrojtje të sovranitetit të Spanjës. Arsyeja është e qartë: Ky solidarizim i Beogradit me Madridin kundër Katalonjës, është përpjekje për shpëtim borxhi ndaj Spanjës e cila ende s'e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Një faqe kroate në Facebook, "Croatiball", ka ironizuar me këtë qasje të Beogradit dhe për efekt humorizimi parullën shoviniste serbe "Kosova- zemër e Serbisë" e ka zëvendësuar me "Katalonja - zemër e Serbisë".

E frikësuar prej ndikimit të NATO-s dhe BE-së, Rusia bëri këtë javë dërgesën e parë të premtuar, të avionëve luftarakë në Serbi, ndërsa më shumë automjete ushtarake dhe mbrojtje kundër-ajrore pritet t'i dërgohen aleatit të vjetër rus në të ardhmen e afërt, teksa në Ballkan tensionet sa vijnë e rriten, sipas Associated Press



Rusët dërguan dy avionë MiG-29, të cilët u çmontuan dhe u transportuan në një aeroplan transporti, teksa katër të tjerë pritet të mbërrijnë deri më 20 tetor, në kohën e vizitës së ministrit rus të mbrojtjes, Sergei Shoigu. Rusia ofroi avionët me dy motorë, në gjendje të arrinjshme shpejtësi maksimale prej më shumë se 1.400 milje në orë dhe që fillimisht debutuan në kulmin e Luftës së Ftohtë në vitet 1970, pa pagesë, megjithëse kostoja e Serbisë për rregullimin dhe modernizimin e avionëve mund të shkojë rreth 236 milionë dollarë. "Ne do të vazhdojmë të mbrojmë lirinë dhe pavarësinë tonë",

tha presidenti serb Aleksandar Vuçiç. Marrëveshjet e armëve, të cilat aktualisht përfshijnë bisedime për të siguruar sistemin e raketave tokë-ajër S-300 të Rusisë, të lëvizshme dhe në gjendje të godasin në rreze të gjata, konsiderohen si një mënyrë për Rusinë, që ta mbajë Serbinë brenda sferës së saj të influencës dhe të krijojë distancë, midis vendit ballkanik dhe NATO-s dhe BE-së. Afrimi me Rusinë për qëllime të mbrojtjes, pas viteve të tëra luftë me fqin-

jët Kroacinë, Bosnjën dhe Kosovën në vitet 1990, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, mund të vërë në provë Serbinë, pasi shumë serbë mbeten skeptikë për t'u bashkuar me BE. Serbia nuk është anëtare e plotë e NATO-s, por ka qenë pjesëmarrëse aktive në programin jo-ushtarak Partneritet për Paqe të organizatës, që nga firmosja në dhjetor 2006. Por Serbia është në negociata për t'u futur në BE - një aleancë ekonomike pra, ndryshe nga NATO-ja, me

bisedimet që pritet të finalizohen deri në vitin 2019. Beogradi mori mbështetje të martën nga kryeministrat e tre vendeve të BE, Bullgari, Greqi dhe Rumania. "Të gjithë e dimë se vendi i natyrshëm i Serbisë është në Bashkimin Evropian", tha kryeministri bullgar Bojko Borisov. Marrëdhëniet me BE-në, megjithatë, nuk janë më të mirat për momentin. Vuçiç shprehu zhgënjim të martën mbi vendimin e BE për të mos njohur referendumin e pavarësisë të Katalonjës - një përpjekje e fundit për t'u larguar nga Spanja, ndërkohë që po BE, mbështeti shpalljen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia në 2008. "Kosova fitoi pavarësinë pa mbajtjen e referendumit, por Katalonja... nuk mund të marrë diçka të tillë", tha Vuçiç. "Nganjëherë, ne, serbët, pyesim veten pse duhet të jemi viktimë e standardeve të dyfishta?". (Newsweek)



SHBA i dhuron Kosovës 1 milion dollarë pajisje për kontrollin e kufirit

Programi për Kontrollin e Eksportit dhe Sigurisë së Ndërlidhur Kufitare të SHBA-ve (EXBS) dhe Departamenti i Energjisë (DOE) kanë dhuruar pajisje në vlerë prej 1 milion e 100 mijë dollarë për Ministrinë e Punëve të Brendshme - Policinë Kufitare dhe Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit, Ministrinë e Financave - Doganat, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë - Departamentin për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike dhe Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore. Ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, tha se MPB është e përkushtuar që të punojë së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai tha se ky donacion do të jetë shumë i mirëseardhur për Kosovën. Ndërsa, Ambasadori i SHBA-ve, Greg Delawie, tha se janë të përkushtuar me institucionet e Kosovës për të forcuar kufijtë e Kosovës.

MË SHUMË SE GJYSMA E SERBËVE TË ORIENTUAR DREJT RUSISË

Më shumë se gjysma e qytetarëve serbë (56.3 për qind) besojnë se Serbia duhet të ketë marrëdhëniet më të afërta me Rusinë, bën të ditur kërkimi i fundit i 'Mendimit të Ri Politik Serb'. Sipas të njëjtit hulumtim, vetëm 4.7 për qind mendojnë se Serbia duhet t'i shkëpus lidhjet me Rusinë. Në anën tjetër, gjysma e qytetarëve serbë, përkatësisht 50.6 për qind, mendojnë se Serbia duhet t'i shtojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara, kurse 31.9 për qind mendojnë se shteti serb duhet të qëndrojë larg nga këto lidhje. Në lidhje me marrëdhëniet mes Serbisë dhe Gjermanisë, 50.2 për qind e respondentëve thonë se këto lidhje duhet të mbahen. Shumica e respondentëve, ose 41.9 për qind, mendojnë se Serbia duhet të qëndrojë neutrale, kurse aleanca politiko-ekonomike gjen mbështetjen e 24.5 për qind të qytetarëve.

Shqipëria po plaket, dyfishohet popullsia mbi 80-vjeç!

Kur hyri mijëvjeçari i ri, në Shqipëri numëroheshin 38.500 persona të moshës mbi 80 vjeç. Në ditët e sotme kjo grupmoshë thuhet është dyfishuar dhe sipas të dhënave të Institutit të Statistikave - numërohen 69.190 persona apo 2% e popullsisë së vendit. Plakja e popullsisë, një fenomen që po vërehet shumë kohët e fundit, ka pasoja ekonomike dhe jo vetëm. Së pari, me plakjen fillojnë dhe problemet me shëndetin



së popullsisë. Të dhënat tregojnë se nga viti 2000 e deri sot, popullsia mbi 80 vjeç është gati dyfishuar... Kur hyri mijëvjeçari i ri, në Shqipëri numëroheshin 38.500 persona të moshës mbi 80 vjeç. Në ditët e sotme kjo grupmoshë thuhet është dyfishuar dhe sipas të dhënave të Institutit të Statistikave - numërohen 69.190 persona apo 2% e popullsisë së vendit. Plakja e popull-

sisë, një fenomen që po vërehet shumë kohët e fundit, ka pasoja ekonomike dhe jo vetëm. Së pari, me plakjen fillojnë dhe problemet me shëndetin. Rreth një e treta e popullsisë mbi 65 vjeç raportojnë se vuajnë nga një apo më shumë sëmundje. Gjatë periudhës janar - gusht 2017 importet e produkteve farmaceutike shënuan rritje vjetore 14% në vlerë dhe 7% në

MË TË MOSHUARIT JETOJNË NË ITALI DHE NË GREQI

Përqindjen më të lartë të moshës mbi 80 vjeç e kanë shtetet në jug të Evropës, ku përqindjet më të larta janë regjistruar në Itali 6.7%, në Greqi 6.5%, Spanjë 6% dhe Portugali 5.9%. Këto vende ndiqeshin nga Gjermania me 5.8% të totalit të popullsisë mbi 80 vjeç. Popullsia mbi 80 vjeç ka shënuar vazhdimisht rritje në BE që nga 2006.

sasi. Shtimi i numrit të të moshuarve - shpjegojnë farmacistët - rrit sasinë e konsumit të ilaçeve për tensionin, zemrën, Parkinsonin, etj. Moshat e thyera shpesh vuajnë më shumë se nga një sëmundje kronike, ndaj dhe ata janë kontingjenti më i madh i blerjes të medikamenteve. Së dyti, plakja e popullsisë ndikon në uljen e produktivitetit dhe rrit kërkesën për shërbime më të specializuara që moshën e tretë kërkon. Plakja e popullsisë sot është një fenomen botëror dhe një

nga arsyet kryesore të reformimeve të skemave të pensionit. Vende të ndryshme e kanë adresuar në mënyra të ndryshme problemin, që nga krijimi i incentivave për rritjen e lindshmërisë, duke rritur shpërblymjet, subvencionet e familjeve me shumë fëmijë, njohje ose dhurim të periudhave të sigurimit për çdo fëmijë ose kohës së kujdesit ndaj fëmijës, rritjes së moshës së daljes në pension ku disa vende po e rrisin deri në 70 vjet. Shpenzimet për pensione për vitin 2016

shënuan rritje vjetore me 5,6%. Në fillim të vitit 2017, popullsia e vendit sipas INSTAT ishte 2,876,591 persona, ndërsa numri i pensionistëve në këtë vit, sipas ISSH, ishte 611,544. Për rrjedhojë, të moshuarit në moshë pensioni, përbënin 24% të popullsisë së vendit. Sipas studimeve më të fundit, një ndër arsyet kryesore të rritjes së kësaj grupmoshe është rritja e jetëgjatësisë. Më përmirësimin e kushteve të jetesës, përmirësimin e të ushqyerit, por edhe me një akses më të gjerë të shërbimeve shëndetësore, është rritur dhe jetëgjatësia e popullsisë. Në vitin 2000, sipas të dhënave nga Banka Botërore, një shqiptar jetonte mesatarisht 74 vite e dy muaj, ndërsa sot moshën e pritur llogaritet të jetë 78 vite e nëntë muaj.



Arabia Saudite mund të vendoset në "listën e zezë" të OKB-së



Me arsyetimin për shkeljet e të drejtave të njeriut në Jemen që kanë shkaktuar "vdekjen dhe plagosjen e afërsisht 700 fëmijëve" forcat e koalicionit nën udhëheqjen e Arabisë Saudite janë përfshirë në draftin e listës së zezë të Kombeve të Bashkuara (OKB). Sipas draft listës së OKB-së, theksohet se forcat e koalicionit nën udhëheqjen e Arabisë Saudite në vitin 2016 kanë

shkaktuar vdekjen dhe plagosjen e 683 fëmijëve në Jemen dhe se kanë patur në objektiv 38 spitale dhe shkolla. Ndërsa ka qenë prej kohësh një çështje debati nëse forcat e koalicionit të mbështetura nga SHBA do të shtohen apo jo në listën e zezë të OKB-së. Forcat e koalicionit nën udhëheqjen e Arabisë Saudite vitin e kaluar u vendosën për një kohë në listën e zezë të OKB-së por më pas u ho-

qën nga lista. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në atë periudhë, Ban Ki-moon tha se ka dhënë një vendim "të vështirë dhe të dhimbshëm" duke vënë theksin se do të ndikoheshin miliona fëmijë nga ndërprerja e ndihmave dhe se ka qenë i detyruar të heqë koalicionin nga lista e zezë pas presioneve. Ndërsa organizatat jo-qeveritare ndërkombëtare me arsyetimin e shkeljes së të drejtave të njeriut kërko-

Forcat e koalicionit nën udhëheqjen e Arabisë Saudite vitin e kaluar u vendosën për një kohë në listën e zezë të OKB-së por më pas u hoqën nga lista

jnë që forcat e koalicionit të vendosen në "listën e zezë" të OKB-së. Në draft listën e OKB-së për këtë vit diskutohet edhe për përfshirjen e forcave të koalicionit nën udhëheqjen e Arabisë Saudite me arsyetimin se në Jemen kanë shkaktuar "vdekjen dhe plagosjen e afërsisht 70 fëmijëve". Gjithashtu në listën e OKB-së janë edhe forcat qeveritare në Jemen, forcat Husi, Al-Kaeda dhe militantët pro qeverisë dhe gjithashtu ato akuzohen për mos marrjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura. Në draft përfshihen gjithashtu edhe forcat e regjimit në Siri, organizata terroriste DEASH dhe organizata talebane në Afganistan.



Në rast të shkëputjes, Katalonja do të mbetet jashtë BE-së

Zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian, Frans Timmermans në seancën e Parlamentit Evropian (PE), ku u diskutua rreth referendimit në Katalonjë, ka thënë se "ka shpërfillje" të ligjit, duke shtuar se obligimi i çdo qeverie është të mbështesë sundimin e ligjit. Ai përsëriti qëndrimin e Komisionit Evropian (KE) se sipas kushtetutës spanjolle, votimi në Katalonjë nuk ishte "ligjor". "Ekziston një konsensus se qeveria rajonale e Katalonjës, duke organizuar referendumin javën e kaluar, vendosi të injorojë ligjin. Gjykata Kushtetuese e pezulloi atë vendim, por kjo nuk ndryshoi asgjë dhe në fund ne pamë vetëm skena shumë të trishtueshme", tha Timmermans. Ai gjithashtu theksoi se në politikë, me dhunë kurrë nuk mund të zgjidhet dhe të ndryshohet asgjë. "Dhuna në politikë kurrë nuk është përgjigje, ajo nuk zgjidh asgjë, kurse Evropa këtë e di më mirë se kushdo tjetër. Megjithatë, natyrisht, është detyrë e çdo qeverie të mbështesë dhe të kujdeset për sundimin e rendit dhe ligjit dhe kjo ndonjëherë kërkon edhe përdorimin proporcional të forcës", tha Timmermans.



Masakrat e muslimanëve, nis "çnderimi" i udhëheqëses së Mianmarit

Udhëheqëses së Mianmarit, Aung San Suu Kyi, do t'i hiqet titulli "Liria e qytetit të Oksfordit", për shkak të reagimit të saj ndaj krizës me muslimanët "Rohingya". Këshilli i Oksfordit vendosi unanimisht se nuk ishte më e përshtatshme të nderohej Suu Kyi dhe zyrtarisht titulli do t'i hiqet më 27 nëntor. Muajt e fundit, udhëheqësjja "de facto" e Mianmarit ka tërhequr shumë kritika, pasi duket se mbron trajtimin e pakicës etnike muslimane "Rohingya" nga autoritetet, që nga OKB-ja është cilësuar si shembull perfekt i "spastrimit etnik". Këshilli i Oksfordit e vlerësoi me titullin në fjalë Suu Kyi në vitin 1997, kur ajo ishte e burgosur politike e juntës ushtarake, por duket qartë se kanë ndryshuar shumë gjëra që atëherë. Më herët, Kolegji i Oksfordit, ku Suu Kyi ka studiuar, hoqi foton e saj nga galeria publike. Shumë institucione të tjera britanike, që kanë vlerësuar fituesen e çmimit Nobel për Paqen, po konsiderojnë masa të njëjta, ndërsa shtohen gjithnjë e më shumë zërat që asaj t'i hiqet edhe Çmimi Nobel. Qindra e mijëra muslimanë "Rohingya" ia kanë mbathur në Bangladesh, pas dhunës së ushtruar ndaj tyre nga autoritetet në Mianmar, e përshtypja e përgjithshme e komunitetit ndërkombëtar është se Aung San Suu Kyi nuk ka ndërmend të bëjë asgjë për ta ndaluar këtë spastrim etnik, madje është dakord me të.

Pse në Itali nuk ka sulme terroriste!

Shumica e vendeve evropiane kanë qenë objekt i sulmeve terroriste. I vetmi vend, që nuk ka provuar makthe të tilla, është Italia, pavarësisht se kanë hyrë shumë emigrantë ilegalë. Vetëm në vitin 2017, kanë hyrë 82 për qind emigrantë, nga numri i përgjithshëm që kanë hyrë në Evropë. Sqarimi i dhënë deri tani, është se mafia italiane ka arritur t'i pengojë xhihadistët të grupohen dhe të organizojnë sulme. "Kemi vërejtur se mafiozët italianë tashmë e kontrollojnë pjesën jugore



të vendit, dhe shumica e muslimanëve jetojnë në veri, e as atje nuk i kanë formuar getot e tyre", ka thënë Arturo Varveli, nga Fakulteti Ndërkombëtar për Shkenca Politike, në Milano. Sipas një koman-

danti të policisë lokale, për shkak të eksperiencës, policia ka dhënë një kontribut të madh në parandalimin e terrorizmit. "Lufta kundër kriminit të organizuar u ka dhënë shërbimeve tona eksperiencë të madhe, në mbikëqyrje të grupeve të vogla, por të lidhura ngushtë. Gjithashtu kemi eksperiencë nga procesi i mbikëqyrjes së celulave të majta dhe të djathta terroriste, të cilat kanë vepruar në gjithë Italinë, gjatë viteve '70- '80", ka treguar ai për "Economist".

Regjimi i Asadit sërish ka përdorur gazin sarin

Përfaqësuesja e përhershme e SHBA-ve në OKB, Nikki Haley tha se Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW) ka arritur në gjetje të reja se regjimi Asad në Siri ka përdorur gazin vdekjeprurës sarin



Përfaqësuesja e përhershme e SHBA-ve në Komitetin e Bashkuara (OKB) Nikki Haley njoftoi se Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW) ka arritur në gjetje të reja se regjimi Asad në Siri ka përdorur gazin vdekjeprurës sarin. Në një deklaratë me shkrim Haley tha se gjetjet e misionit të përbashkët të hetimeve të formuar nga OKB dhe OPCW-ja (JIM)

kanë zbuluar se më 30 mars, në veri të Sirisë, 5 Armëve Kimike (OPCW) ka arritur në gjetje të reja se regjimi Asad në Siri ka përdorur gazin vdekjeprurës sarin. Në një deklaratë me shkrim Haley tha se gjetjet e misionit të përbashkët të hetimeve të formuar nga OKB dhe OPCW-ja (JIM)

t'i vrarë civilët e pafajshëm sirianë dhe për t'i terrorizuar ata. Haley thotë se ky regjim po gënjën lidhur me këto armë të cilat i posedon dhe se vazhdon të mos pranojë që të bashkëpunojë me OPCW-në. "Nuk mund t'i parandalojmë sulmet e ardhshme kimike, përderisa regjimi në Siri

nuk jep llogari për krimet e bëra", thotë Haley. Haley thekson se për marrjen e përgjegjësisë së krimeve të tmerrshme të kryera nga regjimi i Asadit, Këshilli i Sigurimit të OKB-së duhet ta zgjasë mandatin e misionit JIM, i cili do të përfundojë këtë muaj. Misioni i OKB-së JIM, ishte formuar në vitin 2015 për zbulimin e palëve të cilat përdorin armë kimike në Siri. Regjimi sirian më 4 prill në rajonin Han Shejhun të Idlibit në Siri, me armë kimike vrau rreth 100 civilë dhe plagosi rreth 500 të tjerë. Komisioni i Pavarur Hetimor Ndërkombëtar për Sirinë pranë OKB-së ka vërtetuar se regjimi i Asadit ka përdorur gaz sarin në masakrën me armë kimike në këtë rajon.



cilat mund të jenë motivet e një aleance në dukje kaq e pazgjdhshme? Përgjigja, siç ndodh shpesh në këto raste, mund të gjendet tek historia. Në fakt, qysh nga kohëra më të lashta, Kina dhe Koreja kanë pasur një marrëdhënie që mund të përkufizohet si intime dhe komplekse

Kina dhe Koreja e Veriut nuk janë të lidhura vetëm nga pikëpamja gjeografike, duke ndarë një kufi prej 1420 kilometrash: në fakt, qysh nga kohëra që nuk mbahen mend, kanë avancuar një marrëdhënie që mund ta përkufizojmë si intime dhe komplekse. Analiza e këtij raporti është veçanërisht interesante kur përquendohet mbi zhvillimet në historinë bashkëkohore, për faktin se janë pikërisht këto zhvillime të fundit që kanë kontribuar në rregullimin e sotëm gjeopolitik, sidomos në dritën e intensifikimit të kohëve të fundit të tensioneve në gadishullin korean. Analizimi i lidhjeve që regjimi i Kim ka pasur në të kaluarën me Republikën Popullore të Kinës (sot aleati kryesor i tij, në mos i vetmi) është gjë e domosdoshme nëse dëshirohet të tentohet që të parashikohet – apo aq më pak të kuptohet – përgjigja kineze ndaj një shpërthimi eventual të dhunës në gadishull.

“Koreja e Veriut do të bënte mirë që të pushonte nga bërja e kërcënimeve të reja për Shtetet e Bashkuara, përndryshe do t'i duhet të ndeshet me një zjarr e furi që bota nuk e ka parë kurrë më parë”. Këto fjalët e Presidentit të Shteteve të Bashkuara Donald Trump në përgjigje të kërcënimeve të Kim Jong-un ndaj bazës ushtarake të Guamit, në ditët e para të muajit gusht. Janë respektivisht të 29 gushtit dhe të 3 shtatorit lajmet e raketës koeranoveriore (e 17-a këtë vit) që ka fluturuar në qiellin japonez dhe e provës së re bërthamore (e 6-a) e kryer nga regjimi i Phenianit. Në javët e fundit politologët nga e gjithë bota pyesin se cilët mund të jenë planet afatgjata e Koresë së Veriut dhe, sidomos, cilat mund të jenë pasojat e në shpërthimi të ri të dhunës në gadishull. Në këtë skenar një rol me rëndësi absolute është luajturi nga fqinji komunist i regjimit koreanoverior, domethënë ajo Republikë Popullore e Kinës që në vitet e fundit nuk duket ta ketë braktisur “shtetin batakçi” e bezdisshëm. Pavarësisht “kapriçove” të shumta të regjimit, në fakt Kina është akoma sot aleatja kryesore – në mos e vetmja – e Kim dhe vendi që më shumë i mundëson mbijetesën. Por, cilat mund të jenë motivet e një aleance në dukje kaq e pazgjdhshme? Përgjigja, siç ndodh shpesh në këto raste, mund të gjendet tek historia. Në fakt, qysh nga kohëra më të lashta, Kina dhe Koreja kanë pasur një marrëdhënie

Lindja e largët

“Vëllazëria e gjakut”



hënie që mund të përkufizohet si intime dhe komplekse, e krahasueshme – duke cituar fjalët e studiuesit koreanoverior Jae Ho Chung – me atë ekzistuese midis dhëmbëve dhe buzëve: pa këto të fundit (domethënë Gadishulli Korean ose, në përdorimin më bashkëkohor të tij, Koreja e Veriut) dhëmbët (domethënë Kina) do të gjendeshin të ekspozuar ndaj influencave potencialisht të dëmshme të botës së jashtme. Ky raport i veçantë i ka rrënjët deri në shekullin e V-të B.C., kur të dy vendet vendosën një sistem tributar në favor të Vendit të Mesit. Por është në zhvillimet më të vonshme të tij që merr interes të veçantë, për faktin se është pikërisht ky i fundit që ka kontribuar në plazhimin e rregullimit aktual gjeopolitik të gadishullit.

Lufta e rezistencës ndaj Japonisë dhe lufta civile kineze

Lidhja midis komunistëve kinezë dhe koreanë lind në epokën e luftës së rezistencës kineze kundër pushtimit japonez (Lufta e Dytë Kinë – Japoneze, 1937–45) dhe konsolidohet gjatë stadi final të Luftës Civile Kineze (1946 – 1949). Vlerësohet se në rastin e përplasjes së parë luftarake qenë rreth 100 mijë ushtarët koreanë që morën pjesë në operacione ushtarake kundër Japonisë, duke arritur të përbëjnë pothuajse totalitetin e disa njësisë të ushtrisë kineze. Në vijim, gjatë viteve të luftës së brendshme midis komunistëve të Maos dhe nacionalistëve të Jiang Jieshi, Koreja e Veriut u bë një bazë strategjike për operacionet kineze në mançuri, teatri kryesor i përlëshjeve. Për t'i dhënë fund situatës së disfavorshme të krijuar sidomos për shkak të forcave ushtarake inferiore (duke mos mund të mbështetet mbi mbështet-

jen pothuajse të pakufizuar e Shteteve të Bashkuara), Partia Komuniste Kineze krijoi në territorin koreanoverior një zyrë speciale, që përveç mbajtjes aktive të komunikimeve, mori funksionin e hub për ndihmën ndaj ushtarëve të plagosur dhe magazinimit të materialit luftarak. Pa mbështetjen e koreanoveriorëve ka të ngjarë që forcat komuniste e vendosura në jug të Mançurisë do të qenë asgjësuar nga trupat e Guomindang, duke ja dhënë këtij të fundit fitoren e luftës. Në të dyja rastet, ndihma e pakushtëzuar e udhëheqësve të Phenianit, përveç afërësive ideologjike (duhet kujtuar se midis viteve 1910 dhe 1945 Koreja pësoi një dominim traumatik japonez), i detyrohet çështjeve thelbësive taktike: në fakt, duke i dhënë mbështetje Maos, do të mund të gëzonin edhe ata benefitet e mëdha strategjike të një fitoreje komuniste.

Lufta e Koresë

Çfarë e shtyu Kinën, e sapodalë nga një luftë civile e përgjakshme, që të merrte pjesë pothuajse menjëherë në një konflikt të ri të barabartë, në mos me rëndësi më të madhe? Arsyet qenë të shumta dhe mund të ndihmojnë që të ravijëzohen disa skenarë të mundshëm për situatën e sotme. Para së gjithash, mund të citohen fjalët e Bruce Cumigs për sa i përket raportit midis revolucionarëve e të dy vendeve në vijim të episodeve të sipërpërmendur: “Këto lidhje qenë aq të forta sa që, në retrospektivë, ajo që një historian do të kishte vështirësi të shpjegonte është një jondërhyrje kineze në Luftën e Koresë”. Kështu, me shpërthimin e luftimeve, udhëheqja e Partisë Komuniste Kineze ishte goxha e vetëdijshme për vlerën e ndihmës koreanë të disa viteve më parë,

siç ishte edhe për precedentin historinë që i shikonte japonezët ta përdornin gadishullin korean si urë për pushtimin e viteve '30, fillimisht duke e aneksuar dhe më pas duke i dhënë jetë një mobilizimi në shkallë të gjerë ushtarëve të plagosur dhe Verilindjes kineze (e cila ishte gjithmonë një pol zhvillimi jetik për ekonominë, sidomos në kohë me nevojën e rindërtimit). Pohimi se siguria e vendit ishte ngushtësisht e lidhur me atë të Koresë nuk ishte, për pasojë, propagandë e thjeshtë (pikërisht në këtë periudhë lindi “Fushata e Rezistencës ndaj Amerikës dhe e Mbështetjes ndaj Koresë”, një prej lëvizjeve të para masive e të sapokrijuarës Republikë Popullore Kineze). Frika e Pekinit ishte se mos kriza koreanë arrinte të stimulonte aktivitetet e reaksionarëve në territorin kombëtar, pse jo edhe atë të klasave sociale armiqësore ndaj Republikës. Edhe regjimi i Goumindang, i vendosur në Formosa pas humbjes, do të mund të përfitonte nga situata e komplikuar e krijuar në portat e Kinës. Në thelb, duke marrë pjesën e konfliktit dhe duke shmangur rënien e regjimit koreanoverior (i cili, veç të tjerash, shërbente si “kundrapeshë” ndaj Bashkimit Sovjetik të ri të Hrushovit), Mao do të shmangte krijimin e një “efekti domino” të rrezikshëm – siç përcaktohet nga studiuesi kinez Chen Jian – duke e shpëtuar revolucionin socialist të Azisë.


Ekonomi dhe kulturë

Ai politik – strategjik nuk është aspekti i vetëm në të cilin të dy vendet patën shkëmbime. Në fakt, është e pamohueshme që regjimi i Maos ka qenë për koreanoveriorët një partner i rëndësishëm edhe nga pikëpamja ekonomike. Në radhë të parë, Kina u impenjua aktivisht në

rindërtimin e diktaturës së Kim pas lufte, duke dërguar 800 milionë yuan (rreth 95 milionë euro të sotme, shënimi im.). Në nëntorin e vitit 1953 të dy qeveritë nënshkruan një marrëveshje lidhur me b a s h k e p u n i m i n e k o n o m i k, i c i l i g j e n e r o i n j e f l u k s j o v e t e m m a l l r a s h (i lehtësuar nga “Ura e Miqësisë Kinë – Koreane”, nga viti 1990 “Ura në Lumin Yalu”), por edhe studentësh e teknikësh në emër të bashkëpunimit midis poleve industriale (i është një shembull “Naftësjellësi i Miqësisë Kinë – Koreane”). Në vitet '60, në vijim të tensioneve të shpërthyer me Bashkimin Sovjetik për shkak të kursit të ri politik të sipërpërmendur të Hrushovit, kinezët përdorën tregtinë dhe ndihmën ekonomike për ta larguar Kim nga sferë e influencës sovjetike: një plan i guximshëm për t'u vënë në praktikë duke parë superioritetin e Moskës në termat e disponueshmërisë financiare dhe të avancimit teknologjik. Duke shfrytëzuar rivalitetin midis dy fqinjëve, udhëheqësi koreanoverior arriti të sigurojë maksimumin nga të dyja palët. Në planin kulturor mund të përmenden industria kinematografike (e lindur me iniciativën kineze në fundin e viteve '40), artet figurative (superioriteti teknik i koreanëve pranohet nga vetë kinezët, që çdo vit dërgojnë studentë të Korenë e Veriut për t'u specializuar në artin qeramikë pranë Universitetit të Arteve të Bukura të Phenianit) dhe opera moderne koreanoveriore, në të cilën shumë elemente – nga zgjedhja e subjekteve, tek vënia në skenë – dëshmojnë influencën e modelit kinez në modë gjatë Revolucionit Kulturor. Kontributet e Republikës Popullore të Kinës në ekonominë e fqinjit komunist shkojnë goxha më tej: lëvizja Chol-

lima, kooperativat bujqësore dhe planifikimi i ekonomisë me plane i dëshiruar nga Kim Il-sung, realisht nuk ka sesi të mos kujtojnë përvojat kineze e Hopit të Madh Cilësor Përpara, të reformës agrare dhe të planeve pesëvjeçare.

Situata e sotme
Është e qartë sesi raportet midis Kinës dhe Koresë së Veriut kanë qenë të shumtë, me natyrë të larmishme dhe me rëndësi parësore për të dy vendet. Është po aq e qartë sesi shumë prej premisave që çojnë në një përfshirje të Republikës Popullore të Kinës në Luftën e Koresë janë të pranishme akoma sot, në mënyrë të veçantë nevoja për një “shtet kushinetë” që ndaj kombin kinez nga Koreja e Jugut – ku aktualisht janë vendosur 37000 ushtarë amerikanë – dhe vullneti i Pekinit për të shmangur “efektin domino” e sipërpërmendur. Duke marrë një perspektivë më aktuale, rënia e regjimit të Phenianit do të çonte në thelb në dy pasoja pak të dëshirueshme për Pekinin: Një gadishull korean i ribashkuar nën drejtimin e Seulit (dhe influencën e Uashingtonit) që, veç gjërave të tjera, do të fitonin kontrollin e arsenalit koreanoverior, përfshi testatat bërthamore; Një emergjencë humanitare me proporcione të mëdha për t'u menaxhuar përgjatë kufirit, për shkak të numrit të lartë të refugjatëve koreanoveriorë që pashmangshmërisht do të tentonin të hynin në vend. Kështu, nuhatet lehtësisht sesi një skenar i kësaj natyre do ta dëmtonte totalisht interesin kryesor të Kinës, domethënë ruajtjen e stabilitetit përgjatë kufijve. Bile mund të guxohet pohimi se një interes i tillë është vënë në diskutim tashmë me nuklearizimin e shtetit koreanoverior, disa dekada më parë. Nga ana tjetër, Republika Popullore e Kinës e sotme është jashtëzakonisht ndryshe nga ajo e viteve '50: vështirë se Xi Jinping do të vinte në rrezik statusin prestigjioz ndërkombëtar të cilin gëzon vendi me një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake. Është më i imagjinueshëm një aksion pastërtisht diplomatik – pavarësisht se agresiv – me qëllimin e ruajtjes së statuskuosë, të paktën deri në një kërcënim eventual konkret ndaj integritetit territorial. Kjo lloj strategjie është vënë tashmë në zbatim gjatë këtyre javëve, fillimisht me ashpërsimin e sanksioneve ndaj Phenianit dhe më pas me bllokimin total e importeve të qymyrit nga Koreja e Veriut. Për ta përmbyllur, nuk duhet harruar se ato që kanë ndryshuar janë edhe perceptimi dhe qëndrimi i pjesës tjetër të planetit ndaj Kinës, sidomos nga këndvështrimi i Shteteve të Bashkuara. Në fakt, sot janë pikërisht amerikanët që janë partnerët e parë tregtarë e fuqisë aziatike, të pasuar nga Japonia dhe Koreja e Jugut.



Ajnshtajni ishte një kokëfortë fanatik. Ai refuzoi të vishej ashtu siç e këshillonin, kushdo të ishte ai apo ajo. Njerëzit ose e njihnin mirë, ose nuk e njihnin fare

Albert Ajnshtajn (14 mars 1879 – 18 prill 1955) ishte një fizikant i cili llogaritet si shkencëtari më i rëndësishëm i shekullit XX. Ai përcaktoi teorinë e relativitetit dhe dha shumë kontribute në fushat e mekanikës kuantike, mekanikës statistikore dhe kozmologjisë. Në vitin 1921 fitoi çmimin Nobel për fizikë për shpjegimin e efektit fotoelektrik dhe për shërbimin në fushën e "fizikës teorike". Gjithashtu Albert Ajnshtajni njihet si njeriu më i mençur në botë dhe gjeniu i shekullit XXI. Ai krijoi formulën më të njohur në botë, formulën e energjisë. Truri i Albert Ajnshtajnit është akoma i gjallë, duke mbijetuar nëpër laboratorët më modernë në botë! Dhe thuhet se koeficienti i dijes së trurit të Ajnshtajnit është 165, gjithashtu gjatë vërjetjes së trurit ka dallime nga njerëzit tjerë. Ajnshtajni vdiq në Princeton, New Jersey, SHBA më 18 prill, 1955, në moshën 76 vjeçare.

Ajnshtajni ishte një bebe e shëndoshë me një kokë të madhe

Kur nëna e Albertit, Pauline, e lindi, koka e tij ishte kaq e madhe dhe e shtrembëruar, sa ajo kujtonte se mos ishte i deformuar. Ngaqë fundin e kokës e kishte shumë të madhe, familja mendoi mos ishte monstër. Megjithatë, ndërsa javët kalonin ata e kuptuan se ishte një fëmijë gati normal me të tjerët. Thuhet se gjyshja e tij ka klithur "është i shëndoshë, është i shëndoshë", kur e ka pritur të lindte. Ndryshe nga përshtypja e parë, Alberti u rrit normalisht, vetëm se ishte pak i ngadalte.


Ajnshtajni kishte vështirësi në të folur

Kur ishte fëmijë, Ajnshtajni fliste rrallë. Kur e bënte, fliste shumë ngadalë. E mendonte të gjithë fjalën në kokë dhe e pëshpëriste para se ta thoshte. Këtë e bëri rregullisht deri në moshën 9-vjeçare. Prindërit trembeshin mos ishte i vonuar, por sigurisht më vonë doli se frika e tyre ishte pa baza. Kjo është quajtur sindroma e Ajnshtajnit.

Kur Ajnshtajni foli për herë të parë

Një historian ka krijuar një barsoletë. Prindërit e tij ishin të shqetësuar se nuk fliste fare. Kur një mbrëmje foli dhe tha "Supa është e nxehtë", prindërit e pyetën pse nuk kishte folur më parë. Ai i përgjigjet: Sepse gjithçka ishte në rregull.

Sekretet që nuk i dinit për gjenium



SINDROMA E AJNSHTAJNIT



Ajnshtajni është frymëzuar nga një busull

Kur Ajnshtajni ishte pesë vjeç dhe i sëmurë në shtrat, babai i tregoi diçka që i ndezi interesin në shkencë:

Një busull. Ndërsa qëndronte i shtirë, babai i nxori një busull të thjeshtë xhepi. Ajo që i interesonte Ajnshtajnit të ri ishte se sa herë që kutia ndërronte pozicion, gjilpëra kthehej në të njëjtin drejtim. Ai mendoi se duhet të kishte ndonjë forcë në atë që konsiderohej si hapësirë boshe që e bënte gjilpërën të lëvizte. Ky incident i zakonshëm në shumë "fëmijëria të famshme", është përmendur shpesh në shumë rrëfime të jetës së tij.

Ajnshtajni ngeli në provimin e hyrjes për në kolegji

Në vitin 1895, në moshën 17-vjeçare, Albert Ajnshtajni aplikoi për të hyrë në Shkollën Politeknike Federale Zvicrone (Eidgenössische Technische Hochschule). Ai kaloi provimin e matematikës dhe të shkencës tek provimi i hyrjes, por ngeli tek të tjerat.

Ndër lëndët ku nuk shkonte mirë ishte historia, gjuhët e huaja, gjeografia dhe të tjera. Ajnshtajni duhet të regjistrohej në një shkollë tregtare para se ta ribënte provimin dhe më në fund u pranua tek i njëjti universitet një vit më vonë.

Ajnshtajni kishte një fëmijë të paligjshëm

Në vitin 1980, letrat private të Ajnshtajnit kanë zbuluar diçka të re për gjenium. Kishte një vajzë të paligjshme me ish-studenten Mileva Mariç, të cilën më vonë u martua. Në vitin 1902, një vit para martesës, Mileva lindi në familjen e prindërve në Berne, një vajzë me emrin Lieserl, të cilën Ajnshtajni kurrë nuk e pa dhe për të cilën nuk dihet gjë. Ajo është pagëzuar dhe jetoi me familjen e Milevës. Më vonë ajo thotë se vdiq nga ethet në shtator, 1903. Në korrespondencën e çiftit shkruhet se është dhënë për birësim pasi ka lindur. Në letërën e 19 shtatorit, 1903, Lieserl Einstein-Mariç përmendet për herë të fundit.

Kur përjashtohej nga shkolla

Ajnshtajni ishte i ngadalte në procesin e të folurit. Madje prindërit e tij janë konsultuar dhe me një doktor. Ai madje ka patur një rebelim "të paturp" ndaj autoriteteve, që bëri që drejtori i shkollës ku ai studionte ta përjashtonte nga shkolla dhe të shprehej rreth tij se ai nuk do të mund të arrinte shumë në jetë. Por këto karakteristika bënë që ai të bëhej një gjeni. Mospërfillja dhe përbuzja e tij ndaj autoritetit bënë që ai të vinte në dyshim njohuritë tradicionale. Zhvillimi i tij i ngadalte verbal, bëri që ai të bëhej kurioz për gjërat e zakonshme – si koha dhe

hapësira – që pjesa më e madhe e të rriturve i marrin për të mirëqena. I ati i dhuroi një busull në moshën pesë vjeçare, dhe hetoi mbi natyrën e fushës magnetike gjatë gjithë jetës së tij. Ai kishte prirjen të mendonte në bazë të imazheve dhe jo me fjalë.

Kishte Ajnshtajni probleme të në mësuar?

Disa shkencëtarë kanë pretenduar se kanë zbuluar se në fëmijëri Ajnshtajni ka shfaqur shenja të lehta të autizmit ose të sindromës së Aspergerit. Simon Baron Kohen, drejtor i qendrës kërkimore të autizmit në Universitetin e Kembrixhit, është një prej tyre. Ai shkruan se autizmi është i lidhur "me një përpjekje intensive për të kontrolluar dhe një përpjekje të vogël të pazakontë për të qenë empatik". Ai gjithashtu vë në dukje se kjo gjë "shpjegon 'kufijtë e aftësisë' që njerëzit me autizëm shfaqin në lëndë të tilla si matematika, muzika ose vizatimi – të gjitha aftësi që përfitohen nga kontrolli". Kjo nuk duket një diagnozë bindëse. Edhe si adoleshent, Ajnshtajni kishte miq të ngushtë, kishte marrëdhënie intime, bëhej pjesë e debateve skollastike, komunikonte mjaft mirë verbalisht dhe ishte empatik ndaj miqve dhe njerëzimit në përgjithësi.

A ngeli Ajnshtajni në Matematikë?

Një besim mjaft i përhapur rreth Ajnshtajnit është

se ai kishte ngelur në lëndën e matematikës. Një kërkim në Google rreth kësaj nxjerr më shumë se 500 mijë rezultate. Ky lajm madje është bërë pjesë e titujve të gazetave "besoje ose jo". Por historia e tij është shumë ironike: Në 1935, një lajm u botua rreth Ajnshtajnit "Matematikani më i madh i kohës, ngel në matematikë". Duke qeshur ai është përgjigjur se nuk ka ngelur asnjëherë në matematikë, dhe se në moshën 15 vjeçare ai kishte zgjidhur ekuacione të vështira matematikore. Në shkollë fillore ai ka qenë më i miri i klasës dhe shumë më lart rezultateve të prishme në matematikë.

Në moshën 12 vjeçare, motra e tij u shpreh se ai "gjithmonë kishte preferuar të zgjidhte probleme të vështira aritmetike", dhe vendosi të zbulonte nëse mund të progresonte duke mësuar gjeometrinë dhe algjebërën vetë. Prindërit i blenë libra të avancuar që ai të përgatitej gjatë verës. Ai jo vetëm që mësoi fakte në këto libra, por identifikoi disa teori në një përpjekje që t'i testonte personalisht. Ai madje pati idenë e tij personale se si mund të provonte teorinë e Pitagorës.

Ajnshtajni, i preferuari i grave

Kur Ajnshtajni u divorcua me Milevën në vitin 1919 (tradhtia cilësohet si një nga shkaqet), ai u martua me kushërirën, Elsa Loventhal. Në të vërtetë ai donte të marto-

hej edhe me vajzën e Elsës nga një martesë e mëparshme, Ilse, 18 vjet më e re se ai, por ajo e kundërshtoi. Ndryshe nga Mileva, shqetësimi kryesor i Elsës ishte të kujdesej për burrin e saj të famshëm. Ajo i dinte dhe i toleronte tradhtitë dhe lidhjet dashurore të tij, të cilat zbulohen më vonë tek letrat e tij. Fillimisht e tradhtoi me sekretaren, Betty Neumann. Korrespondenca e tij tregon se ishte i lidhur me gjashtë gra, mes tyre dhe një spiune ruse.

Nuk e ndiqte asnjëherë modën dhe s'ka mësuar kurrë të shkruajë anglisht

Ajnshtajni ishte një kokëfortë fanatik. Ai refuzoi të vishej ashtu siç e këshillonin, kushdo të ishte ai apo ajo. Njerëzit ose e njihnin mirë, ose nuk e njihnin fare, arsyetonte ai, kështu që nuk kishte rëndësi në e shihni me të njëjtin kostum një vit të tërë. Edhe pse jetoi për shumë vite në Shtetet e Bashkuara dhe i fliste mirë të dyja gjuhët, Ajnshtajni thotë se kurrë nuk ka mundur të shkruajë në anglisht, për shkak të "shqiptimit të pabesë". Kurrë nuk e humbi theksin dallues gjerman "I vill a little t'ink" (I ëll a little think")

Nuk kishte shtetësi për 5 vite

Ai nuk ishte shtetas i asnjë vendi për gati 5 vite! Që nga viti 1896 (kur refuzoi shtetësinë gjermane në moshën 15-vjeçare) deri në vitin 1901 (kur u bë zvicran). *bota.al*



Sala është i lumtur që "The Last Resort" është përshkruar si vepër antimonumentale, sepse nuk është se ka ndonjë vlerë përveçse fton për interpretime të ndryshme

Koncerti për klarinetë në A-dur, të cilën Mozart e përfundoi në muajt e fundit të jetës së tij, është një prej veprave më të dashura të muzikës klasike. Për herë të parë ishte interpretuar nga miku i Mozartit, klarinetisti virtuoz Anton Stadler në tetor të vitit 1791 dhe bashkëkohësit kishin vërejtur ngjashmërinë në interpretimin e Stadler me zërat e njerëzve.

Mund të imagjinohet humanizmi i shprehur në melodinë e lehtë të kohës së mesme adagio, ndërthurjen e klarinetës me orkestër dhe simetrinë e kënaqshme të strukturës klasike të muzikës si shenjë e Iluminizmit Evropian: rritja e valës së kërkimit intelektual në shekullin XVIII, që do të shfaroste supersticionin dhe do të prezantonte atë që Kanti e përshkroi si "guxim për të menduar për udhëzimet e dikujt tjetër". Tani imagjinoni, ashtu siç e ka bërë këtë artisti shqiptar Anri Sala arritjen e kësaj kulture intelektuale evropiane në një vend jugor dhe të paeksploruar shumë, transmeton "Koha Ditore" shkrimin e The Australian. Me një sy dhe vesh për rastësinë historike, Sala ka vërejtur se premiera e koncertit të Mozartit në Pragë në vitin 1791 përkon me vitin e parë të kolonive britanike në Australi. Ai mendon për koncertin si një artefakt prej një bote të vjetër, e cila është humbur nëpër ato brigje.

"Kam qenë i interesuar në idenë se çfarë do të ndodhte sikur kjo kryevepër të vendosej në një shishe e të hidhej në det, dhe si do të përfundonte në ujërat e trazuar, erërat e motin e lig", ka thënë Sala.

Instilacioni i Salës për "33rd Kaldor Public Art Project" quhet "The Last Resort" dhe prezanton koncertin e Mozartit sikur të ishte humbur në Sydney. Objekti i rrumbullakët në "Observatory Hill", pika më e lartë natyrale në Sydney, nga ku shihet limani, është pajisur me 38 bateri të përmbytura, derisa një tjetër puls ritmik do të aktivizojë shkopiinjët e daulles. Është Mozart, por jo ashtu siç e njohim: muzika është e njohur, por e fragmentuar. Në një aranzhim të veçantë për adagio, që është incizuar për "The Last Resort", Sala e ka zëvendësuar tempin e Mozartit me shenja të nxjerra nga ditari i një marinari, shënime të përditshme që fillojnë me përshkrimin e erës.

"Të gjitha shpresat e tyre

Ekspozitë

Mozarti i panjohur në veprën e Anri Salës



ishin që era të frynte në drejtimin e duhur", ka thënë Sala. "Gjuha është shumë e pasur në relacion me erërat. Na ka dhënë një gamë të gjerë të përshkrimeve, të cilat përfunduan në një gamë aq të pasur të indikacioneve të ritmit", ka shtuar ai. Sala, i cili u lind në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, ka jetuar dhe punuar në Francë për shumë vite, më 2013 ai ishte përfaqësuesi i Francës në Bienalen e Venecias. Para pak kohësh ai është kthyer nga Meksiko – ka qenë atje kur tërmeti shkatërrues e goditi qendrën e Meksikos para dy javësh – dhe po mbikëqyr instalimin e "The Last Resort". Bateritë po rrinë të varura të përmbytura në tavanin e objektit të rrumbullakët sikur të ishin lakuriqë nate, që Sala ishte i habitur kur kishte parë në "Royal Botanic Garden" gjatë vizitës së tij të parë në Sydney. Pamja është spektakolare dhe vepra artistike është gjithçka përveç monumentale. Kualiteti i tij esencial është afatshkurtër: muzika e fragmentuar që do të tingëllojë dhe që do të animojë bateritë. Për koincidence, ekspozimi trejavor i "The Last Resort" vjen pas debateve të fundit për kolonizimin e të bardhëve në Australi dhe monumentet e ngritura nga kolonizuesit britanikë. Udhëtimi i James Cook në vitet 1768 deri më 1771 në Paqësor ishte motivuar nga ideat e iluminizmit të kërkimit shkencor: për të shikuar transitin e Venerës dhe

për të zbuluar lokacionin e "Terra Australis Incognita", asaj që ndryshe njihet si hipotetike ishullor kontinenti i parë. Sala thotë se iluminizmi, po ashtu, do të ketë pasojë për ata që janë kapur nga vrotimi i tij i fuqishëm. "Fatkeqësisht... ishte po ashtu një moment kur civilizimi perëndimor imponoi veten tek civilizimet e tjera duke shkaktuar humbjen e atyre civilizimeve", ka thënë Sala. "Për mua është moment shumë i ndërlikuar dhe i kontestueshëm në historinë e njerëzimit", ka shtuar ai. Disa njerëz i vlerësojnë statujat e Cookut dhe Arthur Phillip si simbole të zbulimeve false dhe shpronësimit. Sala nuk shpallon një opinion të tijin rreth kësaj çështjeje të caktuar, por tregon interesim për këto monumente në përgjithësi dhe atë se çka përfaqësojnë. Ai thotë se ka një dallim në mes të atyre që janë thjesht dekorative apo "pjesë e një prone të një vendi" dhe ato që janë pjesë e "ndërgjegjes" së tyre. Në Shqipëri, bashkë me mikun e tij Edi Rama, artisti i cili më pas u bë kryeministër i vendit, ka dokumentuar transformimin me ngjyra të lehta të arkitekturës së shkatërruar socialiste në Tiranë.

"Monumentet e ndërtuara gjatë kohës së regjimit socialist ishin autoritare", ka thënë ai. "Ato nuk përfaqësojnë vullnetin e popullit, dhe ishin gjëja e parë që njerëzit sulmuan në atë kohë, rrëzuan monumentet e diktatorit, monumentin e Stal-

init... Mendoj se po shkojmë drejt një shoqërie ku ideja e monumentit – ajo që simbolizon, që përfaqëson – është e gabuar në vetvete", ka thënë Sala.

Monumentet, që deri më tani prezantojnë një ideologji apo interpretim të paracaktuar, janë joetike për pjesën më të madhe të artit bashkëkohor, përveç nëse nuk janë të mbushura me armiqësi apo me dykuptimësi. Sala është i lumtur që "The Last Resort" është përshkruar si vepër antimonumentale, sepse nuk është se ka ndonjë vlerë përveçse fton për interpretime të ndryshme. Për këtë arsye ai ngurron të cakttojë një "personazh" për solo-klarinetë në "The Last Resort", siç ishte figura e Cook apo shpirti i iluminizmit. Derisa instrumentet e tjera të orkestrës do të tingëllojnë nëpërmjet baterive të ndara, klarineta do të shëtisë nëpër ansambël.

"Nëse vjen dikush dhe e ka këtë interpretim, atëherë është tejet i mirëseardhur, por nuk jam unë ai që i cakton ato interpretime", ka thënë Sala. "Në fund vepra duhet të funksionojë në mënyrë organike dhe muzikore si një ansambël... Nuk jam i interesuar në artikullimin e metaforave, por ideja ka qenë që të dëgjojmë këtë vepër muzikore, jo domosdo sikur të ishte menduar nga kompozitori i saj, por se si mund të tingëllojë pasi të ketë dalë në breg, duke qenë e prishur nga moti dhe forcat e natyrës".



Ishiguro fitues i çmimit Nobel për Letërsi

Shkrimtari anglez Kazuo Ishiguro është fitues i çmimit Nobel për Letërsi për vitin 2017.

Akademia suedeze ka shpallur fitues shkrimtarin anglez me arsyetimin se ai "në romanet me forcë të madhe emocionale, zbuloi humnerën nën ndjenjën tonë iluzore të lidhjes me botën".

Çmimi Nobel për letërsi i kthehet një shkrimtari të zakonshëm pasi në vitin 2016 këtë çmim e fitoi këngëtar Bob Dylan. Ai ka shkruar tetë libra, të cilët janë përkthyer në 40 gjuhë.

Romanet e tij më të njohur "The Remains of the Day" dhe "Never Let Me Go" u adoptuan në filma shumë të suksesshëm.

Elina Duni në JazzFest Tetova



Pas tre vitesh pauzë, rikthehet në Tetovë manifestimi JazzFest Tetova. Këtë herë, ky manifestim është konceptuar në dy net, edhe atë me datë 7 dhe 9 tetor

Këtë edicion, Tetova do ketë përsëri rastin ta dëgjojë emrin e madh të xhazit shqiptar, Elina Dunin, e cila vjen bashkë me kitaristin kontemporan të xhazit nga Londra Rob Luft.

Organizatorët e këtij manifestimi pohojnë që për shkak të kërkesave të shpeshta të tetovarëve për ta pasur përsëri Elina Dunin në qytetin e tyre, kanë vendosur që t'ua ofrojnë këtë kënaqësi qytetarëve dhe dashamirëve të xhazit. Nata e parë mban titullin, i cili flet gjithçka: "Muzikë shqiptare e ndërthurur në jazz". Do të jetë një bashkëpunim midis dy muzikantëve të shkëlqyer, të cilët tashmë e kanë vërtetuar veten si të tillë. Ky koncert do të mbahet në Sallën e Madhe të Qendrës për Kulturë, në ora 21.00.


Nata e dytë, më 9 tetor, do të jetë me kuartetin nga Shkupi Kalevala. I përbërë nga muzikantë profesionistë, ky kuartet në repertorin e saj ka këngë të tipit të world music, pra këngë të cilat përfshijnë gati se të katër anët e botës. Koncerti do të mbahet në Sallën Koncertale të Shkollës së muzikës në Tetovë, në ora 20.00, shkruan zhurnal.

Manifestimi JazzFest Tetova mbështetet nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, kurse sponsor të tjerë janë edhe Qendra për Kulturë dhe Shkollë Shtetërore e Muzikës "Todor Skallovski-Tetoc".

Kush e tradhtoi Anne Frank

Kurrë nuk është zbardhur me siguri të plotë se kush e tradhtoi familjen e Anna Frankës, vajza që vdiq në vitin 1945 në kampin e përqendrimit Bergen-Belsen, në Gjermani

Tani, siç raporton "The Guardian", kur kanë kaluar 75 vjet nga ngjarja, Vince Pankoke, agjent i FBI-së në pension, përpiqet t'i japë përgjigje misterit holandez. Pankoke do të përdorë teknika investigative të brezit të fundit dhe sisteme të inteligjencës artificiale. "Me algorimet dhe software-t e fuqishme janë studiuar 25 kilometra dosje dhe dokumente", ka deklaruar ish-agjenti. Për të financuar



operacionin, por edhe për të marrë sinjalizime dhe për të publikuar hapat e hetimeve, detektivi ka nisur një fushatë për mbledhje fondesh. Skuadra hetimore përbëhet nga 19 ekspertë, kryesisht

kriminologë, gazetarë, informues dhe historianë. Pankoke dëshiron të zgjidhë çështjen e fundit të karrierës së tij në emër të Anna Frank dhe për këtë do të studiojë disa lista me emrat e hebrenjve që

kishin rënë në duart e njëjësive naziste në Amstërdam sepse ishin tradhtuar nga persona të tjerë.

Në një nga studimet e fundit të bëra në lidhje me këtë çështje, në dhjetor të vitit 2016 me nismë të Shtëpisë Muzeale të Frank, dilte në përfundimin se familja në fjalë ishte gjetur rastësisht nga policia në gusht të vitit 1944, gjatë një kontrolli për falsifikim dokumentesh në shtëpinë ku ishte strehuar. Por në të kaluarën dyshimet binin mbi të paktën 30 persona, më "i famshmi" mes të cilëve Wilhelm van Maaren, punëtor i një fabrike pranë shtëpisë, edhe pse provat në ngarkim të tij janë konsideruar të pamjaftueshme. (KultPlus)



“Na pret një ndeshje mjaftë e vështirë ndaj Italisë. Jemi të vetëdijshëm për kualitet që i ka kjo skuadër dhe kualitetet e tyre individuale. Por, kjo nuk donë të thotë se ne do të dorëzohemi para kohe, do të japim maksimumin në fushë dhe me pak fat besoj se mund të nxjerrim rezultat pozitiv”, pohon për gazetën KOHA, Musliu

Koha Nga Torino, Bujar KURTAJ

Torino, 5 tetor - Përfaqësuesja e Maqedonisë sonte me fillim në ora 20.45 në stadiumin Olimpik të Torinos, do të përballet me kampionin e katërfishtë të botës Italinë, në kuadër të përbaljes së parafundit të ciklit kualifikues për Kampionatin Botëror në Rusi vitin e ardhshëm. Djemtë e seleksionuesit Igor Angellovski pa asnjë ngarkesë do të hynë në këtë ndeshje duke marr parasysh se gjasat për dy vendet e para që moti i kanë humbur, për dallim prej Italisë, të cilës i duhet fitorja për të ruajtur gjasat me Spanjën për vendin e parë, derisa kjo e fundit kryeson në tabelën e klasifikimit me 22 pikë, tre më shumë se Italia. Ndryshe Spanja të premten do të pret Kombëtaren e Shqipërisë.

Verdhekuqtë në Torino janë prej të mërkurës dhe janë maksimalisht të për-



gatitur për këtë sfidë, në të cilën do të tentojnë të bëjnë befasi, ose në një farë mënyrë tu hakmerren “axurrëve” për disfatën në Shkup me 2-3. Kujtojmë, Maqedonia me golat e Nestorovskit dhe Hasanit kishte epërsi me 2-1, por me golat e Imobiles në minutën e 75 dhe 90, përmbysën rezultatit dhe arritën fitore.

Ndryshe në taborin e Maqedonisë Angellovski ka përfshirë pesë futbollist shqiptar, ndërsa pos Arian Ademit, i cili nuk ka të

drejtë të luajë, katër të tjerët Ferhan Hasani, Enis Bardhi, Ezgjan Alioski dhe Visar Musliu do të jenë të gatshëm për lojë. Pikërisht ky i fundit, i cili gjendet në formë jashtëzakonisht të mirë, thotë se nuk do të dorëzohen deri në fund, pa marr parasysh se Italia është një skuadër e fortë. “Na pret një ndeshje mjaftë e vështirë ndaj Italisë. Jemi të vetëdijshëm për kualitet që i ka kjo skuadër dhe kualitetet e tyre individuale. Por, kjo nuk donë të thotë se ne do

të dorëzohemi para kohe, do të japim maksimumin në fushë dhe me pak fat besoj se mund të nxjerrim rezultat pozitiv”, pohon për gazetën KOHA, Musliu, i cili shpreson që Angellovski do ti jep mundësi të luajë ndaj “axurrëve”. “Shpresoj se seleksionuesi Angellovski do të më jep mundësi të luaj. Jam maksimalisht i përgatitur të jap maksimumin që t’ia shpërblej besimin seleksionuesit”, përfundoi mbrojtësi i KF Vardar. Ndërkohë, për Aleksandar Trajkovskin, i

Në Torino, Italia pret Maqedoninë

Musliu: Nuk dorëzohemi, besoj se mund të nxjerrim rezultat pozitiv



Përfaqësuesja e Maqedonisë ka realizuar edhe stërvitjen zyrtare në “Stadio Olimpico” në Torino ku nesër me fillim në ora 20.45 do të zhvillojë përbaljen me përfaqësuesen e Italisë. Atmosfera në mesin e verdhekuqve është e mirë, ndërsa në dispozicion seleksionuesi Igor Angellovski do ti ketë të gjithë të ftuarit për këtë sfidë. Njëri nga katër futbollistët shqiptar që janë ftuar nga Angellovski, Enis Bardhi thotë se janë të gatshëm dhe të motivuar për përbaljen e nesërme me Italinë.

cili luan te skuadra e Palermos, ndeshja me Italinë është e rëndësishme. “Të luash kundër Italisë është shumë e vështirë, por edhe një motivim i madh. Por, pa marr parasysh se sa do të dukej rëndë, asnjëri që është pjesë e përfaqësueses nuk

duhet të lejon as në këtë ndeshje por as në ndeshjet tjera të lirohet. Duhet të japim gjithçka nga vetja dhe të besojmë se mund të vijmë deri te rezultati pozitiv”, deklaroi Trajkovski. Kujtojmë, Italia-Maqedonia luhet sot (e premte) në ora 20.45.

Publicitet

Në bazë të nenit 20, paragrafi 2, nenit 21 dhe 22 të Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarisë energjetike (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16), Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS – Kosovë – filiali FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS në Maqedoni, Tetovë, me adresë: Ilindenska nr. 20 – QTQ/lok. 94 Tetovë, për tregti me energji elektrike në vijim publikon:

LAJMËRIM

Informohet opinioni se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS – Kosovë – filiali FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS në Maqedoni, Tetovë, me adresë: Ilindenska nr. 20 – QTQ/lok. 94 Tetovë, për tregti me energji elektrike, më datë 05.09.2017, ka parashtruar Kërkesë për dhënie të licencës për tregti me energji elektrike me UP1 nr. 12-101/17 deri tek KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.

Emri i kërkuarit:

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS – Kosovë – filiali FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS në Maqedoni, Tetovë,

Lloji i veprimtarisë energjetike:

Tregti me energji elektrike.

Rajoni ku do të realizohet veprimtaria:

Veprimtarinë energjetike, tregti me energji elektrike, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS – Kosovë – filiali FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS në Maqedoni, Tetovë, me adresë: Ilindenska nr. 20 – QTQ/lok. 94 Tetovë, do ta realizojë në pajtim me Ligjin për energjetikë.

Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë:

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS – Kosovë – filiali FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS në Maqedoni, Tetovë, për tregti me energji elektrike do të punojë sipas Ligjit për energjetikë.

Kohëzgjatja e licencës:

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS – Kosovë – filiali FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS në Maqedoni, Tetovë, me adresë: Ilindenska nr. 20 – QTQ/lok. 94 Tetovë nga KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË kërkon dhënie të licencës me kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjet.

Mënyra dhe afati përfundimtar për parashtrimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me Kërkesën për dhënie të licencës për tregti me energji elektrike:

Palët e interesuara, subjektet juridike dhe fizike mund që me shkrim të parashtrorjnë deri tek KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, propozime, mendime dhe sugjerime në lidhje me kërkesën për dhënie të licencës për tregti me energji elektrike në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të LAJMËRIMIT në shtypin ditor për kërkesë të dhënies së licencës për tregti me energji elektrike.

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Bul. Maqedonia pn pallati Petar Pop Trajkov, kati i VI, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS – Kosovë – filiali FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS në Maqedoni, Tetovë, me adresë: Ilindenska nr. 20 – QTQ/lok. 94 Tetovë

Në bazë të nenit 131 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 135 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/08.....127/16); nenit 46 të Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe të punës së Fakultetit Pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup, në përbërje të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Fletorja universitare nr. 287/2014), dhe nenit 34 paragrafi 2 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Fletorja universitare 274/2013), dekani i Fakultetit pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup, më datë 4.10.2017 publikon:

KONKURS

Për zgjedhje (rizgjedhje) të një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor:

- Bëhet zgjedhje (rizgjedhje) e një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat Pedagogjia dhe Metodika për lëndët:
 - Metodika e mësimit për Matematikë 1 dhe Metodika e mësimit për Matematikë 2, Lëndë obligative për grupin studimor Mësim klasor, për mësimin në gjuhën shqipe,
 - Metodika e punës edukativo-arsimore për Matematikë 1 dhe Metodika e punës edukativo-arsimore për Matematikë 2, Lëndë obligative për grupin arsim parashkollor, për mësimin në gjuhën shqipe,
 - Punëtori kreative për Matematikë, lëndë zgjedhore për grupin studimor Mësim klasor, për mësimin në gjuhën shqipe,
 - Punëtori kreative matematikore, lëndë zgjedhore për grupin studimor Mësim klasor dhe parashkollor, për mësimin në gjuhën shqipe.

Kandidatët të cilët do të paraqiten në Konkurs, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet nga Ligji për arsim sipëror, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë duhet të parashtrorjnë:

- fletëparaqitje;
- biografi të shkurtë;
- diplomë për arritje të shkallës shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet;
- formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues, që mund të merren në arkivin e Fakultetit dhe
- certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e kandidatëve parashtrorhen përmes postës në arkivin e Fakultetit, në afat prej 8 ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor.

Kandidati i zgjedhur do të lidhë marrëdhënie pune për kohën që do të zgjidhet.

Për Fakultetin pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” Shkup
Dekan
Prof. d-r Emil Sulejmani



Shanset për t'u ngritur dhe për të fituar titullin janë reale por ato duhen kapur në momentin e duhur. Është shumë i rëndësishëm fakti që morëm sërish konfirmimin nga Maranello që makina është totalisht ok

Ashpërsohen masat ndaj tifozëve

Policia ndalon edhe flakadanët në stadione

Në rast shkeljesh sanksionet parashikojnë gjobë nga 10-50 mijë lekë, ndalim të pjesëmarrjes deri në 1 vit në mjediset sportive, në rast diskriminimi për shkaqe të ndryshme, si dhe ndalim të hyrjes në mjediset sportive deri në 2 vjet, në rast se konstatohen sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive



Policia e Shtetit do të ashpërsojë masat ndaj tifozëve, që shfaqin sjellje të palejuara në mjediset sportive, ku përfshihen edhe mbajtja dhe ndezja e flakadanëve, fishekzjarrëve dhe lëndëve të tjera pirotekine, apo përdorimi i alkoolit. Ja njoftimi i uniformave blu me këtë rast: "Në zbatim të Ligjit "Për Sportet", Policia e Shtetit nis aplikimin e gjobave dhe për-

jashtimet nga stadione për tifozët që kryejnë shkelje. Pranë çdo komisarati do të ngrihet një Komision për Shqyrtimin e Kundërvajtjeve Administrative, ku zhvillohen veprimtari sportive. Në krye të këtij komisioni emërohet shefi i komisaritit. Shkeljet e konstatuara gjatë një evenimenti sportiv, si mbajtja dhe përdorimi në ob-

jektet e mjediset sportive të flakadanëve, fishekzjarrëve, lëndëve piroteknie dhe sendeve të tjera të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike, si dhe cenimi i përfaqësuesve të federatave, arbitrave të ndeshjes, vëzhguesve etj., dërgohen në Komisionin e Shqyrtimit të Kundërvajtjeve

Administrative, i cili miraton masat. Në rast shkeljesh sanksionet parashikojnë gjobë nga 10-50 mijë lekë, ndalim të pjesëmarrjes deri në 1 vit në mjediset sportive, në rast diskriminimi për shkaqe të ndryshme, si dhe ndalim të hyrjes në mjediset sportive deri në 2 vjet, në rast se konstatohen sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive. Për çdo ankesë, kundërvajtësi mund t'i drejtohet Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, që drejtohet nga Nëndrejtori i policisë vendore. Pasi vendimi merr formë të prerë, masa administrative e gjobës bëhet titull ekzekutiv dhe duhet të paguhet nga kundërvajtësi menjëherë. Për të patur një evidencë të plotë për gjithë shkelësit në stadione, Policia e Shtetit do të ndërtojë një regjistër elektronik me emrat e tyre. Kjo listë u dërgohet edhe FSHF-së dhe klubeve të futbollit, në rastet kur do t'u ndalohet hyrja në stadione".


Ilir Daja, timonieri që ndryshoi Skënderbeun

Skënderbeu ka treguar rritje në lojë dhe rezultate që në fillimin e këtij viti, kur skuadra iu besua trajnerit Ilir Daja. Në dhjetorin e vitit 2016, pas përfundimit të supersfidës Skënderbeu-Partizani, korçarët të cilët u mundën 1-2 në shtëpi panë veten 5 pikë larg Kukësit kryesues dhe 4 pikë larg Partizanit pretendent për titullin. Drejtuesit morën vendimin për të larguar Agostinellin duke afruar Ilir Dajën, që u largua në mesin e sezonit nga Tirana. Ky ndryshim rezultoi i goditur për korçarët, pasi bardhekuqtë iu rikthyen pretendimeve për titullin, madje e humbën atë në sfidën direkte aq shumë të kontestuar ndaj Kukësit në Zeqir Ymeri. Që nga debutimi në stol më 28 janar ndaj Flamurtarit në Korçë, Skënderbeu i Dajës ka luajtur 22 ndeshje në superiore, duke fituar 15, barazuar 5 dhe humbur vetëm dy. Mesatarja e pikëve për ndeshje është 2.27, një ecuri i jashtëzakonshme që kulmoi me suksesin në Zeqir Ymeri ndaj Kukësit në fillim të kësaj jave. Sikur të mos mjaftojnë rezultatet dhe loja në rritje në kampionat, këtë verë Skënderbeu vendosi edhe rekord në Evropë, pasi u bë e para skuadër që kalon 4 ture në kompeticionet e UEFA-s për tu rikthyer në fazën e grupeve të Europa League, aty ku luajti edhe dy sezona më parë. Pa diskutim që merita për këtë ecuri shkon për drejtuesit por duartrokitjet më të mëdha i meriton Ilir Daja, strategu që bëri të funksionojë si duhet skuadrën pas një periudhe me oshilacione në lojë dhe rezultate.



Publicitet

Skuadra dhe tifozët kërkojnë Nainggolan në kombëtare



Nainggolan dhe kombëtarja belge, duket një kalavar pa fund. Mesfushori belg u la jashtë përfaqësueses për të dytën herë radhazi dhe çështja shumë polemike në Belgjikë. Trajneri Martinez duhet të mbajë qëndrimin e tij, edhe pse duket se nuk është në diskutim prezenca e futbollistët në Botërorin e vitit të ardhshëm, me trajnerin e Belgjikës që do ta thërrasë

në mars për turneun rus. Por ndërkohë tifozët belgë janë rreshtuar në anën e Radja Nainggolan, pasi panë që sërish nuk ishte pjesë e Kombëtares. Në grumbullimin në Tubisë ku skuadra po zhvillon përgatitjet mungesa është pikërisht ai, mesfushori i Romës që nuk i ka munguar edhe mbështetja e tifozëve që shpalosën një banderolë duke u solidarizuar me të. Edhe shokët e skuadrës duket se janë me Nainggolan me Thorgan Hazard që u shpreh se "të gjithë i njohim cilësitë e Radja, po bën shumë mirë me Romën, meriton një vend në Kombëtare dhe në të kaluarën ka demonstruar se çfarë di të bëjë në këtë skuadër. Është një mëkat që nuk është këtu". Ndërkohë edhe Axel Èitsel u shpreh se "Radja është një futbollist i mirë, i rëndësishëm për skuadrën e tij. Gjithsesi nuk na takon ne lojtarëve të vendosim se kush thërritet në Kombëtare dhe kush jo".

PSG dhe planet për largimin e Cavanit

Zyrtarisht nuk do ta pranojnë kurrë, por PSG ka një plan sekret në merkato mbi të cilin po punon prej kohësh. Do të largohet Cavanit, që pavarësisht se u përfaqua me Neymar në ndeshjen e fundit me Bordeaux ku braziliani gjuajti dhe 11 metërshin, nuk është se shkon shumë mirë me blerjen 222 milionëshe. Në vend të El Matador do të afrohet Alexis Sanchez, me mediat franceze që e japin për të sigurt rrokadën në sulm verën e ardhshme. Një operacion që do të ishte pozitiv edhe në këndvështrimin e fair play-t financiar, duke qenë se kiliani do të vinte me parametra zero pasi i skadon kontrata me Arsenalin. Ndërkohë klubet e mëdha të Europës, janë gati të përfitojnë dhe duhet thënë se pretendentët për shërbimet e Cavanit nuk mungojnë. Duke nisur nga Real Madrid, që nuk do të kishte problem të përballonte pagën e lartë të uruguajanit me Cavanin që mund të joshet jo vetëm nga sharmi i padiskutueshëm i Realit por edhe nga mundësia për të luajtur me Cristiano Ronaldon. Në Angli japin ndërkohë në pole position



Chelsea, me blutë që janë madje të ndërhyjnë në merkato që në janar për tju parapirë konkurrentëve. Në të ardhmen e Cavanit mund të jetë edhe Bajerni, dhe kjo për arsyen e thjeshtë se Realit i madridit synon prej kohësh Levandovskin që nuk duket aq i kënaqur të bavarezët dhe nëse bomberit polak shkon në Bernabeu atëherë në Bavari do të hidhej menjëherë në sulm për Cavanin. Ëndërrojnë ndërkohë rikthimin e sulmuesit në Itali dhe Juventusit e Napoli, me bardhezinjtë që mund të bëjnë një tentativë për El Matador, ndërkohë që te Napoli mund të synojnë të përfitojnë dhe nga marrëdhënia e mirë me sulmuesin që me fanelën e kaltër ka realizuar 104 gola në 138 ndeshje.

KORRIGJIM

Në shpalljen publike për zgjedhjen dhe akreditimin e programeve për trajnimin dhe ofertuesit e shërbimeve për aftësim profesional të kuadrit edukativo – arsimor (mësimdhënësve) në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë me temë: „Nocioni i algoritmit dhe programeve, përvetësimi i mendimit të algoritmit përmes lojës dhe krijimi i programeve të zakonshme (për klasën III, IV dhe V) publikuar më 02.10.2017. Paragrafi 2 i shpalljes publike ndryshohet dhe është: „Ofertuesit e interesuar të cilët do të aplikojnë në shpalljen publike duhet t'i përfshijnë të gjithë rajonet, kryesisht nuk mundet të aplikojnë në veçanti sipas rajoneve”.

Byroja e zhvillimit të arsimit



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe
Planifikimit Hapësinor



MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë
SHPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit, në lokacionin PK 2232, Komuna e Gazi Babës.

Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit të ujërave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë është dorëzuar Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit në lokacionin PK 2232, Komuna e Gazi Babës, me numër të arkivit nr. UPI-11/5/790/2017 prej 01.08.2017.

Parashtrues i kërkesës:
SHA MAKSTIL Shkup
rr. Makedonska Brigada nr. 18

Koordinatat e puseve eksploatauese PK 2232, Komuna e Gazi Babës sipas sistemit shtetëror koordinativ:

Pusi X – 4652405

Y – 7539046

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail H.Rexhepi@moepp.gov.mk
Publiku i tanguar në afat prej 15 ditëve nga data e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë të dorëzojë mendime dhe komente në formë të shkruar deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardi Goce Dellçev nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.



"Barcelona dhe ekipi i Argjentinës nuk mund të përballonjë përbrenda dhjetë minuta lojë dhe Leo Messi të mos e prekë topin. Leo Messi duhet të vihet në lojë si duhet, ka nevojë të jetë aty ku gjërat ndodhin, ku topi shkon"

Messi dhe Dybala janë të ngjashëm

Trajneri i Argjentinës, Jorge Sampaoli thotë se Lionel Messi dhe Paulo Dybala kanë ngjashmëri në stilin e lojës. Sampaoli thotë se ekipi i tij nuk ka kohë për të ndërruar sistemin e lojës në mënyrë që t'iu përshtatet dy yjeve të ekipit. "Nuk kemi kohë për të punuar në marrëdhëniet mes Messit dhe Dybalas", deklaroi Sampaoli. "Dybala është e ardhmja jonë, ne e dimë këtë. Në këtë moment kemi një problem sepse ai dhe Messi janë shumë të ngjashëm", shtoi ai. Ylli i Juventusit kishte deklaruar më herët se është e vështirë për të që të luaj së bashku me idhullin e tij, Messin. "Nuk shoh ndonjë gjë të keqe në atë që ka thënë Dybala. Ai kishte thënë se është i lumtur që luan me Messin, por thjesht nuk arriti të gjej vendin e tij", tha Sampaoli.



Heynckes ulet në stolin e bavarezëve deri në fund të sezonit

Bayerni ka zgjedhur. Jupp Heynckes, trajneri që ka arritur fitoren e trfishhtë në vitin 2013 është zgjedhja e përkohshme për stolin bavarez. 72-vjecari do të marrë drejtimin e ekipit deri në fund të këtij sezoni duke i dhënë kështu zgjidhje boshllëkut të krijuar nga shkarkimi në mes të sezonit të italianit Carlo Ancelotti. Lajmin e bën të ditur e përditshmja prestigjioze gjermane Bild, e cila vijon artikullin e saj duke theksuar se Thomas Tuchel, ish trajner i Borussia Dortmund me të cilin klubi pati zhvilluar një bisedë paraprake, nuk u pa të ishte në lartësinë e duhur, ndërkohë që Julian Nagelsmann nuk e pati rrugën e lirë nga Hoffenheim. Në janar të vitit 2013 ishte komunikuar lajmi se në vend të Heynckes do të mbërrinte Pep Guardiola dhe para se t'i jepte lamtumirën, në muajt që i kishin mbetur ai mori sadsifikacionin e fitoreve në Bundesligë, Kupën e Gjermanisë dhe Champions League. Pas fitores së trfishhtë të parë në historinë e klubit gjerman, Heynckens lajmëroi



se më këtë triumf i jepte fund edhe karrierës së tij si trajner. Më pas miq e kolegë u munduan t'i ndryshonin mendjen. Gjithsesi, duhet ktheksuar fakti se Don Jupp flet shumë mirë spanjisht përkatësisht gjuhën e latinëve Vidal dhe Hames Rodriguez dhe do të jetë faktor plus për të risjellë harmoninë e munguar dhe shuarjen e konflikteve të kri-

juara në dhomat e zhveshjes. Githashtu Heynckens ruan raporte shumë të mira edhe me Robben e Neuer. Ndërkohë më i fituari duket Uli Hoeness, me Presidentin aktual që do të ketë një mundësi tjetër shumë të mirë për të qetësuar ndërgjegjen e tij pas vendimit të marrë në vitin e largët 1991, sezoni i parë për Heynckens në stolin e bavarezëve,

në të cilin ai e pati shkarkuar. Për këtë episod Uli Hënes gjithnjë është shprehur se është penduar dhe se ka qënë gabimi më i madh në vendmarrjen e tij në karrierën si drejtues. Kjo është hera e katërt që Jup Heynckens rikthehet në stolin e Bayern Mynih, e sigurisht që para një figure si ai trajnerët e rinj duhet të presin në rradhë.

7 futbollistët që janë 'gjithmonë' të lënduar

"Marca" ka publikuar emrat e shtatë prej atyre që shumë shpesh ndodh të pësojnë lëndime. Gareth Bale është ylli i fundit i lënduar që do t'i mungojë ekipit të Real Madridit dhe Kombëtares së Uellsit. Por, Bale ka një shoqëri të gjerë të futbollistëve të tjerë që shpeshherë janë të lënduar. E

përditshmja sportive madriene "Marca" ka publikuar emrat e shtatë prej atyre që shumë shpesh ndodh të pësojnë lëndime. Shtatë lojtarët që lëndohen më shpesh: Gareth Bale, Marco Reus, Asenjo, Sergio Canales, Raphael Varane, Radamel Falcao dhe Arjen Robben.



Juventus i mposht të gjithë për Groetzkan



Juventusit pritet ta bëjë një goditje të madhe në afatin kalimtar të janarit. Leon Groetzka, mesfushor gjerman i Schalckas është afër Zonjës së Vjetër. Ai ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve si Barcelona, Liverpool dhe Manchester United. Kontrata e tij me Schalcken skadon me 30 qershor. Juventusit nuk ka ndërmend të presë dhe synon ta marrë futbollistin në Torino sa më shpejt të jetë e mundur. Shtypi italian e sheh si të kryer çështjen, duke shkruar se Groetzka i ka thënë po "Zonjës së Vjetër". Marotta dhe Paratici mund të mbyllin në javët e ardhshme marrëveshjen. Schalcke nuk do të arrijë ta mbajë mesfushorin nëse nuk e bind të rinovojë kontratën dhe lojtari ka bërë të ditur se nuk ka ndërmend ta bëjë një gjë të tillë.

Chelsea do të "lidhë" Hazard dhe Courtois me kontrata të reja

Rinovimi i kontratës së Eden Hazard është bërë një prioritet kyç financiar dhe strategjik për Chelsea. Klubi londinez po sheh, gjithashtu, mundësinë e një marrëveshje të re për Thibaut Courtois. Hazard, kohët e fundit, bëri një nga paraqitjet e tij më të mira me fanellën e bluve, kundër Atletico Madrid. "Goal.com" kupton se "Blues" kanë për qëllim ta shpërblejnë atë me pagë të majme, nëse ai nënshkruan një zgjatje të marrëveshjes së tanishme. Kapiteni i Belgjikës është tashmë lojtari më i paguar i Chelsea me një kontratë prej 200,000 £ në javë,



por marrëveshja e tij e re mund t'i sjellë atij shumë prej 300,000 eurosh në javë, plus

bonuset. Krerët e Chelsea i japin përparësi Hazardit, por janë të ndërgjegjshëm se Cour-

tois është, gjithashtu, një tjetër lojtar për rinovim, për shkak se portierit i kanë mbetur vetëm 21 muaj nga kontrata e tij aktuale. Courtois është i vetëdijshëm se negociatat me Hazard po marrin kohë, por ai shpreson të rinovojë dhe të fitojë dyfishin e pagës së tij aktuale. Portieri belg merr aktualisht 120,000 £ në javë, por ai dëshiron t'i rrisë fitimet e tij deri në 200,000 £ në javë, në përputhje me statusin e tij, si një nga më të mirat në botë në pozitën e tij. Hazard dhe Courtois janë të dy bashkë në ekipin kombëtar të Belgjikës dhe do të përballen me Bosnje-Hercegovinën të shtunën.

Bernardeschi nuk nxiton: Edhe Dybala ishte në stol, duhet durim!

Ndoshta nuk ishte fillimi i sezonit që ëndërronte Federico Bernardeschi, sidomos pas pagimit të çmimit të klauzolës prej 40 milionë eurosh nga Juventusit. Koha e tij te Fiorentina, si i pagabueshëm, është larg, por xhevahiri i skuadrës italiane nuk është me ngut për të marrë gjithçka dhe menjëherë. "Deri tani nuk kam luajtur shumë, por unë nuk jam

i shqetësuar, - tha Bernardeschi nga grumbullimi i kombëtares. - Juventusit punon edhe për të gjithë të rinjtë. Dybala, gjithashtu, e kaloi këtë kohë, dhe pastaj mësoi shumë nga stoli. Nuk është tragjedi të qëndrosh në stol te Juventusit, që ka fituar gjashtë tituj radhazi dhe ka marrë pjesë në dy finale të Ligës së Kampioneve në tri vitet e fundit. Unë nuk

kam frikë edhe se mos humbas Kupën e Botës, sepse trajneri Ventura ka provuar se beson te mua. Juventusit ishte një zgjedhje profesionale. Jam dhe do t'i jem gjithmonë mirënjohës Fiorentinës, që më rriti si futbollist. Unë i pranoj kritikën e tifozëve, por nuk bie dakord me kërcënimet në rrjetet sociale, të cilat kanë vënë në shënjestër motrën time dhe vajzën e saj."





Largimet e parakohshme nga futbollit

10 lojtarët që duhet të kishin vazhduar më gjatë



Disa lojtarë vazhdojnë të luajnë për një kohë të gjatë, por disa vendosin të shkëputen nga futbollit me herët. Kjo është një listë me ata që, vendosën të varin këpucët në një moshë të re

Erik Kantona

Mesfushori francez vendosi të tërhiqet në 1997 në moshën 30 vjeçare, kur ishte akoma në kulmin e formës. Përveçse talentit, ai do të mbahet mend dhe për bëmat jashtë fushës dhe për jetën e tij jashtë normales. Kantona mund të kishte vazhduar edhe 5 vjet, ose më shumë në ligat amatore. Ai u largua me 4 tituj Premier Lige dhe 2 Kupa FA.

Zinedin Zidan

Zinedin Zidan u tërhoq në 2006 në moshën 34 vjeçare, pas incidentit me Materacin në finalen e Kupës së Botës. Tërheqja e Zidan në këtë mënyrë solli shumë habi, pasi një lojtar i këtij niveli për shumë njerëz duhet të priste edhe një vit, në mënyrë që të rregullonte imazhin. Zidan gjatë karrierës së tij arriti të fitonte një Kupe Bote (1998), një Europian (2000) dhe Topin e Artë (1998).

Just Fontaine

Zidan nuk ishte i vetmi legjendë franceze që u tërhoq në moshë të re. Just Fontaine u tërhoq në 1962, një muaj përpara ditëlindjes së 29. Fontaine do të mbahet mend me rekordin që vendosi në Boterorin e 1958, duke shënuar 13 gola, por dëmtimet e shumta e detyruan të tërhiqej.

Marko Van Basten

Marko Van Basten ishte një tjetër viktimë e dëmtimeve. Legjenda e Holandës u tërhoq në 1995 në moshën 31 vjeçare, pasi kaloi 2 vjet jashtë fushave për shkak të një dëmtimi në këmbë. Përpara largimit, shënoi një nga golat më të bukur në një Europian, atë të fitores me Bashkimin Sovjetik në finalen

e 1988.

Alan Shirër (tërheqja nga Kombëtarja)

Alan Shirër u tërhoq nga Kombëtarja në moshën 29 vjeçare, direkt pas dështimit të Anglisë në Euro 2000. Është për të ardhur keq, pasi Anglia në atë periudhë kishte nevojë për një sulmues të nivelit të Shirër. Shirër e vazhdoi karrierën deri në 2006, por nuk u rikthye asnjëherë te ekipi i Tre Luaneve. 27 Jun 1984: Portrait of Michel Platini of France before the European Championship final against Spain at Parc des Princes in Paris. France won the match 2-0. Mandatory Credit: Allsport UK / Allsport

Mishel Platini

Platini është një tjetër legjendë e Francës që bën pjesë në këtë listë. Pasi triumfoi me Francën në Euro 1984 dhe pasi fitoi Topin e Artë 3 herë midis viteve 1983-1985, u tërhoq në 1987, atëherë kur mbushi 32 vjeç.

Brajan Laudrup

Brajan dhe vëllai Majkëll, u përfshinë të dy në listën e Fifa 100, në vitin 2004. Të dy ishin pjesë e Danimarkës në triumfin e Euro 1992.

Patrik Klajvert

Patrick Klajvert shpërtheu në moshën 18 vjeçare me Ajaksin duke shënuar gol në finalen e Champions League në 1995. Vazhdoi të luante me Barcelonën duke u bërë një legjendë e këtij ekipi, por u tërhoq në moshën 31 vjeçare.

Frenk Rajkard

Frenk Rajkard ishte gjithashtu pjesë e atij Ajaksi që fitoi Champions League në vitin 1995. Kjo ishte gjithashtu ndeshja e tij e fundit në karrierë. Ishte 32 vjeç.

Zbigniew Boniek

Polaku i vetëm në listën e Fifa 100 (Lojtaret më të mirë ndonjëherë) udhëhoqi Poloninë në një vend të tretë në Kupën e Botës 1982. Ai gjithashtu fitoi Champions League me Juventusin në 1985. U tërhoq 3 vjet më vonë në moshën 33 vjeçare.



I vëllai mbeti pa ekip, Riberi pagoi rrogën e tij te skuadra e kategorisë së dytë franceze

Frenk Riberi ka paguar rrogën e të vëllait në një klub të kategorisë së dytë franceze pa dijeninë e këtij të fundit. Këtë gjë e ka treguar agjenti Christophe Hutteau në librin e tij "Sekretet e mia si agjent". Ai thotë se Riberi e kishte telefonuar në një

moment kur vëllai i tij kishte mbetur pa ekip dhe i kishte kërkuar që t'i gjente një skuadër ku të paguhej të paktën 2500 euro në muaj në mënyrë që të jetonte në kushte të mira. Hutteau kontaktoi me klubin Aviron Bayonnais, por këta të fun-

dit i thanë se nuk mund të përballonin një pagë të tillë. Në këtë mënyrë, Riberi bëri një donacion prej 40 mijë eurosh për klubin francez dhe 33 mijë euro prej tyre shkuan si pagë për vëllain e futbollistit të Bajernit të Mynihut.





Martesa ka efekte të dobishme në shëndet dhe ruan zemrën

Hulumtimi i ri thotë se martesat janë të mirë për shëndetin dhe është e lidhur me shëndetin e zemrës. Hulumtimi, në të cilin morën pjesë rreth një milion të rritur britanikë të cilët kishin shtypje të lartë të gjakut, kolesterol të lartë apo diabet, tregoi se bashkëshorti i dashur mund t'ju frymëzojë që të kujdeseni më mirë për veten. Dr. Paul Carter dhe

kolegët e tij i prezantuan rezultatet e këtij hulumtimi në konferencën e Shoqatës Kardiovaskulare Britanike. Ata theksuan se martesat ndihmon në parandalimin e faktorëve të mëdhenj të rrezikut nga sëmundjet e zemrës, duke përfshirë kolesterolin dhe shtypjen e lartë të gjakut. "Meshkujt dhe femrat në të pesëdhjetat, gjashtëdhjetat dhe sh-

tatëdhjetat të cilët kanë kolesterol të lartë, diabet ose tension të lartë kanë 16 për qind më shumë të ngjarë të mbijetojnë sesa njerëzit që janë të vetëm", u tha në studim. Studimi nuk vlen për personat e shkurorëzuar dhe të vejë. Gjithashtu, studiuesit nuk kanë testuar nëse personat që morën pjesë në studim ishin në martesë të lumtura. "Ne nuk po

themi se të gjithë duhet të jenë të martuar. Ne duhet t'i përsërisim efektet pozitive të martesës, sepse në të njëjtën mënyrë mund të përdoren në miqësi, familje dhe në rrjete të mbështetjes sociale", tha dr. Carter. Dr. Mike Knapp tha se, në qoftë se e keni ndonjë faktor rreziku për sëmundje të zemrës, thirrëni të dashurit tuaj për t'ju ndihmuar.

KALENDARI HISTORIK 6 TETOR

- 1499 - Mbreti francez Luigji XII okupon Milanin.
- 1762 - Trupat anglez okupojnë Manila në Filipine.
- 1789 - Revolucioni francez: Luigji XVI kthehet në Paris nga Versaja pasi të konfrontohet me gratë e Parisit një ditë më parë.
- 1849 - Ekzekutohen 13 martirët e Aradit pas luftës hungareze për pavarësi.
- 1861 - Studentët e revoltuar rus mbyllin universitetin e Petersburgut.
- 1889 - Moulin Rouge hapet në Paris.
- 1908 - Austria përvetëson Bosnjën dhe Hercegovinën.
- 1922 - Fuqitë e mëdha botërore të Luftës së Parë Botërore tërhiqen nga Stambolli.
- 1928 - Josip Broz (Tito) arrestohet me 5 vjet burg.
- 1941 - Ushtria gjermane okupon Brianskin, BRSS.
- 1944 - Sovjetikët marshojnë në Hungari dhe Çekosllovakia.



2000 - Kryetari i Jugosllavisë Slobodan Milošević jep dorëheqje.

A E DINI SE... ?

Gjeneva për herë të tretë në katër vitet e fundit është zgjedhur si qyteti më i mirë si deshtacion evropian për pushime. Ceremonia është mbajtur në Shën Petersburg, shkruan "eturbonews.com". Ky çmim është si 'Oscar' në industrinë e turizmit. Atraksionet natyrore të Gjenezës, ofertat e turizmit kanë bërë që qyteti zviceran të zgjidhet si më i miri në një konkurrencë të ashpër. Ky është një sukses për qytetin zviceran, derisa ka arritur të mposhtë qytete mjaft të njohura e të mëdha, si Amsterdami, Kopenhaga apo Roma.



Erdhi në jetë duke mbajtur në dorë spiralen që do të evitonte lindjen e tij

Pas lindjes së një fëmije më 27 prill, një nënë e re u befasua pasi spiralja e kontrceptivit, e cila në fakt duhet të kishte evituar lindjen e vogëlushit, ishte fshehur pas placentës së saj, duke bërë kështu të mundur ardhjen në jetë të kësaj krijese engjëllore.

Pas lajmit që publikoi në profilin e saj bashkë me foton, Lucy Hellein nga Teksas, tregon vogëlushin e saj Dexter, i cili shtrëngon



në dorë spiralen e kontrceptivit. Fotoja e jashtëzakonshme ishte shoqëruar me mbishkrimin: "Mbrotja dështoi".

Në të vërtetë, kjo pajisje është 99 për qind efektive për shmangien e një shtatzënie të mundshme, por ajo kishte lëvizur duke u pozicionuar prapa placentës së nënës dhe ishte hequr nga mjekët gjatë një ndërhyrjeje cezariene, më 27 prill.

Vendi më i rrezikshëm në botë bëhet gati për një tjetër fatkeqësi

Vanuatu nuk është i panjohur për përmbytjet e shumta, erërat e forta si dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Vendi i vogël i ndodhur në Paqësorin e Jugut u vlerësua si vendi më i rrezikshëm në botë në një studim të Kombeve të Bashkuara në vitin 2016. 83 ishujt e saj, ndodhen në mes të rrugicës së stuhive dhe ndodhen në kufirin e "unazës së zjarrit", një rrip



rreth Paqësorit i prirur për tërmete dhe shpërthime vullkanike. Pavarësisht nga gjendja e tyre e pasigurt që është realiteti i përditshëm, së fundi kryeministri i vendit Charlot Salwai ka urdhëruar evakuimin e të gjithë ishullit Ambae për shkak të kërcënimit nga vullkani. "Jetët e njerëzve duhet të jenë përparësia jonë e parë", tha Salwai. "Gjithkush duhet të ikë".

BARSOLETA



DOKTORI DHE INXHINIERI

Një doktor dhe një inxhinier kishin rënë në dashuri me të njëjtën vajzë.

Doktori i dërgonte vajzës çdo ditë nga një trëndafil, ndërsa inxhinieri i dërgonte nga një mollë, dhe një ditë bëhet kurioz doktori dhe e pyet inxhinierin:

- Ore ti, pse i dërgon çdo ditë nga një mollë?

- Sepse, një mollë në ditë të mban larg nga doktori! - ia ktheu inxhinieri.

THËNIA E DITËS

Jeta është ajo që të ndodh përderisa je i zënë duke bërë plane tjera. (John Lennon)

